



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

**Efektiviteti i masave të ndërmarra në kuadër të Objektivit 1 të
OZHQ-ve - Zhdukja e varfërisë në të gjitha format**

Maj, 2026

PËRMBAJTJA

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT	4
1.1 Konteksti i Problemit Social	4
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës	5
1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë.....	5
2. SUBJEKTET NËN AUDITIM	6
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim	6
2.2 Baza ligjore dhe kriteret e tjera që rregullojnë çështjen nën auditim.....	8
2.3 Rëndësia e produkteve të subjekteve	9
2.4 Pësia në buxhet.....	10
2.5 Përkufizimet dhe terminologjia.....	11
2.6 Skema e analizës së programit	12
2.7 Feedback-u i subjekteve në fazën studimore.....	13
3. DETAJET E AUDITIMIT	13
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjekteve.....	13
3.2 Objektivat e auditimit.....	15
3.3 Pyetjet e auditimit.....	16
3.4 Fushëveprimi i auditimit	16
4. SHJTELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT	17
Pyetja kryesore: A ka siguruar qeveria shqiptare harmonizim, zbatim dhe monitorim efektiv të Objektivit 1 të OZHQ-ve për të arritur rezultate të matshme dhe të qëndrueshme në reduktimin e varfërisë?	17
1.1 A janë harmonizuar të gjithë synimet dhe indikatorët e Objektivit 1 të OZHQ me strategjitë dhe programet kombëtare?	17
1.2 A kanë funksionuar mekanizmat e koordinimit ndërinstitutional për mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin e progresit të nënobjektivave dhe indikatorëve të Objektivit 1 të OZHQ?.....	28
1.3 A janë zbatuar masat dhe veprimet e parashikuara në strategjitë dhe programet kombëtare për realizimin e synimeve dhe indikatorëve të Objektivit 1 të OZHQ?	38

Lista e Shkurtimeve

3E	Economy, Efficiency, Effectiveness (<i>Ekonomiciteti, Efikasiteti, Efektiviteti</i>)
ABF	Anketa e Buxhetit të Familjes (<i>Household Budget Survey – HBS</i>)
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
BE	Bashkimi Evropian
GDP/PPP	Gross Domestic Product / Purchasing Power Parity (<i>Prodhimi i Brendshëm Bruto / Barazia e Fuqisë Blerëse</i>)
INSTAT	Instituti i Statistikave
INTOSAI	International Organization of Supreme Audit Institutions (<i>Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit</i>)
ISSAI	International Standards of Supreme Audit Institutions (<i>Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit</i>)
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MF	Ministria e Financave
MPI	Multidimensional Poverty Index (<i>Indeksi i Varfërisë Shumëdimensionale</i>)
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OECD	Organisation for Economic Co-operation and Development (<i>Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik</i>)
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (<i>Sustainable Development Goals – SDGs</i>)
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
SDG	Sustainable Development Goals (<i>Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm – ekuivalent me OZHQ</i>)
SILC	Anketa e të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës (<i>Survey on Income and Living Conditions</i>)
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
UN Women	United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women
VNR	Voluntary National Review (<i>Raporti Vullnetar Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm</i>)
SIPI	Sistemit I Integruar të Informacionit për Planifikimin (<i>Integrated Planning System Information System</i>)
GMIP	Grupi i Menaxhimit të Integruar të Projekteve (<i>Integrated Project Management Group</i>)

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

1.1 Konteksti i Problemit Social

Varfëria përbën një nga sfidat më të mëdha të zhvillimit në shkallë globale, pasi ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës, mundësitë për arsim e punësim, si dhe qasjen në shërbime bazike. Ajo nuk është vetëm një pasojë e mungesës së të ardhurave, por lidhet ngushtë me mungesën e mundësive dhe të përfshirjes sociale. Kombet e Bashkuara e përkufizojnë varfërinë si “një mohim të të drejtave themelore të njeriut dhe një pengesë për zhvillimin e qëndrueshëm”. Për këtë arsye, adresimi i varfërisë shihet gjerësisht si një element thelbësor për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të përmirësuar respektimin e të drejtave themelore të njeriut.¹ Pavarësisht progresit të arritur në disa fusha të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, Shqipëria vijon të përballet me sfidën e varfërisë, e cila mbetet e pranishme për një pjesë të popullsisë dhe kërkon vëmendje të vazhdueshme politike dhe institucionale. Sipas INSTAT², për vitin 2024 treguesi i rrezikut për të qenë i varfër në vend ishte 19,2%. Ky nivel tregon se varfëria vijon të mbetet e lartë, sidomos për grupet më vulnerabël si fëmijët dhe të moshuarit, të cilët janë më të ekspozuar ndaj pasojave të saj. Për më tepër, sipas Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2023³, pabarazitë ndërmjet zonave urbane dhe rurale janë thelluar, duke kufizuar mundësitë e individëve në zonat më të largëta për të pasur qasje në arsim cilësor, kujdes shëndetësor dhe shërbime sociale.

Në nivel ndërkombëtar, angazhimi për zhdukjen e varfërisë është pjesë e Agjendës 2030⁴ për Zhvillim të Qëndrueshëm, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2015. Në kuadër të kësaj agjende, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) përfshijnë 17 objektiva dhe 169 synime, të cilat matin progresin global drejt një zhvillimi gjithëpërfshirës dhe afatgjatë. Këto objektiva mbulojnë fusha kyçe si zhdukja e varfërisë, eliminimi i urisë, përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies, arsimit cilësor, barazia gjinore, qasja në ujë të pastër dhe energji të qëndrueshme, rritja ekonomike e qëndrueshme, punësimi i denjë, inovacioni, zvogëlimi i pabarazive, zhvillimi i qyteteve të qëndrueshme, mbrojtja e mjedisit dhe klimës, si dhe forcimi i partneriteteve globale për zhvillim.

Ndër këto objektiva, OZHQ 1 – “Zhdukja e varfërisë në të gjitha format dhe kudo” ka një rëndësi themelore, pasi përbën gur themeli për arritjen e të gjithë objektivave të tjerë. Ky objektivi përbëhet nga 7 synime dhe 13 indikatorë matës që lidhen me: eliminimin e varfërisë ekstreme (nën 1.90 USD/ditë), reduktimin e varfërisë relative, garantimin e sistemeve kombëtare të mbrojtjes sociale për të gjithë, rritjen e qasjes së barabartë në shërbime bazë dhe forcimin e qëndrueshmërisë së grupeve të prekshme përballë krizave ekonomike, shëndetësore apo klimatike⁵.

Shqipëria, si vend anëtar i OKB-së, është angazhuar për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm që prej miratimit të tyre. Ky angazhim nënkupton përfshirjen e objektivave në strategjitë dhe dokumentet politike kombëtare, raportimin periodik mbi zbatimin e tyre dhe përshtatjen e indikatorëve të matjes së progresit. Në vitin 2018, Shqipëria paraqiti Raportin Vullnetar Kombëtar (VNR)⁶ pranë OKB-së, si pjesë e procesit global të vlerësimit të zbatimit

¹ Organizata e Kombeve të Bashkuara (2015). *Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development*. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së. <https://www.un.org/sustainabledevelopment/poverty/>

² INSTAT (2024). Matja e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2024. Instituti i Statistikave, Shqipëri

³ INSTAT *Censi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri 2023 – Rezultatet Kryesore*. Tiranë: INSTAT, 2024

⁴ Organizata e Kombeve të Bashkuara (2015). *Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development*. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së. <https://www.un.org/sustainabledevelopment/poverty/>

⁵ UN Statistics Division – “Global indicator framework for the Sustainable Development Goals” https://unstats.un.org/sdgs/indicators/indicators-list/?utm_source

⁶ Qeveria e Shqipërisë (2018) Raporti Vullnetar Kombëtar mbi Zbatimin e OZHQ ve.

https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/20018ALBANIA_VNR_2018_FINAL.pdf

të OZHQ-ve, dhe ka vijuar të përshtasë politikat e saj ekonomike e sociale me këto standarde ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij objekti dhe ndjeshmërinë e temës së varfërisë, Nënkomisioni Parlamentar ka kërkuar zhvillimin e një auditimi të posaçëm performance për OZHQ 1 nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me qëllim vlerësimin e efektivitetit të përpjekjeve të institucioneve shqiptare në reduktimin e varfërisë dhe përmbushjen e objektivave të dakorduara ndërkombëtarisht. Kjo kërkesë vjen në një moment kur sfidat sociale janë thelluar, si pasojë e krizave të njëpasnjëshme – të pandemisë, inflacionit, rritjes së kostove të jetesës dhe migrimit të vazhdueshëm – të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në strukturën sociale dhe ekonomike të vendit.

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat qeveritare po veprojnë në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit, dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm.

Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka vendosur auditimin e performancës si një nga shtyllat moderne të zhvillimit institucional. Në Planin Strategjik 2023-2027, KLSH e ndërton misionin e vet si institucion i pavarur kushtetues, duke qenë partner strategjik i Kuvendit, i qytetarit shqiptar dhe palëve të interesit, duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Synimi i KLSH-së në auditimin e performancës është përmirësimi i eficiencës dhe efektivitetit në shërbimet publike që i ofrohen taksapaguesit shqiptar, duke ekonomizuar njëkohësisht përdorimin e fondeve publike. Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet, nga pushteti qendror dhe lokal e nga njësi të tjera publike, si dhe nxitja e përgjegjshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me direktivat e praktikat me të mira të BE-së dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, duke kontribuar kështu në mirë qeverisje.

Në përfundim, në linjë edhe me rekomandimet e Progres Raportit dhe Strategjinë institucionale 2023-2027, auditimi i performancës synon parandalimin përmes këshillimit, përpara ndëshkimit përmes penalizimit.

1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka realizuar në vitin 2022 Auditimin e Performancës me temë “*Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm*”, me qëllim vlerësimin e kapaciteteve institucionale për monitorimin, ndjekjen, zbatimin dhe raportimin e progresit lidhur me angazhimet që rrjedhin nga Agjenda 2030. Auditimi është zhvilluar në institucionet përgjegjëse në nivel qendror, Kryeministrinë e Republikës së Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duke mbuluar periudhën 2017–2021.

Gjatë auditimit u identifikuan mangësi të rëndësishme që lidhen me nivelin e ulët të harmonizimit të politikave sektoriale me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm; mungesën e një udhërrëfyese të qartë për zbatimin e OZHQ-ve; mungesën e strukturave të dedikuara për koordinimin dhe raportimin; si dhe dobësi në lidhjen midis objektivave të zhvillimit dhe planifikimit buxhetor të institucioneve përgjegjëse. U evidentua gjithashtu se dokumentet strategjike si Raporti mbi Integrimin e OZHQ-ve nëpërmjet SKZHI dhe Raporti i Harmonizimit me politikat sektoriale nuk ofronin udhëzime të mjaftueshme për institucionet, duke vështirësuar monitorimin dhe raportimin e progresit.

Në përfundimet e auditimit, KLSH thekson nevojën për forcimin e strukturave ndërinstitucionale, përmirësimin e kornizës metodologjike dhe ligjore, si dhe ndërtimin e mekanizmave të qartë dhe funksionalë për matjen dhe raportimin e progresit në kontekstin e OZHQ-ve. Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim përmirësimin e qeverisjes institucionale në raport me angazhimet për zhvillim të qëndrueshëm dhe rritjen e transparencës në veprimtarinë shtetërore.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Në kuadër të auditimit për OZHQ 1 – *Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj*, janë përzgjedhur për auditim institucionet që kanë rol në hartimin e politikave, zbatimin e programeve sociale, ofrimin e shërbimeve bazë për shtresat vulnerabël dhe monitorimin e treguesve të varfërisë. Përfshirja e tyre në auditim është e domosdoshme për të vlerësuar kontributin institucional në arritjen e objektivit për reduktimin e varfërisë. Subjektet nën auditim janë:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS)⁷ ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive në sektorin e kujdesit shëndetësor dhe mbrojtjes sociale. Në kuadër të OZHQ 1, ministria ka rol kryesor në zbatimin e programeve të ndihmës ekonomike, mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara, shërbimeve sociale për familjet dhe komunitetet në nevojë. Përmes këtyre politikave, MSHMS kontribuon drejtpërdrejt në uljen e varfërisë dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël.

Observimi i subjektit: Me anë të shkresës nr. 843/1 prot., datë 11.03.2026, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka përcjellë komentet dhe observimet lidhur me projekt-raportin e auditimit, protokolluar në KLSH nr. 589/20 prot., datë 17.03.2026, si mëposhtë: Mbështetur në vendimin nr. 515, datë 25.09.2025 të Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale*”, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nuk ka në fushën e përgjegjësisë së saj shtetërore subvencionet e qerasë dhe strehimit social, pasi këto çështje janë në fushën e përgjegjësisë së MEI. “

Qendrimi i grupit të auditimit: *Observimi i MSHMS është marrë në konsideratë.*

Ministria e Financave (MF)⁸ - është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave makroekonomike, fiskale dhe buxhetore të vendit. Ajo mbulon administrimin e të ardhurave dhe të buxhetit të shtetit, menaxhimin e financave publike dhe kontrollin financiar. Në kuadër të OZHQ 1 – *Zhdukja e Varfërisë*, Ministria e Financave ka një rol të drejtpërdrejtë përmes planifikimit, ndarjes dhe monitorimit të fondeve buxhetore për programet sociale dhe mbrojtjen e shtresave vulnerabël. Kjo ministri siguron që politikat fiskale dhe buxhetore të lidhen me prioritetet e qeverisë për uljen e varfërisë dhe rritjen e përfshirjes sociale. Pas ristrukturimit të vitit 2024, Ministria e Financave mbajti përgjegjësitë fiskale, buxhetore dhe financiare, duke siguruar që politikat fiskale dhe buxhetore të lidhen me prioritetet e qeverisë për uljen e varfërisë dhe rritjen e përfshirjes sociale.

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI)^{9,10} - është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e zhvillimit ekonomik, inovacionit dhe punësimit. Në

⁷ Vendim Nr.609, datë 20.10.2021 “*Për Përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*”.

⁸ VKM-së nr. 31, datë 17.01.2024 “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Financave*”, pika 3 dhe

⁹ Vendim nr. 30, datë 17.1.2024 “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit*”,

¹⁰ më parë Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit – MEKI

kuadër të OZHQ 1, ajo luan një rol kyç nëpërmjet politikave aktive të punësimit, zhvillimit të aftësive dhe nxitjes së sipërmarrjes, duke synuar uljen e varfërisë përmes rritjes së mundësive për punësim të qëndrueshëm. Përmes masave të saj, ministria kontribuon në forcimin e kapaciteteve të fuqisë punëtore, mbështetjen e inovacionit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme, si dhe përfshirjen sociale të shtresave në nevojë. Pas ristrukturimit të vitit 2024, MEI mori kompetencat që më parë i përkisnin ish-Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në fushën e punësimit, politikave ekonomike dhe zhvillimit social.

Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC)¹¹

- është një institucion qendror në varësi të Kryeministrit, me përgjegjësi për programimin strategjik dhe koordinimin e ndihmës së huaj. Ajo siguron mbështetje metodologjike dhe teknike për hartimin e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, monitoron zbatimin e tyre dhe kujdeset që ato të jenë në përputhje me prioritetet kombëtare të zhvillimit. Në lidhje me OZHQ 1, SASPAC luan një rol të rëndësishëm duke orientuar ndihmën e huaj dhe fondet zhvillimore drejt reduktimit të varfërisë, përfshirjes së grupeve vulnerabël dhe përmirësimit të kushteve sociale. Gjithashtu, ajo kontribuon në harmonizimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim me strategjitë sektoriale, duke garantuar koherencë dhe mbështetje financiare për politikën që lidhen me uljen e varfërisë.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC)¹² është institucioni shtetëror përgjegjës për koordinimin, drejtimin teknik dhe menaxhimin e mbrojtjes civile dhe zvogëlimin të riskut nga fatkeqësitë. Ajo harton dhe monitoron dokumente të tilla si Plani Kombëtar për Emergjencat Civile dhe strategjitë për zvogëlimin e riskut, bashkërendit aktivitetet ndër-institucionale dhe bashkëpunon me autoritetet vendore si bashkitë dhe prefekturat për zbatimin e masave parandaluese dhe përgatitjen për emergjencën.

Instituti i Statistikave (INSTAT)¹³, është institucioni qendror për prodhimin e statistikave zyrtare në Shqipëri. Ai ka për detyrë të sigurojë statistika të sakta, transparente dhe të paanshme për zhvillimet ekonomike e sociale në vend. Në kuadër të OZHQ 1 – Zhdukja e Varfërisë, INSTAT prodhon dhe publikon të dhëna të detajuara mbi të ardhurat, kushtet e jetesës dhe varfërinë monetare e jo-monetare, përmes anketave të posaçme si Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF) dhe Anketa e të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës (SILC). Ai siguron tregues të përditësuar mbi shpërndarjen e të ardhurave, nivelin e varfërisë dhe përjashtimit social, duke u bërë bazë për planifikimin e politikave publike dhe vlerësimin e ndikimit të tyre në uljen e varfërisë. INSTAT organizon dhe zbaton gjithashtu Censin e Popullsisë dhe Banesave¹⁴, i cili ofron të dhëna të plota për strukturën demografike, socio-ekonomike dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë – të gjitha me rëndësi për hartimin dhe monitorimin e politikave që lidhen drejtpërdrejt me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Bashkitë Durrës dhe Elbasan¹⁵, janë njësi bazë të vetëqeverisjes vendore, përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale, programeve të strehimit dhe kujdesit shoqëror për komunitetet

¹² VKM nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”, si dhe Urdhri i Kryeministrit nr. 27, datë 3.2.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”, si strukturë përgjegjëse për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

¹³ Ligji nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare”, neni 14.

¹⁴ Ligji nr. 140/2020 “Për Censin e popullsisë dhe të banesave”, neni 2.

¹⁵ Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 121/2016, datë 24.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 22/2018, datë 13.4.2018 “Për strehimin social

lokale. Në kuadër të OZHQ 1 – Zhdukja e Varfërisë, ato kanë rol thelbësor në identifikimin dhe asistencën e familjeve vulnerabël, ofrimin e shërbimeve për të moshuarit, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe në zbatimin e programeve të strehimit social, duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e varfërisë dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve

2.2 Baza ligjore dhe kriteret e tjera që rregullojnë çështjen nën auditim

Baza ligjore kryesore që rregullon aktivitetin e subjektit lidhur me çështjen nën auditim që do të jetë burimi i kriterëve të auditimit.

Kriteret politike

- Rezoluta e OKB Nr.71/313 “Work of the Statistical Commission pertaining to the 2030 Agenda for Sustainable Development”
- Rezoluta e OKB Nr.70/1 “Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development, 25 shtator 2015
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2022
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2022-2030
- Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030
- Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030
- Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030

Kriteret teknike

- Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore”
- Ligji Nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr. 22/2018, “Për strehimin social”
- Ligji Nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”
- Urdhri i Kryeministrit nr.63, datë 12.05.2017, “Për ngritjen e Komitetit ndërmnistror për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe zbatimin e Axfordës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm” (ndryshuar me Urdhrin nr.249, datë 12.12.2017)
- Urdhri i Kryeministrit nr.70, datë 22.05.2017, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e udhërrëfyesit për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm”
- Urdhri i Kryeministrit nr.248, datë 28.12.2017, “Për disa ndryshime në urdhrin nr.70, datë 22.05.2017”
- Urdhri i Kryeministrit nr.157, datë 30.12.2021, në përputhje me VKM nr.642, datë 29.10.2021, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës”
- Urdhri i Kryeministrit nr.28, datë 13.03.2023 “Për ngritjen e Komitetit Ndërmnistror për Arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm”
- Urdhri i Kryeministrit nr.76, datë 27.06.2023, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e udhërrëfyesit për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe bashkërendimin e masave përkatëse për zbatimin e Agjendës 2030, të Kombeve të Bashkuara”

Kriteret e monitorimit dhe raportimit

- Raporti mbi harmonizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm me politikat ekzistuese sektoriale, UN Albania, Janar 2018
- Census 2023 ”Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave”.
- Programi i statistikave zyrtare 2022-2026;

- EUROSTAT “Demography of Europe”.¹⁶
- Raporte e monitorimit

Kriteret e tjera/Praktikat më të mira

- Sustainable Development Goal 1: No Poverty
- World Bank: “How Economic Growth in Albania Is Reducing Poverty”
- IDI's SDGs Audit Model (ISAM) 2024
- Tribunal De Contas Spain, “Audit of the system, implementation, monitoring, review and reporting on SDG 5” REPORT NO. 7/2023
- Office of the Auditor General of Canada “Implementing the United Nations’ Sustainable Development Goals”, 2021

2.3 Rëndësia e produkteve të subjekteve

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr. 1 – Zhdukja e varfërisë në të gjitha format – kërkon një angazhim të gjerë institucional, me role të ndara dhe të ndërthurura mes strukturave qendrore të qeverisë. Produktet e hartuara dhe të miratuara nga këto institucione janë themelore për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave dhe masave që synojnë reduktimin e varfërisë. Institucionet kyçe dhe produktet e tyre me rëndësi janë:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS) ka miratuar dhe zbatuar Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020–2023 dhe tashmë 2024–2030, ku janë përcaktuar masa të posaçme për reduktimin e varfërisë dhe përfshirjen sociale. Ministria ka hartuar dhe zbatuar programe të ndihmës ekonomike dhe skemat e mbrojtjes sociale, duke përfshirë reformimin e ndihmës ekonomike me bazë pikëzimi, si dhe zgjerimin e shërbimeve të kujdesit social në nivel vendor. Përmes raporteve të progresit dhe planeve të veprimit, janë gjeneruar të dhëna mbi mbulimin e familjeve përfituese, efektivitetin e masave dhe përdorimin e fondeve buxhetore të dedikuara për mbrojtjen sociale.

Ministria e Financave (MF) ka reflektuar në dokumentet e saj buxhetore masat e qeverisë për reduktimin e varfërisë dhe mbrojtjen sociale, përmes buxhetimit afatmesëm, programeve buxhetore vjetore dhe raporteve fiskale. Në kuadër të reformës së financave publike, janë gjeneruar analiza mbi shpërndarjen e fondeve për skemat e ndihmës ekonomike, pensionet dhe shërbimet e kujdesit social, si dhe mbi ndikimin e tyre në mbështetjen e grupeve vulnerabël.

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) ka ndërmarrë iniciativa dhe programe që lidhen me zhvillimin ekonomik, nxitjen e punësimit dhe përkrahjen e sipërmarrjes, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e varfërisë. Në këtë kuadër, ajo ka hartuar dhe zbatuar Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, që përfshin masa për rritjen e aftësive të fuqisë punëtore, përmirësimin e tregut të punës dhe integrimin e grupeve vulnerabël. Përmes raporteve të progresit, planeve të veprimit dhe statistikave mbi tregun e punës, MEI ka gjeneruar të dhëna mbi efektivitetin e programeve të punësimit aktiv dhe formimit profesional. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) ka zhvilluar plane dhe masa për menaxhimin e emergjencave dhe reduktimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore, të cilat lidhen ngushtë me mbrojtjen e grupeve vulnerabël dhe reduktimin e pasojave sociale e ekonomike që thellojnë varfërinë. Në këtë kuadër, AKMC ka hartuar dhe zbatuar Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile 2020–2030, si dhe plane kombëtare të reagimit ndaj emergjencave. Përmes raporteve të monitorimit dhe statistikave mbi ngjarjet e emergjencave civile, janë gjeneruar të dhëna mbi dëmet ekonomike, ndikimin të familjet e prekura dhe nivelin e mbështetjes së ofruar pas fatkeqësive.

¹⁶ <https://ec.europa.eu/eurostat/web/interactive-publications/demography-2023#ageing-population>


Instituti i Statistikave (INSTAT) ka prodhuar statistika zyrtare që lidhen ngushtë me matjen e varfërisë dhe mirëqenies sociale. Anketa e të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës (SILC), Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF), si dhe Censi i Popullsisë dhe Banesave ofrojnë të dhëna të detajuara mbi të ardhurat, kushtet e jetesës dhe shpërndarjen demografike, duke shërbyer si bazë për raportet periodike mbi varfërinë dhe përjashtimin social.

Bashkitë kanë zbatuar programe strehimi social, kanë administruar ndihmën ekonomike, kanë ofruar shërbime komunitare për fëmijë, të moshuar e persona me aftësi të kufizuara dhe kanë organizuar kurse formimi profesional për punësim të grupeve vulnerabël.

Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), ka kontribuar në përgatitjen e analizave dhe dokumenteve strategjike kombëtare duke përfshirë objektivat e OZHQ 1, ka ofruar mbështetje metodologjike për harmonizimin e strategjive sektoriale me prioritetet për reduktimin e varfërisë dhe ka ndihmuar në koordinimin ndërinstitutional në procesin e planifikimit të politikave që synojnë përfshirjen sociale.

2.4 Pesha në buxhet

Zbatimi i Agjendës 2030 dhe Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) kërkon jo vetëm vullnet politik, por edhe një angazhim të konsiderueshëm financiar nga burime të ndryshme. Financimi për arritjen e OZHQ-ve nuk është detyrim vetëm i qeverisë apo vetëm i buxhetit të shtetit, por procesi mbështetet gjithashtu në donatorë ndërkombëtarë, partnerë zhvillimi, organizata joqeveritare dhe veçanërisht në sektorin privat. Kompleksiteti i strukturës së OZHQ-ve dhe ndërvarësia mes tyre e bëjnë të vështirë, në disa raste edhe të pamundur, llogaritjen e saktë të kostove financiare për secilin objektiv.¹⁷



Burimi: Draft Udhërrëfyese për arritjen e OZHQ (SASPAC), 2025

¹⁷ Draft - Udhërrëfyese për arritjen e Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Shqipëri, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), Qershor 2025

Sipas draftit përfundimtar të Udhërrëfyesit të OZHQ-ve, për periudhën 2016–2024 për përmbushjen e OZHQ-ve në Shqipëri janë shpenzuar rreth 4.12 trilionë lekë, që përfaqësojnë afërsisht 93 % të shpenzimeve totale buxhetore nga burime të brendshme dhe të jashtme.

Brenda këtij kuadri, Objektivi 1 (Zhdukja e varfërisë) zë një peshë të veçantë. Financimi për këtë objektiv ka ardhur në rritje të qëndrueshme, nga rreth 60 miliardë lekë në vitin 2016, në 80 miliardë lekë në vitin 2020, dhe rreth 100 miliardë lekë në vitin 2024. Burimi kryesor i financimit është buxheti i shtetit, ndërsa kontributet nga donatorët ndërkombëtarë dhe burime të tjera mbeten të pjesshme dhe ende të pa detajuara plotësisht.

2.5 Përkufizimet dhe terminologjia

Varfëri ekstreme – Gjendja më e ulët e jetesës, kur individët nuk arrijnë të përmbushin nevojat ushqimore bazë për mbijetesë. (Sipas Bankës Botërore matet me të ardhura nën 2.15 USD/ditë; sipas INSTAT lidhet me pamundësinë për të siguruar ushqimin minimal të nevojshëm).

Varfëri relative – Gjendja kur individit ka më pak burime krahasuar me standardet mesatare të shoqërisë ku jeton.

Vulnerabilitet – Ekspozimi i individëve apo grupeve ndaj rrezikut të varfërisë për shkak të mungesës së burimeve, arsimit, punësimit apo kushteve shëndetësore.

Siguri ekonomike – Gjendja kur njerëzit kanë mjetet e nevojshme për të përmbushur nevojat bazë dhe për të përballuar situata të paparashikuara.

Mbrojtje sociale – Sistemet dhe programet që ofrojnë mbështetje financiare dhe shërbime për individët në situata të pasigurisë ekonomike dhe sociale, përfshirë pensionet, ndihmën sociale dhe sigurimet shoqërore.

Sisteme të qëndrueshme të mbrojtjes sociale – Struktura të dizajnuara për t’u ofruar siguri ekonomike qytetarëve gjatë gjithë jetës, të bazuara mbi kontribute dhe/ose financime publike.

Shërbime sociale – Ndihma dhe mbështetja që ofrohen për të përmirësuar mirëqenien e grupeve në nevojë, si të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, familjet në varfëri, etj.


Politika sociale – Rregullat, programet dhe masat që qeveria ndërmerr për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe për të siguruar mbrojtje ndaj rreziqeve sociale.

Përfshirje sociale – Procesi i sigurimit që të gjithë individët, veçanërisht ata vulnerabël, të kenë mundësi të barabarta në arsim, punësim, shëndetësi dhe vendimmarrje.

Indikatorët e performancës – Masa specifike, të matshme që përdoren për të vlerësuar rezultatet dhe ndikimin e politikave dhe programeve.

Qëndrueshmëria financiare – Aftësia për të siguruar burime financiare afatgjata që mundësojnë vazhdimësinë e politikave dhe shërbimeve pa ndërprerje.

2.6 Skema e analizës së programit



2.7 Feedback-u i subjekteve në fazën studimore

Institucionet e përfshira në auditim, të cilat kanë përgjegjësi për hartimin dhe zbatimin e politikave lidhur me reduktimin e varfërisë dhe me përmbushjen e nën-objektivave dhe indikatorëve të OZHQ 1, paraqitën një sërë dokumentesh që pasqyrojnë aktivitetin e tyre në këtë fushë. Megjithatë, dokumentacioni i dorëzuar ishte shpesh i përgjithshëm dhe nuk përmbante informacion të mjaftueshëm, të strukturuar dhe të përshtatur sipas kërkesave specifike të auditimit.

Kjo ka ndikuar në vonesa dhe ka krijuar nevojën për rikomunikim të vazhdueshëm me subjektet nën auditim, kryesisht përmes shkëmbimeve të njëpasnjëshme me email, për të sqaruar nevojat e auditimit dhe për të kërkuar dokumente plotësuese. Në disa raste, është dashur të ndërhyhet më thellë për të ndihmuar institucionet të kuptojnë kërkesat metodologjike të auditimit, veçanërisht në lidhje me indikatorët e OZHQ nr. 1.

Pavarësisht sfidave, bashkëpunimi me nëpunësit e caktuar ka qenë korrekt dhe është vërejtur një angazhim për të përmbushur kërkesat e auditimit në mënyrë të vazhdueshme gjatë procesit.

3.DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjekteve

Vlerësimi i risqeve ka për qëllim identifikimin dhe analizimin e faktorëve që mund të ndikojnë negativisht në realizimin e objektivave të institucioneve të audituara, duke penguar arritjen dhe zbatimin e Objektivit 1 të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Analiza është mbështetur në shqyrtimin e dokumenteve strategjike, planeve të veprimit, akteve ligjore dhe nënligjore, raporteve të progresit si dhe në informacionin e siguruar nga intervistat me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse.

Ky proces ka evidentuar risqe që lidhen me harmonizimin e politikave, koordinimin ndërinstitutional dhe vertikal, cilësinë dhe disponueshmërinë e të dhënave, sigurimin e burimeve financiare dhe funksionimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit të progresit, të cilat paraqesin rrezik të drejtpërdrejtë për përmbushjen e synimeve të OZHQ 1. Risqet e identifikuara janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Fusha e aktivitetit	Përshkrimi i riskut	Ndikimi që mund të kenë risqet e identifikuara	Niveli i riskut	Pyetja e auditimit
Strategjia kombëtare për OZHQ	Mungesa e një strategjie kombëtare të posaçme për zbatimin e Agjendës 2030 dhe për arritjen e objektivave të OZHQ-ve, e cila të orientojë qartësisht politikat dhe programet sektoriale	Politikat mbeten të fragmentuara dhe të pakoordinuara; mungon drejtimi i unifikuar për reduktimin e varfërisë dhe përmbushjen e OZHQ sipas Agjendës 2030	I lartë	1.1 A janë harmonizuar të gjithë synimet dhe indikatorët e Objektivit 1 të OZHQ me strategjitë dhe programet kombëtare?
Plani i veprimit për zbatimin e OZHQ	Mungesa e një plani të detajuar veprimi për të gjithë treguesit dhe indikatorët e OZHQ-ve, me përcaktim të qartë të baseline, objektivave vjetore, targetit 2030, institucioneve përgjegjëse dhe burimeve financiare për secilin tregues.	Vështirësi në monitorimin e progresit dhe në matjen e rezultateve; rritet rreziku i mosarritjes së targeteve kombëtare.	I lartë	1.1 A janë harmonizuar të gjithë synimet dhe indikatorët e Objektivit 1 të OZHQ me strategjitë dhe programet kombëtare?
Integrimi i indikatorëve të OZHQ1 në strategjitë kombëtare dhe sektoriale	Integrimi i pjesshëm i indikatorëve të OZHQ 1 në strategjitë kombëtare, sektoriale dhe ndërsektoriale, që kufizon harmonizimin e politikave dhe matjen e plotë	Strategjitë sektoriale mund të mos adresojnë nën-objektivat e reduktimit të varfërisë sipas kornizës së indikatorëve të OKB	I lartë	1.1 A janë harmonizuar të gjithë synimet dhe indikatorët e Objektivit 1 të OZHQ me strategjitë dhe programet kombëtare?

	të progresit sipas kornizës së indikatorëve të OKB			
Strukturat e posaçme për ndjekjen e OZHQ	Mungesë ose funksionim jo i plotë i strukturave institucionale të dedikuara brenda ministrive dhe institucioneve përkatëse për ndjekjen, koordinimin dhe raportimin e vazhdueshëm të progresit për OZHQ-të	Koordinim i dobët ndërinstitutional, vonesa në raportim dhe zbatim joefikas i udhërrëfyesit kombëtar.	I lartë	1.2 A kanë funksionuar mekanizmat e koordinimit ndërinstitutional për mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin e progresit të synimeve dhe indikatorëve të Objektivit 1 të OZHQ?
Kapacitetet teknike dhe njerëzore	Kapacitete teknike dhe njerëzore të pamjaftueshme për koordinimin ndërinstitutional, mbledhjen e të dhënave dhe përmbushjen e detyrimeve të raportimit sipas standardeve të OKB-së	Raportime me cilësi të ulët, gabime metodologjike dhe rrezik për mosrespektim të afateve ndërkombëtare.	I lartë	1.2 A kanë funksionuar mekanizmat e koordinimit ndërinstitutional për mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin e progresit të synimeve dhe indikatorëve të Objektivit 1 të OZHQ?
Njohuri të kufizuara të stafit mbi OZHQ	Njohuri të kufizuara të stafit administrativ mbi mekanizmat dhe kërkesat e raportimit për OZHQ-të, duke rrezikuar interpretim jo të saktë dhe zbatim joefektiv të politikave	Zbatim i pasaktë i politikave dhe masave; raportime jo të plota ose jo të sakta.	I lartë	1.2 A kanë funksionuar mekanizmat e koordinimit ndërinstitutional për mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin e progresit të synimeve dhe indikatorëve të Objektivit 1 të OZHQ?
Koordinimi ndërinstitutional	Koordinim i dobët vertikal me njësitë e vetëqeverisjes vendore, që pengon mbledhjen e rregullt të të dhënave dhe zbatimin e masave në nivel lokal	Politika të pamjaftueshme në nivel vendor; humbje informacioni nga burimet lokale.	I lartë	1.2 A kanë funksionuar mekanizmat e koordinimit ndërinstitutional për mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin e progresit të synimeve dhe indikatorëve të Objektivit 1 të OZHQ?
Kuadër financiar dhe buxhetor afatmesëm i paqartë për OZHQ1	Kuadër financiar dhe buxhetor afatmesëm i paqartë dhe i pakoordinuar me kostot e nevojshme për zbatimin e masave të lidhura me OZHQ 1, që rrezikon sigurimin e fondeve të qëndrueshme.	Projekte të pazbatueshme financiarisht; rrezik i ndërprerjes së programeve dhe humbje e besueshmërisë ndërkombëtare.	I lartë	1.3 A janë zbatuar masat dhe veprimet e parashikuara në strategjitë dhe programet kombëtare për realizimin e syimeve dhe indikatorëve të Objektivit 1 të OZHQ?
Mbledhja dhe cilësia e të dhënave	Të dhëna statistikore të paplota dhe jo mjaftueshëm të detajuara në nivel lokal	Pamundësi për të identifikuar nevojat reale; politika jo të targetuara dhe buxhete të pakoordinuara.	I lartë	1.2 A kanë funksionuar mekanizmat e koordinimit ndërinstitutional për mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin e progresit të synimeve dhe indikatorëve të Objektivit 1 të OZHQ?
Sistem elektronik mbi raportimin e të dhënave	Mungesë e një sistemi të unifikuar elektronik për raportimin në kohë të të dhënave dhe për monitorimin e progresit, duke shkaktuar vonesa dhe pasaktësi në	Vonesë në marrjen e vendimeve dhe mungesë transparence; humbje mundësish për ndërhyrje korrigjuese në kohë.	I lartë	1.2 A kanë funksionuar mekanizmat e koordinimit ndërinstitutional për mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin e progresit të

	procesin e ndjekjes së objektivave..			synimeve dhe indikatorëve të Objektivit 1 të OZHQ?
Monitorimi dhe ndjekja e progresit	Raportim jo i plotë mbi përparimin e masave të zbatimit, për shkak të mungesës së sistemeve efektive të grumbullimit të të dhënave në terren.	Progresi i arritur nuk pasqyrohet realisht; vendimmarrja bëhet mbi baza të pasakta; rritet rreziku i mosidentifikimit në kohë të devijimeve nga targetet	I lartë	1.3 A janë zbatuar masat dhe veprimet e parashikuara në strategjitë dhe programet kombëtare për realizimin e syimeve dhe indikatorëve të Objektivit 1 të OZHQ?
Zbatimi i politikave dhe masave sektoriale të lidhura me reduktimin e varfërisë	Zbatim i pjesshëm ose me vonesë i masave të përcaktuara në strategjitë kombëtare dhe sektoriale për arritjen e nën-objektivave të OZHQ 1	Objektivat vjetore dhe targetet e vitit 2030 nuk arrihen sipas afateve; ulje e efektivitetit të programeve	I lartë	1.3 A janë zbatuar masat dhe veprimet e parashikuara në strategjitë dhe programet kombëtare për realizimin e syimeve dhe indikatorëve të Objektivit 1 të OZHQ?

3.2 Objektivat e auditimit

Auditimi me temë “Efektiviteti i masave të ndërmarra në kuadër të Objektivit 1 të OZHQ – Zhdukja e varfërisë në të gjitha format” ka si objektiv kryesor të vlerësojë nëse qeveria shqiptare ka siguruar harmonizimin, monitorimin dhe zbatimin efektiv të Objektivit 1 të OZHQ, me qëllim arritjen e rezultateve të matshme dhe të qëndrueshme në reduktimin e varfërisë. Në këtë kuadër, objektivat specifikë të auditimit janë:

- Të vlerësojë harmonizimin, duke shqyrtuar nëse të gjithë synimet (target) dhe indikatorët e Objektivit 1 të OZHQ janë përshtatur dhe integruar në strategjitë, programet dhe dokumentet e planifikimit kombëtar dhe sektorial, si dhe nëse janë përcaktuar tregues bazë (baseline), objektiva vjetore, objektivi për vitin 2030 dhe përgjegjësitë institucionale për secilin tregues.
- Të vlerësojë funksionimin e mekanizmave të koordinimit dhe monitorimit, duke shqyrtuar nëse strukturat ndër-institucionale dhe procedurat për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave sigurojnë informacion të plotë, të besueshëm dhe në kohë për ndjekjen e progresit të synimeve (target) dhe indikatorëve të OZHQ 1.
- Të vlerësojë zbatimin e masave të planifikuara, duke analizuar nëse veprimet dhe ndërhyrjet e parashikuara në strategjitë dhe programet kombëtare janë realizuar në mënyrë efektive dhe brenda afateve, dhe nëse ato kanë kontribuar në përmbushjen e objektivave të reduktimit të varfërisë.


3.3 Pyetjet e auditimit

Pyetja kresore: A ka siguruar qeveria shqiptare harmonizim, zbatim dhe monitorim efektiv të Objektivit 1 të OZHQ për të arritur rezultate të matshme dhe të qëndrueshme në reduktimin e varfërisë?

1.1A janë harmonizuar të gjithë synimet dhe indikatorët e Objektivit 1 të OZHQ me strategjitë dhe programet kombëtare?

1.2 A kanë funksionuar mekanizmat e koordinimit ndërinstitutional për mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin e progresit të synimeve dhe indikatorëve të Objektivit 1 të OZHQ?

1.3 A janë zbatuar masat dhe veprimet e parashikuara në strategjitë dhe programet kombëtare për realizimin e synimve dhe indikatorëve të Objektivit 1 të OZHQ?



3.4 Fushëveprimi i auditimit

Fushëveprimi i auditimit përfshin institucionet publike që luajnë rol të rëndësishëm në hartimin, financimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave dhe masave që lidhen me reduktimin e varfërisë në të gjitha format. Përmes këtij auditimi synohet të analizohet shkalla e përmbushjes së përgjegjësiwe institucionale në kuadër të Objektivit 1 të OZHQ-ve, duke vlerësuar koherencën midis politikave të hartuara dhe masave të ndërmarra, si dhe efektivitetin operacional të institucioneve për të garantuar mbështetjen e grupeve vulnerabël dhe përfshirjen sociale në mënyrë të qëndrueshme.

Auditimi shtrihet në institucionet përgjegjëse për politikën ekonomike, sociale dhe buxhetore në nivel kombëtar dhe lokal, konkretisht: MF, MEKI, MSHMS, INSTAT, AKMC, SASPAC, Bashkinë Elbasan dhe Bashkinë Durrës. Analiza përfshin ndërveprimin ndërinstitutional, planifikimin dhe alokimin e fondeve për adresimin e varfërisë, mbështetjen për grupet në nevojë, si dhe sistemet e monitorimit të progresit në zbatimin e Objektivit 1.

Auditimi mbulon periudhën 2022–2024 dhe synon të ofrojë një vlerësim gjithëpërfshirës dhe objektiv mbi efektivitetin e politikave dhe masave të ndërmarra, duke identifikuar praktikën pozitive, boshllëqet sistematike dhe rekomandimet për përmirësim në funksion të zhdukjes së varfërisë.

3. SHJTELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT

Pyetja kryesore: A ka siguruar qeveria shqiptare harmonizim, zbatim dhe monitorim efektiv të Objektivit 1 të OZHQ-ve për të arritur rezultate të matshme dhe të qëndrueshme në reduktimin e varfërisë?

MESAZHI I AUDITIMIT

Harmonizimi i *Objektivit 1 të OZHQ-ve* *Zhdukja e varfërisë në të gjitha format* me strategjitë dhe programet kombëtare rezultoi i paplotë, pasi mungon Korniza Kombëtare e Indikatorëve dhe dokumentet ekzistuese nuk sigurojnë lidhje të matshme me politikat. Gjithashtu, Udhërrëfyesi për arritjen e OZHQ-ve ende nuk është miratuar. Mekanizmat e koordinimit ndërinstitutional për mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin e progresit të OZHQ 1 nuk kanë funksionuar. Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar (SIPI) nuk funksionon ndërsa pjesa më e madhe e institucioneve qendrore dhe vendore nuk kanë struktura ose përgjegjës të caktuar për OZHQ-të. Zbatimi i masave për arritjen e Objektivit 1 është pjesërisht efektiv, pasi mbi 40% e popullsisë është në rrezik për të qenë i varfër ose përjashtim social, ndërsa buxheti i alokuar për mbrojtjen sociale në vendin tonë është ndjeshëm më i ulët se mesatarja e vendeve të BE-së. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar progres të qartë, të matshëm dhe të qëndrueshëm drejt arritjes së synimit për t'i dhënë fund varfërisë në të gjitha format e saj deri në vitin 2030.

Lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e auditimit, janë përcjellë komente dhe observime nga katër subjekte në auditim:

- Me anë të shkresës nr. 8527/3 prot., datë 18.02.2026, Ministria e Financave ka përcjellë komentet dhe observimet lidhur me projekt-raportin e auditimit, protokolluar në KLSH nr. 589/17 prot., datë 27.02.2026, trajtuar në gjetjet dhe rekomandimet respektive, në vijim të këtij raporti auditimit.
- Me anë të shkresës nr. 226/2 prot., datë 26.02.2026, protokolluar në KLSH me nr. 589/18 prot., datë 02.03.2026, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit ka shprehur dakordësinë lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e projekt-raportit të auditimit, pa komente ose sugjerime për projekt-raportin.
- Me anë të shkresës nr. 270/2 prot., datë 04.03.2026, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës ka përcjellë komentet dhe observimet lidhur me projekt-raportin e auditimit, protokolluar në KLSH nr. 589/19 prot., datë 06.03.2026, trajtuar në gjetjet dhe rekomandimet respektive, në vijim të këtij raporti auditimit.
- Me anë të shkresës nr. 843/1 prot., datë 11.03.2026, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka përcjellë komentet dhe observimet lidhur me projekt-raportin e auditimit, protokolluar në KLSH nr. 589/20 prot., datë 17.03.2026, trajtuar në gjetjet dhe rekomandimet respektive, në vijim të këtij raporti auditimit.

3.1 A janë harmonizuar të gjithë synimet dhe indikatorët e Objektivit 1 të OZHQ me strategjitë dhe programet kombëtare?

Agjenda 2030 përcakton 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe 169 synime (targets), të cilët mbulojnë sektorë kyç si varfëria, shëndetësia, barazia gjinore, rritja ekonomike e

qëndrueshme, menaxhimi i burimeve ujore dhe reagimi ndaj ndryshimeve klimatike.¹⁸ Për ndjekjen dhe matjen e progresit drejt këtyre synimeve, u krijua Korniza Globale e Indikatorëve, që përmban 234 indikatorë globalë të standardizuar.¹⁹ Këta indikatorë u mundësojnë shteteve të vlerësojnë progresin e tyre, të identifikojnë mangësitë dhe të orientohen drejt politikave më efektive.²⁰ Për të siguruar zbatimin e plotë të këtyre angazhimeve globale në nivel kombëtar, është thelbësore që secili vend të sigurojë harmonizimin ndërmjet synimeve globale dhe prioritetëve të veta të zhvillimit.

Harmonizimi nënkupton përshtatjen e synimeve globale me prioritetet kombëtare, si dhe integrimin e indikatorëve në dokumentet strategjike, politikat sektoriale, planifikimin buxhetor dhe sistemet institucionale të monitorimit. Vlerësimi i nivelit të harmonizimit të synimeve dhe indikatorëve të OZHQ-ve, me strategjitë dhe programet kombëtare është një proces i rëndësishëm për të garantuar që Shqipëria po ndjek një qasje të përafëruar, koherente dhe të matshme me angazhimet e marra në kuadër të Agjendës 2030.

Objekti 1 përfshin 7 synime dhe 13 indikatorë që kërkojnë një bazë të qartë metodologjike, burime statistikore të qëndrueshme dhe struktura efektive koordinimi. Në nivel ndërkombëtar, Korniza Globale e Indikatorëve e miratuar nga OKB siguron standardin e matjes, ndërsa vendet inkurajohen t'i përshtasin këto synime dhe indikatorë në realitetet e tyre kombëtare. Kjo përfshin zhvillimin e kornizave kombëtare të indikatorëve dhe hartimin e mekanizmave të monitorimit që mundësojnë vlerësimin e ecurisë dhe planifikimin e politikave në funksion të zbatimit të qëndrueshëm të Objektivit 1.

Shqipëria ka ndërmarrë një sërë hapash për integrimin e OZHQ-ve në politikat kombëtare, përfshirë krijimin e Komitetit Ndërmarrës²¹ dhe Grupit Ndërinstitucional të Punës për OZHQ-të²² në vitin 2017. Gjithashtu ka përgatitur Raportin të parë të Harmonizimit (2017)²³, ka prezantuar Raportin Kombëtar Vullnetar (VNR)²⁴ në 2018 dhe ka kryer disa rishikime të politikave sektoriale që adresojnë elementë të Objektivit 1. Po ashtu, Kuvendi i Shqipërisë ka riafirmuar angazhimin e tij përmes Rezolutës së vitit 2017, duke theksuar rolin e tij në promovimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e OZHQ-ve.²⁵

Megjithatë, pavarësisht këtyre përpjekjeve fillestare, harmonizimi i synimeve dhe indikatorëve të OZHQ 1 mbetet i pjesshëm, jo i përditësuar dhe metodologjikisht i paqartë, duke treguar nevojën për një kornizë të unifikuar kombëtare, metodologji standarde matjeje dhe koordinim më efektiv ndërinstitucional.

¹⁸ United Nations General Assembly, *Resolution A/RES/70/1: Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development*, 25 September 2015, <https://sdgs.un.org/2030agenda>

¹⁹ Treguesit e OZHQ-ve janë rishikuar disa herë nga Komisioni Statistikor i OKB-së, përfshirë rishikimet kryesore të miratuara në vitet 2020 dhe 2025

²⁰ Global indicator framework for the Sustainable Development Goals and targets of the 2030 Agenda for Sustainable Development <https://unstats.un.org/sdgs/indicators/indicators-list/>

²¹ Urdhri nr. 63, datë 12.05.2017 ndryshuar me Urdhrin nr. 28, datë 13.03.2023 të Kryeministrit “Për ngritjen e Komitetit Ndërmarrës për Arritjen e OZHQ-ve dhe Zbatimin e Agjendës 2030

²² Urdhri i Kryeministrit nr. 70, datë 22.05.2017, ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 76, datë 27.06.2023, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e Udhërrëfyesit për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm si dhe bashkërendimin e masave për zbatimin e Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara”

²³ Albania Report on the Harmonization of Sustainable Development Goals with Existing Sectoral Policies, January 2018. <https://un.org.al/sites/default/files/Albania%20Report%20on%20the%20Harmonization.pdf>

²⁴ Voluntary National Review on Sustainable Development Goals. 23 July 2018. <https://albania.un.org/en/46592-voluntary-national-review-sustainable-development-goals>

²⁵ Kuvendi i Shqipërisë. “Rezolutë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të Shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara” miratuar me 04.12.2017

Shqipëria nuk ka zhvilluar dhe formalizuar një Kornizë Kombëtare të Indikatorëve të OZHQ-ve

Sipas Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara A/RES/71/313, shtetet anëtare duhet të adaptojnë kornizën globale të indikatorëve. Gjithashtu, pritet që ajo të plotësohet me indikatorë kombëtarë, të cilët pasqyrojnë realitetin dhe prioritetet e vendit.²⁶ Po ashtu, Rezoluta A/RES/70/1 thekson përgjegjësinë e çdo qeverie për të përcaktuar synimet dhe indikatorët e saj kombëtarë, në përputhje me kontekstin e zhvillimit dhe nivelin e ambicies që vendi synon të arrijë.²⁷

Megjithëse ka kaluar një dekadë nga miratimi i Agjendës 2030, Shqipëria ende nuk ka adaptuar një Kornizë Kombëtare të Indikatorëve të OZHQ-ve. Institucionet shprehen se kanë zbatuar politika të ndryshme në kuadër të varfërisë, por nuk ka një dokument në të cilin të bëhet lidhja ndërmjet këtyre politikave të ndërmarra dhe synimeve dhe indikatorëve të OZHQ 1. Mungesa e kësaj kornize e bën të vështirë lidhjen e objektivave globale me politikat, programet dhe prioritetet kombëtare. Korniza globale e indikatorëve shërben si referencë, por nuk adreson në mënyrë të plotë specifikat e çdo vendi. Për këtë arsye, praktika ndërkombëtare kërkon nga shtetet që të zhvillojnë korniza të përshtatura me kushtet, kapacitetet statistikore dhe prioritetet e tyre kombëtare.

Hartimi dhe formalizimi i një Kornize Kombëtare të Indikatorëve nuk nënkupton mos matjen e indikatorëve globalë të OZHQ-ve. Indikatorët globalë mbeten korniza e detyrueshme e raportimit dhe krahasimit ndërkombëtar. Korniza kombëtare ka funksion plotësues. Ajo identifikon dhe harton indikatorë shtesë aty ku indikatorët globalë janë të pamjaftueshëm, të papërshtatshëm ose nuk reflektojnë dimensionet specifike të zhvillimit të vendit. Hartimi i saj është thelbësor për matjen dhe monitorimin e progresit kombëtar ndaj OZHQ-ve. Sipas Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) dyzet e dy shtete të saj kanë zhvilluar indikatorë kombëtarë dhe platforma raportimi, me qëllim sigurimin e matjeve më të sakta dhe më të përshtatura me realitetet e tyre kombëtare.²⁸

Referuar praktikave ndërkombëtare, Gjermania është një ndër vendet që ka hartuar dhe miratuar Kornizën Kombëtare të Indikatorëve të OZHQ-ve, të integruar në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Qëndrueshëm.²⁹ Në këtë dokument, Gjermania ka përcaktuar synime dhe indikatorë kombëtarë për secilin objektiv të OZHQ-ve, duke i përshtatur me realitetin social dhe ekonomik të vendit. Për OZHQ 1, për shembull, Gjermania deklaron se ka eliminuar varfërinë ekstreme dhe ka identifikuar vetëm dy indikatorë kombëtarë që matin forma të tjera të varfërisë me rëndësi për kontekstin gjerman. Gjermania ka një platformë *online* të dedikuar për OZHQ-të³⁰, ku paraqitet ecuria e të gjithë indikatorëve globalë për të cilët janë të disponueshme të dhëna, në mënyrë që vendi të jetë i krahasueshëm me vendet e tjera.³¹ Për secilin OZHQ paraqiten gjithashtu edhe indikatorët kombëtarë të përshtatur, të cilët shoqërohen

²⁶ United Nations General Assembly, *Resolution A/RES/71/313: Work of the Statistical Commission pertaining to the 2030 Agenda for Sustainable Development*, 6 July 2017, paragrafi 1.

<https://docs.un.org/en/A/RES/71/313>

²⁷ United Nations General Assembly, *Resolution A/RES/70/1: Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development*, 25 September 2015, paragrafi 55. <https://docs.un.org/en/A/RES/70/1>

²⁸ United Nations Economic Commission for Europe (UNECE), “National indicators for measuring progress with SDGs”, 2024. <https://w3.unece.org/sdg2024/story-17.html>

²⁹ Federal Government of Germany. *German Sustainable Development Strategy – 2021 Update*. Berlin: Press and Information Office of the Federal Government, 10 March 2021, fq 369. <https://www.bundesregierung.de/resource/blob/974430/1940716/8943e3f421a7a0d8bcd06a1cc66e92d0/2021-07-26-gsds-en-data.pdf?download=1>

³⁰ Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë në vitin 2019 lancoi një platformë online për OZHQ-të

³¹ Federal Statistical Office of Germany (DESTATIS). *Indicators of the German Sustainability Strategy*. <https://dns-indikatoren.de/>

me informacion të detajuar mbi përkufizimin, metodologjinë e matjes, objektivat, dhe progresin e arritur.³² Edhe Kanadaja ka hartuar Kornizën Kombëtare të Indikatorëve të OZHQ-ve.³³ Në platformën e dedikuar mbi OZHQ-të (në dizajn e ngjashme me atë të Gjermanisë), paraqet të dhëna si për idikatorët e kornizës globale³⁴ ashtu edhe për indikatorët e kornizës kombëtare.

Në Shqipëri, mungesa e Kornizës Kombëtare të Indikatorëve të OZHQ-ve lidhet me mungesën e një vendimmarrjeje të qartë dhe të formalizuar në nivel qeveritar për përcaktimin e indikatorëve kombëtarë të OZHQ-ve, përtej detyrimit për raportim mbi kornizën globale. Si pasojë, mungesa e Kornizës Kombëtare të Indikatorëve të OZHQ-ve kufizon lidhjen e aktiviteteve dhe masave të ndërmarra në kuadër të luftës kundër varfërisë me objektivin OZHQ 1, duke bërë që këto ndërhyrje të mos përkthehen në tregues të matshëm dhe të krahasueshëm për vlerësimin e progresit real drejt këtij objekti. Harmonizimi mbetet i bazuar në interpretime të veçara institucionale dhe jo qartësisht i faktueshëm.

Shqipëria nuk ka hartuar një plan kombëtar për implementimin e OZHQ-ve

Sipas Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara A/RES/70/1, shtetet anëtare inkurajohen të hartojnë sa më shpejt përgjigje kombëtare të strukturuar dhe ambicioze për zbatimin e Agjendës 2030.³⁵ Po ashtu, rekomandohet që vendet të kryejnë rishikime të rregullta e gjithëpërfshirëse të progresit në nivel kombëtar³⁶, çka e bën të domosdoshme ekzistencën e një dokumenti orientues që përcakton qartë mënyrën e matjes, koordinimit dhe monitorimit të zbatimit të OZHQ-ve. Gjithashtu, theksohet nevoja për forcimin e kapaciteteve statistikore dhe ndërtimin e treguesve bazë (baseline) aty ku mungojnë, për të siguruar matje të besueshme të progresit.³⁷

Pavarësisht këtyre orientimeve ndërkombëtare, në Shqipëria nuk evidentohet një lidhje e qartë e synimeve për çdo OZHQ me synimet kombëtare; indikatorët përkatës; treguesit bazë (baseline); synimet deri në vitin 2030; metodologjitë e matjes; institucionet përgjegjëse; mekanizmat e koordinimit ndërinstitucional; burimet buxhetore të nevojshme; afatet e zbatimit; dhe proceset e monitorimit e raportimit; ashtu siç parashikohet nga praktikat më të mira ndërkombëtare. Mungesa e një lidhje të tillë të qartë e bën të pamundur vlerësimin e nivelit të harmonizimit ndërmjet synimeve dhe indikatorëve globalë dhe politikave kombëtare, duke penguar njëkohësisht monitorimin e progresit. Për më tepër, institucionet nuk i kanë të qarta rolet dhe përgjegjësitë e tyre si për realizimin e indikatorëve, ashtu edhe për raportimin dhe monitorimin e të dhënave.

Praktikat ndërkombëtare tregojnë se pjesa më e madhe e vendeve kanë ndërmarrë masa të rëndësishme për të ndërtuar struktura të tilla. Gjermania ka hartuar një Strategji Kombëtare të Zhvillimit të Qëndrueshëm në vitin 2016, e cila është rishikuar në vitin 2018 dhe përditësuar

³² Federal Statistical Office of Germany (DESTATIS). Indicators of the UN Sustainable Development Goals. <https://sdg-indikatoren.de/en/>

³³ Statistics Canada. *Canadian Indicator Framework for the Sustainable Development Goals – Data Hub*. Government of Canada. <https://sdgcif-data-canada-oddcic-donnee.github.io/>

³⁴ Statistics Canada. *Canada's data on the Sustainable Development Goals – Data Hub*. Government of Canada. <https://sdggif-data-canada-oddcmi-donnee.github.io/>

³⁵ United Nations General Assembly, *Resolution A/RES/70/1: Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development*, 25 September 2015, paragrafi 78. <https://docs.un.org/en/A/RES/70/1>

³⁶ United Nations General Assembly, *Resolution A/RES/70/1: Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development*, 25 September 2015, paragrafi 79. <https://docs.un.org/en/A/RES/70/1>

³⁷ United Nations General Assembly, *Resolution A/RES/70/1: Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development*, 25 September 2015, paragrafi 58. <https://docs.un.org/en/A/RES/70/1>

në vitin 2021, duke reflektuar ndryshimet e nevojshme në objektiva, synime dhe indikatorë.³⁸ Edhe Finlanda në vitin 2022 miratoi strategjinë e re kombëtare mbi OZHQ-të për periudhën 2022–2030.³⁹ Gjithashtu, Finlanda miratoi dhe udhërrëfyesin i cili përbën një plan afatmesëm që përcakton veprimet që vendi duhet të ndërmarrë për arritjen e objektivave të Agjendës 2030.⁴⁰ Po ashtu, Malajzia ka përgatitur një udhërrëfyes për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.⁴¹ Në auditimin e mëparshëm të performancës të kryer nga KLSH mbi zbatimin e OZHQ-ve në Shqipëri, është rekomanduar që edhe Shqipëria të hartojë një strategji të posaçme kombëtare për OZHQ-të, me qëllim forcimin e drejtimit strategjik dhe institucionalizimin e qasjes ndaj zhvillimit të qëndrueshëm. Megjithatë, ky rekomandim nuk është zbatuar.

Shqipëria ka filluar përgatitjen e Udhërrëfyesit për OZHQ-të që në vitin 2017, por deri në vitin 2025 procesi ende nuk është përfunduar. Me Urdhrin nr. 70, datë 22.05.2017, Kryeministri urdhëroi ngritjen e grupit ndërinstitutional të punës për përgatitjen e Udhërrëfyesit për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, me detyrimin që dokumenti të përgatitej brenda vitit 2017.⁴² Auditimi i KLSH-së në vitin 2022 konstatoi se Udhërrëfyesi nuk ishte hartuar dhe rekomandoi përfundimin e tij brenda vitit 2023. Gjashtë vite pas urdhrit të parë, Kryeministri përsëriti kërkesën nëpërmjet Urdhrit nr. 76, datë 27.06.2023, duke ngritur sërish grupin ndërinstitutional të punës duke kërkuar përgatitjen e Udhërrëfyesit brenda vitit 2023.⁴³ Pavarësisht këtyre dy urdhrave të Kryeministrit, Udhërrëfyesi nuk është miratuar.

Grupi ndërinstitutional i punës kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) dhe përfshin anëtarë nga të gjitha ministrat dhe AKSHI. SASPAC, në cilësinë e drejtuesit të grupit, i ka vënë në dispozicion grupit të auditimit një version draft të Udhërrëfyesit, i përgatitur në qershor 2025, por ky dokument nuk është miratuar Këshilli i Ministrave.

Analiza e draft-udhërrëfyesit tregon mangësi në hartimin e tij. Për OZHQ 1, dokumenti paraqet vetëm 5 indikatorë nga 13 indikatorët e e kornizës globale. Për secilin prej tyre jepet vetëm projeksioni për vitin 2030, por nuk shpjegohet se cilat masa do të ndërmerren për arritjen e këtyre projeksioneve dhe nuk përcaktohen institucionet përgjegjëse për secilin indikator. Ky draft i Udhërrëfyesit nuk e kryen funksionin e një plani kombëtar për implementimin e OZHQ-ve pasi nuk përmban elementët e nevojshëm. Gjithashtu, në lidhje me indikatorin 1.2.1 “*Përqindja e popullsisë që jeton nën kufirin kombëtar të varfërisë, sipas gjinisë dhe moshës*”, në draft paraqitet synimi për uljen e tij me 0.3% në vit, duke synuar një nivel prej 20.8% në

³⁸ Federal Government of Germany. German Sustainable Development Strategy – 2021 Update. Berlin: Press and Information Office of the Federal Government, 10 March 2021, fq 369.

<https://www.bundesregierung.de/resource/blob/974430/1940716/8943e3f421a7a0d8bcd06a1cc66e92d0/2021-07-26-gsds-en-data.pdf?download=1>

³⁹ Finnish National Commission on Sustainable Development. Strategy of the National Commission on Sustainable Development 2022–2030 : A prosperous and globally responsible Finland that protects the carrying capacity of nature. <https://julkaisut.valtioneuvosto.fi/items/e3767f70-a9b3-4998-8b95-76070cd3c8ef>

⁴⁰ Finnish National Commission on Sustainable Development. The 2030 Agenda Roadmap of the Finnish National Commission on Sustainable Development. Publications of the Prime Minister’s Office 2022. <https://julkaisut.valtioneuvosto.fi/server/api/core/bitstreams/9130de58-f123-47f5-bede-c68409363f7f/content>

⁴¹ SDG Roadmap for Malaysia: Phase II (2021–2025). Putrajaya: Ministry of Economy, Government of Malaysia, September 2024. https://ekonomi.gov.my/sites/default/files/202409/SDG_Roadmap_for_Malaysia_Phase2_%282021-2025%29_0.pdf

⁴² Urdhri i Kryeministrit nr. 70, datë 22.05.2017, “Për ngritjen e grupit ndërinstitutional të punës për përgatitjen e Udhërrëfyesit për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm”

⁴³ Urdhri i Kryeministrit nr. 76, datë 27.06.2023, “Për ngritjen e grupit ndërinstitutional të punës për përgatitjen e Udhërrëfyesit për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm si dhe bashkërendimin e masave për zbatimin e Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara”

vitin 2030 (21.4% në 2027). Për fëmijët 0–17 vjeç parashikohet një vlerë prej 27.3% në vitin 2030 (27.9% në 2027). Këto parashikime nuk përputhen me të dhënat zyrtare të INSTAT, sipas të cilit treguesi i rrezikut për të qenë i varfër në vitin 2024 është 19.2%, duke pësuar një rënie prej 0.6 pikë përqindje krahasuar me vitin 2023.⁴⁴ Për rrjedhojë, fakti që draft-udhërrëfyeshi parashikon një nivel më të lartë varfërie për vitin 2030 sesa niveli real i vitit 2024 (20.8% kundrejt 19.2%) tregon një mospërputhje domethënëse të të dhënave dhe cenon saktësinë, besueshmërinë dhe koherencën e targeteve të propozuara për indikatorët e OZHQ-ve. Mungesa e një kuadri kombëtar funksional gjithëpërfshirës për zbatimin e OZHQ-ve e lë procesin të paqartë dhe të pakoordinuar, duke penguar harmonizimin me politikat kombëtare dhe duke kufizuar aftësinë e institucioneve për të monitoruar dhe vlerësuar progresin.

Raporti i Harmonizimit i vitit 2017 nuk reflekton kuadrin strategjik aktual

Gjatë viteve 2016–2017 Shqipëria përgatiti një raport mbi harmonizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm me politikat sektoriale ekzistuese.⁴⁵ Ky dokument përfaqëson përpyqjen e parë të strukturuar të vendit për të vlerësuar lidhjen ndërmjet Agjendës 2030 dhe dokumenteve strategjike të periudhës, kryesisht SKZHIE II 2015–2020 dhe strategjive sektoriale në fuqi. Megjithatë, analiza e kryer në raport ka pasur karakter deskriptiv dhe orientues, duke adresuar vetëm përputhshmërinë në nivel objektivash dhe synimesh të përgjithshme. Raporti nuk përcakton indikatorë të matshëm, vlera bazë (baseline), objektiva për vitin 2030, apo mekanizma të raportimit institucional, duke e bërë të pamundur matjen e progresit dhe vlerësimin e implementimit të këtyre synimeve të identifikuara. Gjithashtu dokumenti nuk ka të paraqitur një metodologji të qartë mbi të cilën është mbështetur procesi i vlerësimit të harmonizimit. Edhe raporti MAPS⁴⁶ i vitit 2018 evidentonte se në atë periudhë Shqipëria nuk dispononte mekanizma të konsoliduar për integrimin operacional të OZHQ-ve, mungonin struktura të qarta koordinimi ndërinstitutional, si dhe nuk kishte një lidhje sistematike ndërmjet objektivave globale dhe instrumenteve të planifikimit kombëtar. Kjo do tregon se harmonizimi i parë ishte më shumë një paraqitje orientuese, sesa një proces i plotë integrimi strategjik.

Pas vitit 2017, kuadri strategjik kombëtar ka ndryshuar ndjeshëm. Me miratimin e SKZHIE III 2022–2030, rishikimin e dokumenteve sektoriale dhe orientimin e ri të politikave të zhvillimit ekonomik e social, Shqipëria ka hyrë në një cikël të ri planifikimi që nuk pasqyrohet në analizën e bërë në raportin e harmonizimit të viteve 2016–2017. Për pasojë, raporti i vjetër i harmonizimit nuk përputhet me objektivat dhe prioritetet aktuale kombëtare dhe nuk siguron bazë të vlefshme analitike për integrimin e OZHQ-ve në kuadrin e ri strategjik.

Sipas Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara A/RES/70/1, shtetet anëtare inkurajohen të kryejnë rishikime të rregullta dhe gjithëpërfshirëse të progresit në nivel kombëtar të cilat duhet të përfshijnë kontributet e aktorëve të ndryshëm, përfshirë shoqërinë civile, sektorin privat dhe grupet e interesit, në përputhje me rrethanat, politikat dhe prioritetet kombëtare.⁴⁷ Në praktikën ndërkombëtare, vende si Gjermania dhe Finlanda kryejnë rishikime

⁴⁴ INSTAT. “Matja e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës në Shqipëri, 2024”

<https://www.instat.gov.al/media/gignuadh/aanj-2024.pdf>

⁴⁵ Albania Report on the Harmonization of Sustainable Development Goals with Existing Sectoral Policies, January 2018. <https://un.org.al/sites/default/files/Albania%20Report%20on%20the%20Harmonization.pdf>

⁴⁶ Mainstreaming, Acceleration, and Policy Support for Achieving the Sustainable Development Goals in Albania, 2018. https://www.un.org.al/sites/default/files/MAPS_Report_web.pdf

⁴⁷ United Nations General Assembly, Resolution A/RES/70/1: Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development, 25 September 2015, paragrafi 79. <https://docs.un.org/en/A/RES/70/1>

të objektivave dhe indikatorëve të OZHQ-ve çdo 3–4 vjet, duke siguruar që harmonizimi të pasqyrojë zhvillimet e reja strategjike, institucionale dhe statistikore.

Ndryshe nga këto praktika, Shqipëria nuk ka zhvilluar një rishikim të dytë të harmonizimit që prej analizës fillestare të vitit 2017. Mungesa e një përditësimi periodik ka sjellë që vendi të mos disponojë një dokument të unifikuar harmonizimi që lidh objektivat dhe indikatorët e OZHQ-ve me SKZHIE III 2022–2030 dhe dokumentet sektoriale të përditësuar. Për pasojë, harmonizimi i OZHQ-ve, përfshirë OZHQ 1, vazhdon të mbetet i fragmentuar dhe i bazuar në interpretime të veçuara institucionale. Kjo situatë cenon koherencën e procesit të monitorimit dhe raportimit të progresit dhe e vështirëson matjen e qartë të arritjeve dhe boshllëqeve.

Niveli i harmonizimit të synimeve dhe indikatorëve të OZHQ 1 është i pjesshëm dhe paqartë

Vlerësimi i harmonizimit të synimeve dhe indikatorëve të OZHQ 1 në Shqipëri tregon një situatë të fragmentuar, ku institucionet japin deklaratime të ndryshme mbi nivelin e përafrimit, duke treguar mungesë të një qasjeje të unifikuar kombëtare dhe mungesë të një kornize të përbashkët metodologjike.

Dokumenti i vetëm formal i harmonizimit, i hartuar në vitin 2017, përcaktonte se synimet 1.3, 1.4, 1.a dhe 1.b ishin harmonizuar plotësisht, ndërsa synimet 1.1, 1.2 dhe 1.5 ishin pjesërisht të harmonizuara.⁴⁸ Lidhur me indikatorët e OZHQ 1, raporti i vitit 2017 konstatonte se 7 ishin gati të disponueshëm, 4 ishin të disponueshëm pas më shumë përpjekjesh, 1 pjesërisht i disponueshëm dhe 2 të padisponueshëm. Ky vlerësim i viteve të kaluara përbën ende referencën e vetme kombëtare, megjithëse në praktikë nuk është i përditësuar dhe nuk mbështetet nga një Kornizë Kombëtare e Indikatorëve.

Tabela 1: Synimet dhe indikatorët e OZHQ 1

Objektivi 1. Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj kudo	
Synimet	Indikatorët
1.1 Deri në vitin 2030, zhdukja e varfërisë së skajshme për të gjithë njerëzit në gjithë botën, e matur për njerëzit që jetojnë me më pak se 1.25 dollarë në ditë	1.1.1 Përqindja e popullsisë që jeton nën kufirin ndërkombëtar të varfërisë, sipas gjinisë, moshës, statusit të punësimit dhe vendndodhjes gjeografike (urbane/rurale).
1.2 Deri në vitin 2030, ulja, të paktën deri në 50%, e numrit të burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave që jetojnë në varfëri, në të gjitha përmasat e saj, sipas përkufizimeve kombëtare	1.2.1 Përqindja e popullsisë që jeton nën kufirin kombëtar të varfërisë, sipas gjinisë dhe moshës.
	1.2.2 Përqindja e burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave që jetojnë në varfëri në të gjitha dimensionet e saj, sipas përkufizimeve kombëtare.
1.3 Zbatimi kombëtar i sistemeve të duhura të mbrojtjes sociale dhe masave për të gjithë, duke përfshirë nivelin bazë dhe arritje e mbulimit themelor të të varfërve dhe personave në nevojë deri në vitin 2030.	1.3.1 Përqindja e popullsisë e mbuluar nga sistemet e mbrojtjes sociale, sipas gjinisë, me dallime për: fëmijët, të papunët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, gratë shtatzëna, të sapolindurit, viktimat e aksidenteve në punë dhe grupet e varfra apo të cënueshme.
1.4 Deri në vitin 2030, sigurimi i të drejtave të barabarta për të gjithë burrat dhe gratë,	1.4.1 Përqindja e popullsisë që jeton në familje me akses në shërbime bazë.

⁴⁸ Albania Report on the Harmonization of Sustainable Development Goals with Existing Sectoral Policies, January 2018. Fq 36.
<https://un.org.al/sites/default/files/Albania%20Report%20on%20the%20Harmonization.pdf>

veçanërisht të varfrit dhe të pambrojturit, për burimet ekonomike, si dhe akses te shërbimet bazë, pronësinë dhe kontrollin mbi tokën dhe forma të tjera të pronës, trashëgimia, teknologjitë e reja të përshtatshme dhe shërbimet financiare, përfshirë mikrofinancën	1.4.2 Përqindja e popullsisë adulte që gëzon të drejta të sigurta pronësie mbi tokën, (a) me dokumentacion ligjor të njohur, dhe (b) që e perceptojnë pronësinë e tyre si të sigurt, sipas gjinisë dhe llojit të pronësisë.
1.5 Deri në vitin 2030, ndërtimi i qëndrueshmërisë së të varfërve dhe personave në situata të pambrojtura dhe zvogëlimi i ekspozimit dhe cenueshmërisë së tyre ndaj ngjarjeve ekstreme të lidhura me klimën, goditjet dhe fatkeqësitë e tjera ekonomike, sociale dhe mjedisore, si dhe katastrofat	1.5.1 Numri i vdekjeve, personave të zhdukur dhe personave të prekur drejtpërdrejt si pasojë e fatkeqësive, për çdo 100,000 banorë
	1.5.2 Humbjet ekonomike direkte të shkaktuara nga fatkeqësitë, në lidhje me Produktin e Brendshëm Bruto global (PBB).
	1.5.3 Numri i vendeve që miratojnë dhe zbatojnë strategji kombëtare për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, në përputhje me Kornizën Sendai për Reduktimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë 2015–2030.
	1.5.4 Përqindja e njësive të qeverisjes vendore që miratojnë dhe zbatojnë strategji vendore për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, në përputhje me strategjitë kombëtare.
1.a Sigurimi i mobilizimit domethënës të të ardhurave nga një sërë burimesh, duke përfshirë zgjerimin e bashkëpunimit për zhvillim, në mënyrë që të sigurohen mjete të përshtatshme dhe të parashikueshme për vendet në zhvillim, në veçanti për vendet më pak të zhvilluara, për zbatimin e programeve dhe politikave për t'i dhënë fund varfërisë në të gjitha përmasat e saj	1.a.1 Totali i ndihmës zyrtare për zhvillim (grante) nga të gjithë donatorët që fokusohet në uljen e varfërisë, si përqindje e të ardhurës kombëtare bruto të vendit përfitues
	1.a.2 Përqindja e shpenzimeve totale të qeverisë për shërbime thelbësore (arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale)
1.b Krijimi i kornizave të politikave të shëndosha në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, bazuar në strategjitë e zhvillimit në favor të të varfërve dhe me ndjeshmëri ndaj çështjeve gjinore, për të mbështetur investimin e përshpejtuar tek masat për zhdukjen e varfërisë.	1.b.1 Shpenzime publike sociale me ndikim të drejtpërdrejtë në mbështetjen e të varfërve

Burimi: Global Indicator Framework 2025

Në mungesë të një dokumenti të përditësuar, grupi i auditimit i kërkoi të gjitha institucioneve me përgjegjësi sektoriale të deklarohet nivelin e harmonizimit aktual. Përgjigjet e tyre tregojnë se harmonizimi i OZHQ 1 nuk është konceptuar njësoj nga institucionet, duke krijuar dallime të dukshme ndër-institucionale.

SASPAC, institucioni përgjegjës për koordinimin e OZHQ-ve, deklaroi se aktualisht për OZHQ 1 janë harmonizuar 4 synime dhe 9 indikatorë. Sipas tij, nga 14⁴⁹ indikatorët globalë të OZHQ 1, 9 (64%) janë përshtatur në nivel kombëtar, ndërsa 5 indikatorë dhe 3 synime – konkretisht 1.4, 1.a dhe 1.b – nuk janë të harmonizuara për shkak të mungesës së burimeve statistikore dhe të dhënave në fushat e varfërisë multidimensionale, qasjes në shërbimet bazë dhe ekspozimit ndaj risqeve klimatike. Ndërkohë, raporti i harmonizimit i vitit 2017 jep një panoramë krejt të ndryshme. Pikërisht synimet 1.4, 1.a dhe 1.b, të cilat SASPAC sot i vlerëson si jo të harmonizuara, në këtë raport paraqiten si synime të harmonizuara plotësisht. Ky kontrast midis dy vlerësimeve tregon mungesë të një kornize të unifikuar të harmonizimit.

⁴⁹ Ndryshimi nga 14 indikatorë në vitin 2017 në 13 indikatorë sot lidhet me rishikimet e kornizës globale të OKB-së dhe korrigjimin e klasifikimit, pasi një nga indikatorët e atëhershëm nuk konsiderohet më pjesë e OZHQ 1.

INSTAT, institucioni përgjegjës për statistikat zyrtare kombëtare, deklaroi se publikon të dhëna vetëm për 2 indikatorë nga 13 indikatorët e OZHQ 1, konkretisht indikatorët 1.2.1 dhe 1.2.2, të cilët masin kufirin kombëtar të varfërisë. Pjesa tjetër e indikatorëve nuk ka burime statistikore të disponueshme. Kjo mospërputhje mes deklarimit të SASPAC dhe INSTAT tregon se vlerësimi i harmonizimit nuk është i bazuar në të dhënat empirike të matjes, por në deklarime të përgjithshme institucionale.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS) deklaroi se harmonizimi i synimeve të OZHQ 1 është kryesisht i pjesshëm.

- Për synimin 1.1, MSHMS identifikoi masa të rritjes së përfitimeve të ndihmës ekonomike, por këto masa nuk përbëjnë indikatorë të plotë të varfërisë ekstreme sipas standardeve globale.
- Për synimin 1.2, deklarohet se është “pothuajse plotësisht i harmonizuar”, duke u mbështetur te Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024–2030, megjithëse matjet statistikore varen nga INSTAT.
- Për synimin 1.3 dhe 1.4, MSHMS deklaroi harmonizim të pjesshëm, pasi mbulon vetëm disa programe (ndihmën ekonomike, aftësinë e kufizuar dhe shërbimet sociale), por jo të gjithë komponentët që kërkon korniza globale (sipas përkufizimit të metadatës për secilin indikator).
- Për synimin 1.b, harmonizimi konsiderohet i pjesshëm duke u bazuar vetëm në programet ekzistuese të mbrojtjes sociale.

Deklarimet e MSHMS janë të fokusuar në kontributet e saj funksionale, por nuk ofrojnë një vlerësim të plotë të indikatorëve, duke reflektuar mungesën e një forme të unifikuar raportimi ndërinstitutional.

Observimi i subjektit: Me anë të shkresës nr. 843/1 prot., datë 11.03.2026, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka përcjellë komentet dhe observimet lidhur me projekt-raportin e auditimit, protokolluar në KLSH nr. 589/20 prot., datë 17.03.2026, si mëposhtë: “Sa i takon vlerësimin mbi harmonizimin e synimeve të OZHQ1, harmonizimi duhet të vlerësohet në raport me fushën e kompetencës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Për të gjitha ato komponentë që lidhen me politikat dhe programet në përgjegjësi të Ministrisë, harmonizimi i plotë. Vlerësimi si i “pjesshëm” nuk mund të aplikohet në mënyrë të përgjithshme ndaj MSHMS-së, pasi ai përfshinë edhe elementet që nuk bëjnë pjesë në fushën e përgjegjësisë së saj dhe që mbulohen nga insitucione të tjera përgjegjëse.”

Qendrimi i grupit të auditimit: Krahas vlerësimit të bërë nga grupi i auditimit, në përgjigje të kërkesës për informacion gjatë auditimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka përcjellë nëpërmjet adresës zyrtare të e-mailit nivelin e harmonizimit në lidhje me synimet e sipërpërmendura në fushën e saj të përgjegjësisë, të cilat përputhen me sa paraqitur më lart. Sa më sipër, MSHMS nuk ka paraqitur informacion të ri, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) deklaroi angazhim pjesërisht dhe vetëm në mënyrë të tërthortë për shumicën e synimeve të OZHQ 1.

- Për synimin 1.1, MEI raportoi lidhje të tërthortë përmes Strategjisë së Strehimit Social dhe objektivit për të siguruar strehim për 35,000 familje deri në 2030.
- Për synimin 1.2, MEI deklaroi se nuk është përgjegjëse.

- Për 1.3 dhe 1.5, MEI deklaron rol të pjesshëm përmes masave qeveritare të pensioneve dhe mbështetjes ndaj pensionistëve të prekur nga fatkeqësitë natyrore, por këto masa nuk janë pjesë e ndonjë politike të miratuar sektoriale që lidhet drejtpërdrejt me OZHQ1.
- Për 1.4, 1.a dhe 1.b, MEI identifikon veten jo përgjegjëse ose vetëm tërthorazi të lidhur përmes politikave të punësimit dhe inovacionit.

Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile (AKMC) deklaron se raporton rregullisht për 4 indikatorët e synimit 1.5 (1.5.1, 1.5.2, 1.5.3, 1.5.4) në Platformën e Monitorimit të Kuadrit Sendai. Megjithatë, dy nga këta indikatorë nuk janë pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, dhe strategjia nuk ka objektiva të përcaktuara për vitin 2030.⁵⁰ Kjo krijon një boshllëk të dukshëm midis raportimit të detyrueshëm ndërkombëtar dhe integritimit në politikat kombëtare.

MF ka deklaruar se OZHQ nuk është në fushën e saj të përgjegjësisë.⁵¹

Nga sa më sipër, vlerësimi i harmonizimit të synimeve dhe indikatorëve të OZHQ 1 tregon mungesë koherence ndër-institucionale. Institucionet japin deklarime të ndryshme mbi synimet dhe indikatorët e harmonizuar, të cilat nuk përputhen as me njëra-tjetrën, as me dokumentin e harmonizimit të vitit 2017, duke treguar mungesën e një metodologjie të përbashkët dhe të një kuadri të unifikuar vlerësimi. Për shkak të këtyre mospërputhjeve, nuk është e mundur të përcaktohet qartë sa dhe cilat synime dhe indikatorë të OZHQ 1 janë realisht të harmonizuar, duke e lënë procesin të fragmentuar dhe të pambështetur mbi të dhëna të standardizuara.

Konkluzion 1: Procesi i harmonizimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, dhe veçanërisht i OZHQ 1, nuk ka funksionuar në mënyrë të strukturuar dhe të standardizuar në Shqipëri. Mungesa e zhvillimit dhe formalizimit të një Kornize Kombëtare të Indikatorëve, mungesa e një kuadri metodologjik dhe ndër-institucional të konsoliduar dhe plotësisht funksional, mospërditësimi i dokumentit të harmonizimit të vitit 2017, si dhe vlerësimet e paqarta e të pakonsoliduara mbi shkallën e përafrimit, tregojnë se synimet dhe indikatorët nuk janë të lidhur në mënyrë koherente me kuadrin strategjik kombëtar. Si rezultat, Shqipëria nuk disponon bazën metodologjike, institucionale dhe statistikore të nevojshme për të matur, vlerësuar dhe raportuar progresin drejt arritjes së OZHQ-ve deri në vitin 2030, duke e lënë procesin të fragmentuar, të pakrahueshëm dhe të pambështetur në të dhëna të verifikueshme.

1. Gjetje nga auditimi: Sipas Rezolutës së Kombeve të Bashkuara A/RES/71/313, shtetet anëtare adoptojnë kornizën globale të indikatorëve të OZHQ-ve, e cila parashikohet të plotësohet edhe me indikatorë kombëtarë të zhvilluar nga vetë shtetet, në përputhje me prioritetet dhe rrethanat e tyre kombëtare. Megjithatë, në Shqipëri nuk evidentohet ekzistenca e një kornize të konsoliduar kombëtare që të përcaktojë në mënyrë të qartë lidhjen ndërmjet indikatorëve të OZHQ-ve dhe politikave apo dokumenteve strategjike kombëtare. Institucionet raportojnë se kanë ndërmarrë politika dhe masa për luftën kundër varfërisë, por mungesa e indikatorëve kombëtarë të OZHQ-ve nuk siguron një lidhje të qartë të politikave dhe synimeve kombëtare lidhur me varfërinë në Shqipëri me indikatorët e OZHQ 1. Si rezultat, nuk mund të përcaktohet në mënyrë të qartë se sa dhe në çfarë mase këto politika kontribuojnë në arritjen e objektivave të OZHQ-ve.

⁵⁰ Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, miratuar me VKM nr. 94, datë 22.2.2023 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 dhe Planit të Veprimit

⁵¹ Në përgjigje të intervistës zyrtare, MF ka kthyer përgjigje me emailin e datës 28.10.2025 “Në dijeninë tonë, në Ministrinë e Financave nuk ka një strukturë apo punonjës të dedikuar për ndjekjen e OZHQ, pasi nuk është në fushën e saj të përgjegjësisë”. Gjithashtu edhe në takimet verbale kanë mbajtur të njëjtin qëndrim.

2. Gjetje nga auditimi: Mbështetur në Urdhrin për ngritjen e Komitetit Ndërmnistror për OZHQ-të, ministritë e linjës dhe institucionet qendrore duhet të marrin masa për harmonizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në kuadrin strategjik kombëtar, si dhe për zbatimin dhe monitorimin e Agjendës 2030. Komiteti përbëhet nga disa ministra (përfshirë edhe ministrat e institucioneve subjekt auditimi) dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.

Nga auditimi rezultoi se nuk evidentohet një kuadër metodologjik dhe ndërinstitutional i konsoliduar dhe plotësisht funksional që të përcaktojë në mënyrë të strukturuar mënyrën e implementimit, koordinimit dhe monitorimit të OZHQ-ve në nivel kombëtar. Ndryshe nga sa rezultoi nga praktikat ndërkombëtare të implementimit të Agjendës 2030, në vendin tonë nuk evidentohet një lidhje e qartë ndërmjet synimeve për çdo OZHQ dhe elementeve përkatëse, si: synimet kombëtare, indikatorët, treguesit bazë (*baseline*), synimet deri në vitin 2030, metodologjitë e matjes, institucionet përgjegjëse, mekanizmat e koordinimit ndërinstitutional, burimet buxhetore të nevojshme, afatet e zbatimit, si dhe proceset e monitorimit dhe raportimit.

Sipas Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara A/RES/70/1, shtetet anëtare inkurajohen të zhvillojnë përgjigje kombëtare të strukturuar për zbatimin e Agjendës 2030 dhe të integrojnë synimet e saj në proceset kombëtare të planifikimit dhe politikave publike. Shqipëria ka filluar përgatitjen e Udhërrëfyesit për OZHQ-të që në vitin 2017, por deri në vitin 2025 procesi ende nuk është përfunduar. Me Urdhrin nr. 70, datë 22.05.2017, Kryeministri urdhëroi ngritjen e grupit ndërinstitutional të punës për përgatitjen e Udhërrëfyesit për arritjen e OZHQ-ve, me detyrimin që dokumenti të përgatitej brenda vitit 2017. Gjashtë vite pas urdhrin të parë, Kryeministri përsëriti kërkesën nëpërmjet Urdhrit nr. 76, datë 27.06.2023, duke ngritur sërish grupin ndërinstitutional të punës dhe duke kërkuar përgatitjen e Udhërrëfyesit brenda vitit 2023. Pavarësisht këtyre dy urdhrave të Kryeministrit, Udhërrëfyesi nuk është miratuar. Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, në cilësinë e drejtuesit të grupit të punës, i ka vënë në dispozicion grupit të auditimit një version draft të Udhërrëfyesit të përgatitur në qershor 2025, i cili nuk rezultoi i miratuar nga Këshilli i Ministrave. Nga analizimi i draft-udhërrëfyesit evidentohet se për disa indikatorë të varfërisë, targetet e përcaktuara për vitin 2030 rezultojnë të jenë arritur që në periudhën aktuale, madje në disa raste edhe të tejkaluara, duke ngritur pikëpyetje mbi mënyrën e përcaktimit të tyre dhe aftësinë për të përfaqësuar në mënyrë të besueshme progresin real të arritur nga zbatimi i politikave kundër varfërisë. Ky dokument nuk përmban elementët e nevojshëm për të funksionuar si një instrument operacional për implementimin dhe monitorimin e OZHQ-ve. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 17 – 30 të Raportit të Auditimit).*

3. Gjetje nga auditimi: Gjatë viteve 2016-2017 Shqipëria përgatiti një raport mbi harmonizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm me politikat sektoriale ekzistuese. Ky dokument përfaqëson përpjekjen e parë të strukturuar të vendit për të vlerësuar lidhjen ndërmjet Agjendës 2030 dhe dokumenteve strategjike të periudhës, kryesisht SKZHIE II 2015–2020 dhe strategjive sektoriale në fuqi. Megjithatë, analiza e kryer në raport ka pasur karakter përshkruar dhe orientues, duke adresuar vetëm përputhshmërinë në nivel objektivash dhe synimesh të përgjithshme. Raporti nuk përcakton indikatorë të matshëm, vlera bazë (*baseline*), objektiva për vitin 2030, apo mekanizma të raportimit institucional, duke e bërë të pamundur matjen e progresit dhe vlerësimin e implementimit të këtyre synimeve të identifikuar. Gjithashtu, dokumenti nuk ka të paraqitur një metodologji të qartë mbi të cilën është mbështetur procesi i vlerësimit të harmonizimit. Ky dokument ishte më shumë një paraqitje orientuese e situatës, sesa një proces i plotë integrimi strategjik. Pas vitit 2017, kuadri

strategjik kombëtar ka ndryshuar ndjeshëm. Me miratimin e SKZHIE III 2022–2030, rishikimin e dokumenteve sektoriale dhe orientimin e ri të politikave të zhvillimit ekonomik e social, Shqipëria ka hyrë në një cikël të ri planifikimi që nuk pasqyrohet në analizën e bërë në raportin e harmonizimit të viteve 2016–2017. Për pasojë, raporti i vjetër i harmonizimit nuk përputhet me objektivat dhe prioritetet aktuale kombëtare dhe nuk siguron bazë të vlefshme analitike për integrimin e OZHQ-ve në kuadrin e ri strategjik. Shqipëria nuk ka zhvilluar një rishikim të dytë të harmonizimit që prej analizës fillestare të vitit 2017. Mungesa e një përditësimi periodik ka sjellë që vendi të mos disponojë një dokument të unifikuar harmonizimi që lidh objektivat dhe indikatorët e OZHQ-ve me SKZHIE III 2022–2030 dhe dokumentet sektoriale të përditësuar. Për pasojë, harmonizimi i OZHQ-ve, përfshirë OZHQ 1, vazhdon të mbetet i fragmentuar dhe i bazuar në interpretime të veçuara institucionale. Kjo situatë cenon koherencën e procesit të monitorimit dhe raportimit të progresit dhe e vështirëson matjen e qartë të arritjeve dhe boshllëqeve.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit⁵², në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës⁵³, Institutin e Statistikave dhe aktorë tjerë përkatës, të marrin masat e nevojshme për të siguruar një qasje të unifikuar dhe të koordinuar për harmonizimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Të sigurohet ekzistenca e një kuadri metodologjik dhe ndërinstitutional të strukturuar dhe funksional, i cili të mundësojë përafrimin e synimeve dhe indikatorëve globalë me politikat kombëtare, përfshirë përcaktimin e indikatorëve shtesë kur është e nevojshme, vendosjen e baseline-ve dhe objektiveve të matshme, si dhe lidhjen e tyre me programet dhe burimet buxhetore përkatëse. Gjithashtu, kuadri duhet të përcaktojë metodologji të unifikuar për mbledhjen, përpunimin, raportimin dhe publikimin e të dhënave mbi bazë të metadata-ve të standardizuara, të qartësojë rolet dhe përgjegjësitë institucionale për secilin indikator në të gjitha nivelet e qeverisjes, si dhe të forcojë mekanizmat e koordinimit ndërinstitutional për sigurimin e të dhënave dhe raportimin periodik të progresit.

Brenda vitit 2026 dhe në vazhdimësi

Observimi i subjektit: Me anë të shkresës nr. 270/2 prot., datë 04.03.2025 Agjencia e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) ka përcjellë komentet dhe observimet lidhur me rekomandimin e mësipër, protokolluar në KLSH nr. 589/19 prot., datë 06.03.2026, si: “Në përgjigje të rekomandimit të auditimit, Agjencia e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) vlerëson se procesi i harmonizimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit të OZHQ-ve në Shqipëri është tashmë i adresuar përmes mekanizmave ekzistues të Sistemit të Planifikimit të Integruar të Politikave (SPI) dhe nuk është e nevojshme ngritja e një plani të veçantë paralel për OZHQ-të. Në këtë kuadër, agjencia ka hartuar Udhërrëfyesin Kombëtar për Zbatimin e OZHQ-ve (SDG Roadmap) 2025–2030, i cili është një dokument strategjik dedikuar për OZHQ-të dhe përmbush rekomandimin e auditimit të mëparshëm të vitit 2021 për hartimin e tij. Ky udhërrëfyes është planifikuar të miratohet në 4MI të 2026, përfshirë në PPAP 2026, miratuar me VKM nr. 812, datë 30.12.2025, “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projekteve për vitin 2026”. Udhërrëfyesi do të shërbejë si një dokument strategjik orientues për integrimin e OZHQ-ve në kuadrin kombëtar të politikave dhe garanton lidhjen e tyre të drejtpërdrejtë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 (SKZHIE) dhe strategjitë sektoriale. Referuar

⁵² Këto ministri janë anëtare të Komitetit Ndërmintor për OZHQ-të.

⁵³ Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës drejton Grupin Ndërinstitutional të Punës.

qasjes së auditimit, sipas të cilit OZHQ-të janë detyrë funksionale e institucioneve, vlerësojmë se sqarojmë se arritja e OZHQ-ve është në funksion të zbatimit të politikave sektoriale dhe nuk duhen parë si komponente të tyre.

Lidhur me mungesën e një Kornize Kombëtare të Indikatorëve për OZHQ-të theksojmë se nuk ekziston asnjë detyrim për krijimin e një kornize kombëtare të veçantë për këta indikatorë. Praktika është përdorimi i kornizës globale të tyre, e cila mundëson krahasimin midis shteteve duke synuar në këtë mënyrë maksimizimin e përdorimit. Krijimi i këtyre indikatorëve paralelë do të sillte fragmentim institucional dhe shmangie nga standardet globale pasi çdo institucion do të përdorte tregues të ndryshëm.

Agjencia vlerëson se rekomandimet duhet të jenë të zbatueshme praktikisht dhe në veçanti theksojmë se detajimi i buxhetit për çdo synim dhe indikator të OZHQ-ve nuk është objektiv i sistemit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), i cili lidhet me programe politike dhe jo me indikatorë globalë statistikorë.

Gjithashtu, vërejmë se në raport krahasimet bëhen me vendet e zhvilluara, si p.sh me mesataren e BE-së, etj., ndaj vlerësojmë se do të ishte më mirë që krahasimi të bëhej me vendet e rajonit ose në të njëjtin stad zhvillimi me vendin tonë. Pavarësisht problematikave që hasen, Shqipëria ka kryesisht më përpara krahasuar me këto vende sa i përket qasjes ndaj OZHQ-ve. Në aspektin institucional dhe metodologjik, duhet theksuar se agjencia, edhe pse në mungesë të një strukture të dedikuar për OZHQ-të dhe me kapacitete të kufizuara ka arritur të hartojë Udhërrëfyesin Kombëtar për Zbatimin e OZHQ-ve (SDG Roadmap) 2025–2030 (dokument strategjik) duke garantuar kështu lidhjen e tyre me prioritetet dhe objektivat e përcaktuara në SKZHIE 2022–2030. Gjithashtu, në kuadër të koordinimit ndërinstitutional, agjencia ka organizuar mbi 20 takime teknike dhe ndërinstitutionale, ka ndërtuar një rrjet funksional të pikave të kontaktit, si dhe ka mbështetur përgatitjen e dokumenteve strategjike në përputhje me qasjen e planifikimit të integruar të politikave (SIP) duke garantuar edhe lidhjen e OZHQ-ve me qëllimet dhe objektivat e këtyre dokumenteve strategjike sektoriale.

Sikurse kemi theksuar edhe më lart, koordinimi i politikave dhe prioritetëve kombëtarë realizohet në mënyrë të institucionalizuar përmes SPI-së, ku në nivel politik Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS) (Urdhri nr. 4, datë 11.01.2022 i Kryeministrit) miraton drejtimet strategjike, objektivat dhe prioritetet e strategjive sektoriale, ndërsa në nivel administrativ funksionojnë GMIP-të dhe ekipet tematike (Urdhër nr. 90, datë 01.08.2023 i Kryeministrit) ku ndër të tjera shqyrtojnë edhe raportet e monitorimit të dokumenteve strategjike. Për më tepër, dokumentet kyçe si Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe Integritimit Evropian 2022–2030 dhe Dokumenti i Politikave Prioritare (DPP) sigurojnë përkthimin e prioritetëve afatmesme të qeverisë në objektiva konkrete politike dhe në ndarjen efektive të burimeve financiare, duke reflektuar në mënyrë të integruar edhe synimet e OZHQ-ve, të cilat janë të integruara në ciklin normal të planifikimit strategjik dhe buxhetor.

Në përfundim, agjencia konsideron se rekomandimi për hartimin e një plani të veçantë kombëtar për OZHQ-të duhet të rishikohet në dritën e kuadrit ekzistues institucional dhe strategjik. Funksionet e harmonizimit, zbatimit dhe monitorimit të OZHQ-ve tashmë realizohen përmes Sistemit të Planifikimit të Integruar të Politikave (SIP), ku përfshihen edhe dokumentet strategjike të SKZHIE-së, DPP-së, Udhërrëfyesit për OZHQ-të, si dhe dokumentet strategjike sektoriale. Agjencia vlerëson se një dokument shtesë paralel do të rrezikonte fragmentarizimin e mëtejshëm të SIP dhe nuk do të ishte në përputhje me parimin e integritetit të politikave, që është themelor për qeverisjen strategjike dhe për arritjen efektive të OZHQ-ve.

Qendrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit mori në konsideratë vlerësimet dhe komentet e subjektit. Megjithatë, nga auditimi rezultoi se aktualisht nuk evidentohet një **kuadër metodologjik dhe ndërinstitutional i konsoliduar** dhe plotësisht funksional që të sigurojë lidhjen e qartë ndërmjet synimeve dhe indikatorëve të OZHQ-ve, politikave dhe dokumenteve

strategjike kombëtare, burimeve buxhetore, si dhe mekanizmeve të monitorimit dhe raportimit të progresit, sikurse paraqitur në raportin e auditimit.

Lidhur me argumentin e subjektit se hartimi i Udhërrëfyesit Kombëtar për OZHQ-të përbën zbatim të rekomandimeve të mëparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit, grupi i auditimit vlerëson se dokumenti i vënë në dispozicion është në fazë drafti dhe nuk rezulton i miratuar nga organet përkatëse vendimmarrëse. Gjithashtu, sikurse trajtuar në raport, ndër të tjera, nga analiza e draft-udhërrëfyesit evidentohet se për disa indikatorë të varfërisë, targetet e përcaktuara për vitin 2030 rezultojnë të jenë arritur që në periudhën aktuale, madje në disa raste edhe të tejkaluara, duke ngritur pikëpyetje mbi mënyrën e përcaktimit të tyre dhe aftësinë për të përfaqësuar në mënyrë të besueshme progresin real të arritur nga zbatimi i politikave kundër varfërisë. Për rrjedhojë, në kushtet aktuale, dokumenti nuk mund të konsiderohet si një instrument i konsoliduar për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të OZHQ-ve në nivel kombëtar.

Sa i përket çështjes së përcaktimit të indikatorëve kombëtarë dhe elementëve të tjerë të matjes së progresit, grupi i auditimit vlerëson se ekzistenca e tyre përbën një element thelbësor për monitorimin efektiv të progresit drejt arritjes së OZHQ-ve dhe për sigurimin e një lidhje të qartë ndërmjet politikave publike dhe rezultateve të synuara.

Lidhur me kërkesën e subjektit të audituar për të mos iu referuar mesatares së BE-së në analizat e kryera, grupi i auditimit sjell në vëmendje se krahasimi me mesataren e Bashkimit Evropian përbën një praktikë të konsoliduar në raportimet zyrtare statistikore dhe strategjike, duke shërbyer si referencë për vlerësimin e progresit dhe konvergjencës së vendit drejt standardeve të BE-së. Gjithashtu, të njëjtën praktikë (krahasim me mesataret e BE-së dhe me vende të zhvilluara) përdor edhe INSTAT në raportet e përgatitura lidhur me indikatorët që masin varfërinë në vend.

Në vijim të sa më sipër, observimet e subjektit merren në konsideratë pjesërisht.

Observimi i subjektit: Me anë të shkresës nr. 843/1 prot., datë 11.03.2026, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka përcjellë komentet dhe observimet lidhur me projekt-raportin e auditimit, protokolluar në KLSH nr. 589/20 prot., datë 17.03.2026, si: “*Sa i përket rekomandimeve 1.1, 4.1 dhe 4.2, duhet theksuar se MSHMS nuk ka rol mismëtar për marrjen e iniciative në këto drejtime, por kontribuon në mënyrë institucionale në funksion të mbështetjes së proceseve ndërinstitutionale dhe zbatimit të masave që lidhen me fushën e përgjegjësisë.*”

Qendrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit sjell në vëmendje se, në të tre rekomandimet të cilave i referohet subjekti, KLSH i drejtohet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, në cilësinë e tyre si anëtarë të Komitetit Ndërmintor për OZHQ-të, dhe kërkon angazhim aktiv nga secili prej tyre për marrjen e masave përkatëse. Në këtë kuadër, rekomandimet kërkojnë angazhim aktiv nga të gjitha institucionet anëtare, së bashku me SASPAC, në cilësinë e drejtuesit të Grupit Ndërinstitucional të Punës, për marrjen e masave përkatëse.

Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

3.2 A kanë funksionuar mekanizmat e koordinimit ndërinstitucional për mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin e progresit të nënobjektivave dhe indikatorëve të Objektivit 1 të OZHQ?

Koordinimi ndërinstitucional për mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin e progresit të OZHQ-ve, përfshirë OZHQ 1, përbën një element thelbësor për të siguruar një qasje të harmonizuar, të krahasueshme dhe të besueshme në vlerësimin e progresit të vendit në drejtim të reduktimit të varfërisë. Ky proces kërkon bashkërendim të vazhdueshëm ndërmjet

institucioneve qendrore, strukturave të politikëbërjes, autoriteteve statistikore dhe nivelit vendor, me qëllim sigurimin e informacionit të integruar dhe të standardizuar për indikatorët dhe nënobjektivat përkatës.

Me Urdhrin nr. 63, datë 12.05.2017 ndryshuar me Urdhrin nr. 28, datë 13.03.2023 të Kryeministrit “Për ngritjen e Komitetit Ndërmnistror për Arritjen e OZHQ-ve dhe Zbatimin e Agjendës 2030” është ngritur Komiteti Ndërmnistror për OZHQ-të si strukturë politike përgjegjëse për drejtimin dhe koordinimin e procesit të zbatimit të OZHQ-ve. Komiteti përbëhet nga Ministrat dhe SASPAC në cilësinë e Sekretariatit.

Me Urdhrin nr. 70, datë 22.05.2017, ndryshuar me Urdhrin nr. 76, datë 27.06.2023, të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e Udhërrëfyesit për arritjen e Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm si dhe bashkërendimin e masave për zbatimin e Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara” është ngritur grupi ndërinstitucional i punës, i cili kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) dhe përfshin anëtarë nga të gjitha ministratë dhe AKSHI. Megjithatë, pavarësisht ekzistencës së këtyre mekanizmave formalë, bashkërendimi ndërinstitucional, mbledhja e të dhënave, monitorimi dhe raportimi i progresit të OZHQ-ve në praktikë nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.

Mungon koordinimi ndërinstitucional për implementimin e OZHQ-ve

Nga shqyrtimi i kuadrit institucional dhe bashkëveprimit ndërmjet SASPAC dhe institucioneve përgjegjëse për OZHQ-të, rezulton se mungon koordinimi ndërinstitucional i nevojshëm për implementimin e Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 28, SASPAC, në cilësinë e Sekretariatit të Komitetit Ndërmnistror për Arritjen e OZHQ-ve, ka detyrimin të koordinojë punën ndërmjet Komitetit, institucioneve publike, partnerëve për zhvillim, partnerëve socialë dhe aktorëve të tjerë të interesuar.⁵⁴ Megjithatë, nga analiza e bashkëpunimit ndërmjet SASPAC dhe institucioneve përgjegjëse, përfshirë MSHMS, MF, MEI dhe të tjera të ngarkuara me zbatimin e OZHQ-ve, konstatohet se mekanizmat e koordinimit ndërinstitucional për mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin e progresit të OZHQ 1, nuk kanë funksionuar në mënyrë të rregullt, të dokumentuar dhe të harmonizuar.

SASPAC, në rolin e Sekretariatit të Komitetit Ndërmnistror, duhet gjithashtu të organizojë mbledhjet dhe të paraqesë çështjet për diskutim në bashkëpunim me ministratë dhe aktorët e përfshirë.⁵⁵ Edhe pse SASPAC deklaron se ka zhvilluar disa takime formale dhe teknike,⁵⁶ këto nuk përbëjnë një cikël të strukturuar, periodik dhe të dokumentuar të koordinimit. Takimet nuk janë zhvilluar mbi bazën e një kalendari të miratuar apo procedurash të dakorduara ndërinstitucionale, duke treguar se procesi nuk ka funksionuar në mënyrë të qëndrueshme. Për më tepër, në asnjë prej takimeve nuk janë siguruar minuta takimi, nuk janë dokumentuar diskutimet, vendimmarrjet apo ndjekja e tyre dhe nuk ekzistojnë evidenca që të vërtetojnë procesin e koordinimit ndërmjet institucioneve. Nga takimet e kryera me institucionet subjekt auditimi, pjesa më e madhe e tyre kanë deklaruar se nuk kanë kryer takime me SASPAC lidhur me diskutimin e OZHQ-ve.

⁵⁴ Urdhri nr. 28, datë 13.03.2023 i Kryeministrit “Për ngritjen e Komitetit Ndërmnistror për Arritjen e OZHQ-ve dhe Zbatimin e Agjendës 2030, pika 9/c

⁵⁵ Urdhri nr. 28, datë 13.03.2023 i Kryeministrit “Për ngritjen e Komitetit Ndërmnistror për Arritjen e OZHQ-ve dhe Zbatimin e Agjendës 2030, pika 9/ç

⁵⁶ përfshirë takimin e parë të Komitetit për Zbatimin e OZHQ-ve më 6 qershor 2023, dhe disa takime gjatë periudhës shtator 2024 – shkurt 2025

Sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 76, SASPAC ka rolin e drejtuesit të grupit ndërinstitucional të punës për OZHQ-të dhe ka detyrimin të raportojë periodikisht pranë Kryeministrit për përmbushjen e detyrave, përfshirë: përgatitjen e udhërrëfyesit për arritjen e OZHQ-ve brenda vitit 2023; identifikimin dhe zhvillimin e instrumenteve dhe mjeteve për punën me masat zbatuese sipas afateve të udhërrëfyesit; propozimet për masat zbatuese dhe instrumentet përkatëse sipas afateve të përcaktuara; si dhe bashkërendimin e objektivave dhe treguesve me kuadrin strategjik kombëtar, përmes përgatitjes së raportit bazë të vendit.⁵⁷ Nga verifikimi i kryer, rezulton se SASPAC nuk ka kryer asnjë raportim zyrtar pranë Kryeministrit për informimin mbi ecurinë e këtyre detyrave.

Përveç mungesës së takimeve të strukturuar dhe raportimeve zyrtare, koordinimi ndërinstitucional për OZHQ-të dhe veçanërisht për OZHQ 1 nuk është realizuar për shkak të mungesës së pikave të kontaktit dhe njësive të dedikuara në institucionet përgjegjëse, mungesës së procedurave dhe standardeve të bashkërendimit, mosfunksionimit të Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Projekteve (GMIP) dhe Sistemit të Integruar të Informacionit për Planifikimin (SIPI), si dhe mospërfshirjes së nivelit vendor dhe të INSTAT në procesin e shkëmbimit dhe integritit të të dhënave. Këta faktorë tregojnë se nuk ekziston një mekanizëm funksional dhe i qëndrueshëm bashkërendimi që siguron një proces të sinkronizuar, të dokumentuar, të gjurmueshëm dhe të matshëm për monitorimin dhe raportimin e progresit të OZHQ 1 në nivel kombëtar.

Subjektet e audituara nuk kanë struktura të dedikuara dhe përgjegjësi të përcaktuara për ndjekjen dhe raportimin e OZHQ-ve

Nga analiza e informacionit të marrë nga institucionet qendrore dhe vendore, rezulton se në pjesën më të madhe nuk janë ngritur njësi të dedikuara dhe nuk janë caktuar persona përgjegjës të formalizuar për ndjekjen dhe raportimin e OZHQ-ve, përfshirë OZHQ 1. Mungesa e strukturave funksionale dhe roleve të përcaktuara shkakton paqartësi përgjegjësish, fragmentim, mungesë koordinimi dhe pamundësi për monitorim të qëndrueshëm të progresit. Sipas informacionit të siguruar nga SASPAC, edhe pse Agjencia ushtron funksionin e koordinatorit kombëtar për OZHQ-të, ajo nuk disponon një strukturë të dedikuar formalisht për koordinimin e procesit të mbledhjes, analizimit dhe monitorimit të të dhënave për OZHQ-të. Funksionet përkatëse realizohen brenda Sektorit të SKZHIE-së të Drejtorisë së Programimit Strategjik, e cila në total ka vetëm tetë punonjës, gjë që kufizon kapacitetet institucionale për koordinim ndërinstitucional, përpunim të të dhënave dhe raportim të besueshëm dhe të standardizuar. Pjesa më e madhe e institucioneve të përfshira në auditim nuk kanë përcaktuar struktura apo persona përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e OZHQ-ve.

- MSHMS, gjatë auditimit nuk ka dhënë një përgjigje të qartë lidhur me ekzistencën e një personi përgjegjës për OZHQ 1, ndërsa përgjigjet e dhëna gjatë intervistave kanë qenë jokonkluzive. Pas observimeve mbi projekt-raportin e auditimit është përcjellë shkresa me anë të të cilës është përcaktuar personi përgjegjës për OZHQ-të në MSHMS.
- MF ka deklaruar se nuk ka një strukturë apo punonjës të dedikuar për ndjekjen e OZHQ-ve, përfshirë OZHQ 1, pasi nuk është në fushën e saj të përgjegjësisë.

⁵⁷ Urdhri i Kryeministrit nr. 76, datë 27.06.2023, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e Udhërrëfyesit për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm si dhe bashkërendimin e masave për zbatimin e Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara, pika 4.

- MEI ka deklaruar se ka një strukturë përgjegjëse për raportimin e OZHQ 8 dhe për OZHQ 11, por jo për OZHQ 1.

Observacioni i subjektit: Me anë të shkresës nr. 843/1 prot., datë 11.03.2026, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka përcjellë komentet dhe observimet lidhur me projekt-raportin e auditimit, protokolluar në KLSH nr. 589/20 prot., datë 17.03.2026, si mëposhtë: *“MSHMS gjatë intervistave të kryera ka ofruar informacion të saktë dhe të qartë për sa i përket përgjegjësisë dhe rolit të saj në arritjen e OZHQ 1. Në lidhje me personin përgjegjës për OZHQ 1 në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ju bëjmë me dije se, në zbatim të shkresës nr. 2607/1, datë 14.06.2024, të MSHMS-së, është përcaktuar përfaqësuesi i asaj ministrie sipas shkresës bashkëlidhur.”*

Qendrimi i grupit të auditimit: Gjatë auditimit, në përgjigje të kërkesës për informacion të KLSH-së, nëpërmjet adresës zyrtare të e-mailit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka përcjellë një informacion të përgjithshëm mbi raportimin për OZHQ-të. Megjithatë, pavarësisht kërkesës së grupit të auditimit, nuk është përcjellë informacion lidhur me ekzistencën e një përfaqësuesi të ministrisë për OZHQ-të. Gjithashtu, edhe nëpërmjet shkresës nr. 843/1 prot., datë 11.03.2026, me të cilën subjekti ka paraqitur observimet për projekt raportin e auditimit, nuk është vënë në dispozicion shkresa nr. 2607/1, datë 14.06.2024, e MSHMS-së, ku duhet të ishte përcaktuar përfaqësuesi i ministrisë. Në vijim, pas komunikimeve me MSHMS, kjo shkresë është vënë në dispozicion. **Observacioni merret në konsideratë pjesërisht.**

- AKMC ka deklaruar se nuk ka një strukturë apo person të dedikuar për ndjekjen e OZHQ-ve. Elementë të lidhur me qëndrueshmërinë, uljen e rrezikut dhe mbështetjen e shtresave vulnerabël adresohen përmes politikave dhe programeve të mbrojtjes civile, por jo si pjesë e një mekanizmi të strukturuar për ndjekjen e OZHQ 1.
- Bashkitë Durrës dhe Elbasan kanë konfirmuar se nuk kanë një strukturë apo person përgjegjës të dedikuar OZHQ-ve dhe OZHQ1 në vecanti.

SASPAC deklaron se mungesa e strukturave të posaçme dhe e pikave të kontaktit brenda institucioneve përbën një nga sfidat më të theksuara që pengon ndjekjen e vazhdueshme dhe raportimin sistematik të progresit për OZHQ-të, përfshirë OZHQ 1. Situata e konstatuar tregon se përgjegjësitë institucionale për monitorimin dhe raportimin nuk janë të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe të formalizuar, duke theksuar nevojën për forcimin e organizimit të brendshëm dhe për caktimin e përgjegjësisë të strukturuar për ndjekjen e progresit drejt arritjes së Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Mungon një mekanizëm i unifikuar kombëtar për monitorimin dhe raportimin e OZHQ-ve

Analiza e informacionit të marrë nga institucionet e audituara tregon se procesi i mbledhjes së të dhënave, monitorimit dhe raportimit për OZHQ-të, përfshirë OZHQ 1 zhvillohet pa një strukturë të konsoliduar dhe të standardizuar në nivel kombëtar. Institucionet publike nuk kryejnë raportim periodik dhe nuk prodhojnë raporte të dedikuara për OZHQ-të. Edhe në nivel vendor, bashkitë, ndonëse disponojnë të dhëna të rëndësishme mbi shërbimet sociale dhe ndihmën ekonomike, nuk i përdorin këto burime informacioni për të analizuar apo raportuar progresin lidhur me OZHQ 1, gjë që tregon mungesë të integritetit të komponentit lokal në vlerësimin kombëtar të objektivit. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile raporton në Platformën Sendai të dhëna për katër indikatorët e synimit 1.5 të OZHQ 1, por këto të dhëna nuk integrohen dhe nuk publikohen nga INSTAT në kuadër të raportimit kombëtar të

indikatoreve të OZHQ-ve. Kjo tregon mungesë koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve lidhur me monitorimin dhe raportimin e të dhënave.

Në kuadër të raportimit dhe me qëllim vlerësimin e progresit në zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, vendet hartojnë Rishikimet Kombëtare Vullnetare (VNR), të cilat paraqiten në High-Level Political Forum (HLPF). HLPF është platforma qendrore e Kombeve të Bashkuara për ndjekjen dhe rishikimin e zbatimit të Axhendës 2030.⁵⁸ Çdo vit, nën kujdesin e Këshillit Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC), HLPF mbledh shtetet anëtare, ekspertë dhe aktorë të ndryshëm për të diskutuar progresin, sfidat dhe zgjidhjet në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfshirë prezantimin e VNR-ve që dokumentojnë ecurinë dhe angazhimet e secilit vend. Këto raporte përfaqësojnë mekanizmin kryesor për pasqyrimin e ecurisë, sfidave dhe angazhimeve të çdo vendi në zbatimin e OZHQ-ve dhe shërbejnë si instrument orientues për forcimin e politikave kombëtare dhe koordinimit ndërinstitutional.

Shqipëria ka përgatitur dhe paraqitur VNR-në e saj të parë në vitin 2018.⁵⁹ Së fundmi, më 20 gusht 2025, Misioni i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë pranë OKB-së ka njoftuar zyrtarisht Këshillin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC) se vendi do të paraqesë VNR-në e tij të tretë në HLPF 2026.⁶⁰ Edhe pse deklarohet se do të paraqitet VNR e tretë, deri më sot Shqipëria nuk ka përgatitur një VNR të dytë. Në faqen zyrtare të HLPF, ku paraqiten VNR e raportuara për secilin shtet, rezulton se për Shqipërinë është vetëm VNR e vitit 2018. Si rezultat, mungesa e një mekanizmi të përbashkët dhe të standardizuar për mbledhjen, përpunimin dhe integrimin e të dhënave krijon boshllëqe në koherencën, cilësinë dhe transparencën e informacionit, duke cenuar kështu monitorimin efektiv të progresit kombëtar për OZHQ-të.

Platforma online e OZHQ-ve është e paplotë dhe e papërditësuar për OZHQ 1

INSTAT, si institucioni përgjegjës për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e statistikave zyrtare në nivel kombëtar, ka një rol qendror në sigurimin e të dhënave për indikatorët e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, përfshirë OZHQ 1 që lidhet me reduktimin e varfërisë. Kjo përgjegjësi përforcohet nga parashikimet e Axhendës 2030 të miratuar me Rezolutën A/RES/70/1 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, ku njihet nevoja për forcimin e sistemeve statistikore kombëtare për shkak të mungesës së të dhënave bazë për disa objektiva.⁶¹ Gjithashtu Rezoluta A/RES/70/1 përcakton se korniza globale e indikatorëve duhet të mbështetet në të dhëna të cilësisë së lartë të prodhuara nga sistemet statistikore kombëtare, të miratuara teknikisht dhe të bazuara në prova.⁶² Sipas Departamentit të Statistikave të KB-së, një mekanizëm efektiv monitorimi kërkon një kornizë të fortë indikatorësh dhe të dhënash statistikore, e cila siguron matje të besueshme, informon politikëbërjen dhe garanton llogaridhënie publike.⁶³

⁵⁸ United Nations. High-Level Political Forum on Sustainable Development <https://hlpf.un.org/2026>

⁵⁹ Qeveria e Shqipërisë (2018) Raporti Vullnetar Kombëtar mbi Zbatimin e OZHQ-ve. https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/20018ALBANIA_VNR_2018_FINAL.pdf

⁶⁰ United Nations. Albania Voluntary National Reviews 2026 <https://hlpf.un.org/countries/albania/voluntary-national-reviews-2026>

⁶¹ United Nations General Assembly, Resolution A/RES/70/1: Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development, 25 September 2015, paragrafi 45, <https://sdgs.un.org/2030agenda>

⁶² United Nations General Assembly, Resolution A/RES/71/313: Work of the Statistical Commission pertaining to the 2030 Agenda for Sustainable Development, 6 July 2017, paragrafi 75. <https://docs.un.org/en/A/RES/71/313>

⁶³ UN Statistics Division – “Indicator Framework and Metadata for the Sustainable Development Goals

INSTAT në platformën e OZHQ-ve aktualisht publikon të dhëna vetëm për 2 nga 13 indikatorët e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 1. Ky nivel i kufizuar raportimi tregon një mbulim të paplotë të kërkesave të kornizës së indikatorëve dhe reflekton kontribut të pamjaftueshëm të sistemit statistikor kombëtar në matjen e progresit ndaj OZHQ 1.

Gjithashtu, rezulton se të dhënat e të gjitha OZHQ-ve në faqen zyrtare të INSTAT janë të papërditësuara që nga viti 2022.⁶⁴ Në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2024, INSTAT rekomandohet *“Të vijojë puna për publikimet tematike “Post Census”, me analiza që u përgjigjen nevojave të politikave publike, planifikimit vendor dhe kërkit shkencor, dhe të përditësohet platforma e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm.”*⁶⁵ Pavarësisht rekomandimeve të Kuvendit platforma e OZHQ-ve është e papërditësuar.

Gjithashtu INSTAT nuk ka realizuar takime apo bashkëpunim me institucionet që disponojnë të dhëna administrative për OZHQ 1 dhe nuk ka ndërmarrë veprime për pasurimin e pasaportës së indikatorëve.

Praktikat ndërkombëtare tregojnë një model funksionimi të konsoliduar dhe proaktiv të institucioneve kombëtare të statistikave. Institucioni Kombëtar i Statistikave në Finland udhëheq procesin kombëtar të përpilimit të indikatorëve globalë të OZHQ-ve dhe drejton një grup bashkëpunues teknik që siguron zgjerimin dhe përditësimin e të dhënave statistikore.⁶⁶ Në Francë, Instituti Kombëtar i Statistikave dhe Studimeve Ekonomike (INSEE) koordinon mbledhjen dhe prodhimin e treguesve statistikore dhe shërben si ndërfaqe institucionale me sistemin statistikor të Kombeve të Bashkuara, duke garantuar harmonizim metodologjik dhe raportim të standardizuar.⁶⁷ Në Gjermani, Zyra Federale e Statistikave publikon periodikisht raporte dyvjeçare mbi indikatorët dhe nivelin e arritjes së objektivave dhe ka krijuar një platformë publike transparence që paraqet në mënyrë të plotë treguesit globalë dhe kombëtarë, objektivat dhe të dhënat statistikore përkatëse.⁶⁸ Në këto vende, strukturat përgjegjëse për statistikën ushrojnë role të strukturuar në analizën teknike, interpretimin metodologjik dhe zhvillimin e indikatorëve.

Krahasuar me këto praktika, situata në Shqipëri tregon se roli i INSTAT në sigurimin dhe publikimin e indikatorëve për OZHQ 1 mbetet i kufizuar. Kjo situatë pengon matjen reale të progresit të OZHQ 1 dhe e bën të pamundur verifikimin nëse vendi po afrohet drejt objektivit për zhdukjen e varfërisë në të gjitha format dhe për të gjithë.

Konkluzion 2: Mekanizmat e koordinimit ndërinstitutional për mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin e progresit të OZHQ 1 nuk kanë funksionuar. Komiteti Ndërmnishtor, Grupi Ndërinstitutional i Punës dhe SASPAC nuk kanë operuar me takime periodike, dokumentim, raportim apo ndjekje vendimmarrjesh, ndërsa pjesa më e madhe e institucioneve qendrore dhe vendore nuk kanë struktura ose përgjegjëse të caktuar për OZHQ-të. Mungesa e një sistemi të unifikuar raportimi dhe mbështetjes statistikore, përfshirë mbulimin e kufizuar të indikatorëve nga INSTAT, ka sjellë fragmentim, mungesë koherence dhe pamundësi për të matur dhe raportuar në mënyrë të besueshme progresin drejt reduktimit të varfërisë.

⁶⁴ INSTAT. SDG. <https://www.instat.gov.al/sq/sdgs/>

⁶⁵ Kuvendi i Shqipërisë. “Rezolutë për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikave për vitin 2024” <https://www.instat.gov.al/media/03imydwz/rezolute-2025-10-30-3375.pdf>

⁶⁶ https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/26263VNC_2020_Annex_1_Statistics_Finland.pdf

⁶⁷ <https://www.agenda-2030.fr/en/agenda-2030/monitoring-system/article/indicators-for-monitoring-the-sustainable-development-goals#The-French-version-of-SDG-indicators>

⁶⁸ F1 104

<https://www.bundesregierung.de/resource/blob/974430/1940716/1c63c8739d10011eb116fda1aecb61ca/german-sustainable-development-strategy-en-data.pdf>

4. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i kuadrit institucional dhe bashkëpunimit ndërmjet SASPAC dhe institucioneve përgjegjëse për OZHQ-të, rezultoi se mungon koordinimi ndërinstitucional i nevojshëm për implementimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 28, SASPAC, në cilësinë e Sekretariatit të Komitetit Ndërmnistror për arritjen e OZHQ-ve, ka detyrimin të koordinojë punën ndërmjet Komitetit, institucioneve publike, partnerëve për zhvillim, partnerëve socialë dhe aktorëve të tjerë të interesuar.⁶⁹ Megjithatë, nga analiza e bashkëpunimit ndërmjet SASPAC dhe institucioneve përgjegjëse, përfshirë MSHMS, MF, MEI dhe të tjera të ngarkuara me zbatimin e OZHQ-ve, u konstatua se mekanizmat e koordinimit ndërinstitucional për mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin e progresit të OZHQ 1, nuk kanë funksionuar në mënyrë të rregullt, të dokumentuar dhe të harmonizuar.

SASPAC, në rolin e Sekretariatit të Komitetit Ndërmnistror, duhet gjithashtu të organizojë mbledhjet dhe të paraqesë çështjet për diskutim në bashkëpunim me ministrinë dhe aktorët e përfshirë.⁷⁰ Edhe pse SASPAC deklaroi se ka zhvilluar disa takime formale dhe teknike,⁷¹ këto nuk përbëjnë një cikël të strukturuar, periodik dhe të dokumentuar të koordinimit. Takimet nuk janë zhvilluar mbi bazën e një kalendari të miratuar apo procedurash të dakorduara ndërinstitucionale, duke treguar se procesi nuk ka funksionuar në mënyrë të qëndrueshme. Për më tepër, në asnjë prej takimeve nuk janë siguruar minuta takimi, nuk janë dokumentuar diskutimet, vendimmarrjet apo ndjekja e tyre dhe nuk ekzistojnë evidenca që të vërtetojnë procesin e koordinimit ndërmjet institucioneve.

Sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 76, SASPAC ka rolin e drejtuesit të grupit ndërinstitucional të punës për OZHQ-të dhe ka detyrimin të raportojë periodikisht pranë Kryeministrit për përmbushjen e detyrave, përfshirë: përgatitjen e udhërrëfyesit për arritjen e OZHQ-ve brenda vitit 2023; identifikimin dhe zhvillimin e instrumenteve dhe mjeteve për punën me masat zbatuese sipas afateve të udhërrëfyesit; propozimet për masat zbatuese dhe instrumentet përkatëse sipas afateve të përcaktuara; si dhe bashkërendimin e objektivave dhe treguesve me kuadrin strategjik kombëtar, përmes përgatitjes së raportit bazë të vendit.⁷² Nga verifikimi i kryer, rezultoi se SASPAC nuk ka kryer asnjë raportim zyrtar pranë Kryeministrit për informimin mbi ecurinë e këtyre detyrave.

Përveç mungesës së takimeve të strukturuar dhe raportimeve zyrtare, koordinimi ndërinstitucional për OZHQ-të dhe veçanërisht për OZHQ 1 nuk është realizuar për shkak të mungesës së pikave të kontaktit dhe njësive të dedikuara në institucionet përgjegjëse.

4.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, në cilësinë e anëtarëve të Komitetit Ndërmnistror për OZHQ-të, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës si drejtues i Grupit Ndërinstitucional të Punës, dhe me Institutin e Statistikave, të iniciojnë koordinimin e procesit të mbledhjes së të dhënave, monitorimit dhe raportimit të progresit për OZHQ 1, përmes organizimit të takimeve periodike të planifikuara, me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë, ku të adresohen problematikat, të shqyrtohet ecuria dhe të përcaktohen masat e nevojshme për përmirësim.

Brenda vitit 2026

⁶⁹ Urdhri nr. 28, datë 13.03.2023 i Kryeministrit “Për ngritjen e Komitetit Ndërmnistror për Arritjen e OZHQ-ve dhe Zbatimin e Agjendës 2030, pika 9/c

⁷⁰ Urdhri nr. 28, datë 13.03.2023 i Kryeministrit “Për ngritjen e Komitetit Ndërmnistror për Arritjen e OZHQ-ve dhe Zbatimin e Agjendës 2030, pika 9/ç

⁷¹ përfshirë takimin e parë të Komitetit për Zbatimin e OZHQ-ve më 6 qershor 2023, dhe disa takime gjatë periudhës shtator 2024 – shkurt 2025

⁷² Urdhri i Kryeministrit nr. 76, datë 27.06.2023, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e Udhërrëfyesit për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm si dhe bashkërendimin e masave për zbatimin e Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara, pika 4.

4.2 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, në cilësinë e anëtarëve të Komitetit Ndërmnistror për OZHQ-të, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës si drejtues i Grupit Ndërinstitucional të Punës, të iniciojnë ngritjen dhe formalizimin e strukturave ose pikave të kontaktit dhe personave përgjegjës për ndjekjen, monitorimin dhe raportimin e OZHQ 1, në njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore.

Brenda vitit 2026

Observimi i subjektit: Me anë të shkresës nr. 270/2 prot., datë 04.03.2025 Agjencia e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) ka përcjellë komentet dhe observimet lidhur me rekomandimin e mësipër, protokolluar në KLSH nr. 589/19 prot., datë 06.03.2026, si: *“Lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e auditimit për funksionimin e mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional për mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin e progresit të OZHQ 1, agjencia vlerëson se, sikurse jemi shprehur edhe më sipër, procesi i harmonizimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit të OZHQ-ve, ku përfshihet edhe OZHQ 1, adresohen përmes mekanizmave ekzistues të Sistemit të Planifikimit të Integruar të Politikave (SPI). Në këtë kontekst, agjencia ka organizuar mbi 20 takime teknike dhe ndërinstitucionale, ka ndërtuar një rrjet funksional të pikave të kontaktit, ka mbështetur përgatitjen e dokumenteve strategjike, si dhe të Udhërrëfyesit për OZHQ-të. Agjencia, bazuar në funksionet e saj jep mbështetje metodologjike për institucionet përgjegjëse gjatë hartimit të dokumenteve strategjike, për të mundësuar sigurimin e harmonizimit të politikave sektoriale me objektivat e SKZHIE-së 2022–2030 dhe OZHQ-të, përfshirë OZHQ 1 “Pa varfëri”, duke vlerësuar se procesi i harmonizimit të kësaj OZHQ-je është i konsoliduar në nivel të strategjive sektoriale/ndërsektoriale, ku objektivat dhe masat e të lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kontribuojnë në përmbushjen e synimeve të këtij objekti. Gjithashtu, duhet pasur parasysh se mekanizmat mbështetës të monitorimit strategjik, si GMIP-të dhe sistemi IPSIS, kanë hasur kufizime në funksionimin e tyre, procesi është mbështetur në koordinim manual ndërinstitucional dhe në informacionin e dërguar nga institucionet përkatëse, në kuadër të raportimit të SKZHIE 2022-2030, raport i cili hartohet nga agjencia dhe që reflekton progresin e politikave që kontribuojnë edhe në arritjen e OZHQ-ve. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të theksohet se ngritja e strukturave apo personave që do të jenë përgjegjës për ndjekjen e monitorimit dhe raportimit të OZHQ 1 duhet të bëhet në përputhje me mandatet dhe kapacitetet ekzistuese administrative, duke integruar funksionet e monitorimit të OZHQ-ve në proceset e zakonshme të planifikimit dhe raportimit të politikave sektoriale. Agjencia vlerëson se konstatimet paraqesin disa elemente që do të mund të ndihmonin në përmirësimin e ndjekjes, monitorimit dhe raportimit të OZHQ 1, funksionimi i tyre duhet parë në kuadrin më të gjerë të SPI.”*

Qendrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit ka analizuar në mënyrë të detajuar informacionin e përcjellë nga SASPAC dhe institucionet e tjera gjatë auditimit, të trajtuara gjerësisht në shtjellimin e nëpyetjes audituese nr. 2 në raportin përfundimtar të auditimit. Sa më sipër nuk paraqet informacione apo fakte të reja në lidhje me gjetjet e auditimit, për rrjedhojë, **observacioni nuk merret në konsideratë.**

5. Gjetje nga auditimi: Rezoluta A/RES/70/1 përcakton se korniza globale e indikatorëve duhet të mbështetet në të dhëna të cilësisë së lartë të prodhuara nga institucionet kombëtare të statistikave. INSTAT, si institucioni përgjegjës për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e statistikave zyrtare në nivel kombëtar, ka një rol të rëndësishëm në sigurimin e të dhënave për indikatorët e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, përfshirë OZHQ 1 që lidhet me reduktimin e varfërisë. Për këtë qëllim, INSTAT në faqen e tij zyrtare ka krijuar një platformë

online për OZHQ-të. Megjithatë, rezulton se kjo platformë është e paplotë dhe e pa përditësuar. INSTAT aktualisht publikon të dhëna vetëm për 2⁷³ nga 13 indikatorët e OZHQ 1.

Gjithashtu, rezulton se të dhënat e të gjitha OZHQ-ve në faqen zyrtare të INSTAT janë të papërditësuara që nga viti 2022. Në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2024, Instituti i Statistikave rekomandohet të përditësojë platformën e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm. Pavarësisht rekomandimeve të Kuvendit, platforma e OZHQ-ve është e papërditësuar. Kjo situatë pengon matjen reale të progresit të OZHQ 1 dhe e bën të pamundur verifikimin nëse vendi po afrohet drejt objektivit për zhdukjen e varfërisë në të gjitha format.

5.1 Rekomandimi: Instituti i Statistikave të ndërmarrë masa për të zgjeruar mbledhjen, përpunimin, publikimin dhe përditësimin e të dhënave për një numër më të madh indikatorësh të OZHQ 1, duke përfshirë edhe përdorimin e burimeve administrative dhe bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse sektoriale dhe nivelin vendor, në mënyrë që të sigurohet mbulim i plotë dhe i krahasueshëm i kornizës së indikatorëve, si dhe të mundësohet matja e besueshme e progresit drejt reduktimit të varfërisë në vend.

Brenda vitit 2026

3.3 A janë zbatuar masat dhe veprimet e parashikuara në strategjitë dhe programet kombëtare për realizimin e synimeve dhe indikatorëve të Objektivit 1 të OZHQ?

Fokusi i auditimit në këtë çështje është vendosur mbi masat e ndërmara nga vendi ynë për zbatimin e masave që kontribuojnë në arritjen e targetave kombëtarë të lidhur me Objektivin 1 të OZHQ-ve: *‘T’i japim fund varfërisë në të gjitha format e saj, kudo’*.⁷⁴

Referuar standardit global, varfëria ekstreme do të thotë të jetosh me më pak se 2.16 dollarë amerikanë në ditë⁷⁵. Ky është një përkufizim monetar i varfërisë. Mirëpo, njerëzit të cilët jetojnë në varfëri ekstreme vuajnë një mungesë të qenësishme të aksesit në mundësi dhe shërbime për të përmbushur nevojat bazike të njeriut. Kështu, varfëria (absolute) referuar OKB-së, përkufizohet si gjendja e karakterizuar nga privimi i rëndë i nevojave themelore njerëzore, ku përfshihet ushqimi, uji i pijshëm i sigurt, mjedise të pastra, shëndeti, strehimi, edukimi dhe informimi. Pra, varfëria nuk është vetëm një çështje monetare, por edhe aksesit në shërbime.⁷⁶

OZHQ 1 mban në konsideratë aspektet e shumta të varfërisë dhe vendos theksin jo vetëm tek zhdukja e varfërisë ekstreme por edhe në përgjysmimin e varfërisë në të gjitha format e saj.⁷⁷ Ky objektiv nuk e trajton varfërinë vetëm si mungesë e të ardhurave monetare, por adreson aspektin shumëdimensional të saj, duke përfshirë aksesin në shërbime, mundësitë, punësimin, jetesën me dinjitet, etj.

Në bazën ligjore dhe rregullatore nuk gjendet një përkufizim zyrtar se çfarë do të thotë të jesh i varfër në Shqipëri. Në legjislacionin shqiptar gjejmë përkufizimin e ndihmës ekonomike e cila është *‘mbështetja me para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë’*.⁷⁸ Por, nga ana

⁷³ Indikatorin 1.2.1 – përqindja e popullsisë që jeton nën kufirin kombëtar të varfërisë, e ndarë sipas gjinisë dhe grupmoshës;

Indikatorin 1.2.2 – përqindja e popullsisë në rrezik të varfërisë ose përjashtimit social (AROE).

⁷⁴ <https://www.un.org/sustainabledevelopment/poverty/>

⁷⁵ <https://www.un.org/sustainabledevelopment/poverty/> ,

⁷⁶ <https://www.un.org/esa/socdev/essd/text-version/agreements/poach2.htm>

⁷⁷ https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=SDG_1_-_No_poverty

⁷⁸ Ligji nr.57/2019 ‘Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar, shkronja k, neni 4.

tjetër, të qenit ‘*individ në nevojë*’ nuk lidhet drejtpërdrejtë me varfërinë, pasi përkufizohet si ‘*personi fizik që është jetim, viktimë e trafikimit, viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare*’.⁷⁹ Kontrolli i Lartë i Shtetit ndër vite ka kryer auditime të shumta të cilat kanë pasur fokus të drejtpërdrejtë varfërinë në vendin tonë, apo kanë qenë të lidhur me të, dhe ndër të tjera ka rekomanduar ‘*miratimin e vlerës zyrtare të minimumit jetik*’⁸⁰, duke analizuar në mënyrë të thelluar edhe pasojat ekonomike dhe sociale që lidhen me mungesën e saj.

Megjithëse varfëria ka rënë në dy dekadat e fundit, Shqipëria vazhdon të jetë vendi më i varfër në rajon sipas Bankës Botërore. Të moshuarit dhe anëtarët e grupeve minoritare janë veçanërisht të prekur.⁸¹

Referuar raport-progresit të BE-së për Shqipërinë, në vitin 2024, ‘*Varfëria e fëmijëve mbetet prevalente dhe masat e marra nuk kanë arritur ta trajtojnë atë në mënyrë efektive*’⁸².

Në vijim grupi i auditimit ka analizuar situatën në vendin tonë përsa i përket nën objektivave 1.2, 1.5, 1.a dhe 1.b të OZHQ1, duke synuar që të mbledh të dhëna për indikatorët respektiv të këtyre nën-objektivave, me qëllim për të identifikuar efektivitetin e masave të ndërmarra për arritjen e OZHQ 1.

- 1.2 Deri në vitin 2030, ulja, të paktën deri në 50%, e numrit të burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave që jetojnë në varfëri, në të gjitha përmasat e saj, sipas përkufizimeve kombëtare

1.2.1 Përqindja e popullsisë që jeton nën kufirin kombëtar të varfërisë, sipas gjinisë dhe moshës.
--

1.2.2 Përqindja e burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave që jetojnë në varfëri në të gjitha dimensionet e saj, sipas përkufizimeve kombëtare.

Nga lista e indikatorëve të OZHQ1, të harmonizuar në Shqipëri, rezultojnë dy indikator zyrtarë:

- Indikator 1.2.1 – përqindja e popullsisë që jeton nën kufirin kombëtar të varfërisë⁸³, e ndarë sipas gjinisë dhe grupmoshës;
- Indikator 1.2.2 – përqindja e popullsisë në rrezik të varfërisë ose përjashtimit social (AROPE).

Të dhënat për këto indikator përlllogariten nëpërmjet Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës⁸⁴, rezultatet e të cilës publikohen nga INSTAT, nëpërmjet dy treguesve: “*Rreziku për të qene i varfër*” dhe “*Rreziku për të qenë i varfër dhe përjashtimi social*”.

⁷⁹ Ligji nr.57/2019 ‘*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*’, i ndryshuar, shkronja g, neni 4.

⁸⁰ Raporti i performancës ‘*Varfëria në Shqipëri dhe roli i shtetit në zbutjen e saj*’, KLSH, 2018, fq.34-35.


⁸¹ <https://www.bmz.de/en/countries/albania/social-situation-51920>

⁸² Raport Progressi I BE- për Shqipërinë, 2024, ‘*Të drejtat e fëmijëve*’, fq.40

⁸³ INSTAT: Sipas metodologjisë për matjen e varfërisë, kufiri i rrezikut për të qenë i varfër llogaritet në bazë të konceptit relativ (i varfër në raport me të tjerët) dhe përcaktohet në 60 % të medianës së të ardhurave familjare disponibël të ekuivalentuara për familjet e anketuara, duke përdorur shkallën e ekuivalentuar të modifikuar të OECD, <https://www.instat.gov.al/media/13063/anketa-e-t%C3%AB-ardhurave-dhe-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-silc2022.pdf> fq.8.

⁸⁴ Referrer INSTAT, në vitin 2017 ka ndryshuar metodologjia për matjen e varfërisë në vend, më herët matej varfëria absolute bazuar në shpenzimet e konsumit, ndërsa tani matet varfëria relative bazuar në të ardhurat e familjes. Në vitin 2024 madhësia e kampionit ishte 8,443 familje (njësi ekonomike familjare), prej të cilave i ishin përgjigjur anketës 6,942 familje (njësi ekonomike familjare). Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër është përcaktuar në 60 % të medianës së të ardhurave disponibël të ekuivalentuara të familjeve të anketuara. <https://www.instat.gov.al/media/gignuadh/aanj-2024.pdf>

Grafiku 2: Treguesit Rreziku për të qenë i varfër dhe Rreziku për të qenë i varfër dhe përjashtimi social për periudhën 2022-2024



Burimi: INSTAT Përpunoi: G.A

Nga analizimi i vlerave të treguesve të mësipërm vërehet një trend i qendrueshëm rënës, si në riskun për të qenë i varfër ashtu dhe në riskun për të qenë i varfër dhe në përjashtim social, për periudhën objekt auditimi. Më të detajuara këto rezultate trajtohen në tabelat e mëposhtme, të ndara në bazë gjinie dhe sipas grupmoshave.

Tabela 1: Rreziku për të qenë i varfër sipas grupmoshave dhe gjinisë (në%)

Grupmosha	2023			2024		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
0-17 vjeç	27.1	27.8	27.5	26.4	26.8	26.6
18-64 vjeç	18.9	19.5	19.2	18.4	18.9	18.6
65+	12.5	14.5	13.6	12.8	14.7	13.8
Gjithsej	19.4	20.1	19.8	18.9	19.5	19.2

Burimi: "Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2023 dhe 2024", INSTAT. Përpunoi: G.A

Nga analizimi i të dhënave të mësipërme vërehet se fëmijët janë më të ekspozuar ndaj varfërisë monetare, ndërsa grupmosha 65+ ka një risk më të ulët për të qenë të varfër, me një tendencë të lehtë rritje në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023. Referuar të dhënave të detajuara në bazë të gjinisë, vërehet se në të gjitha moshat, femrat janë më të riskuara për të qenë të varfra se meshkujt. Kjo tregon se pabarazitë gjinore në vendin tonë vazhdojnë të gjenerojnë pozicion me pak të favorshëm socio-ekonomik për gratë.

Tabela 2: Rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social (AROPE-Europa 2030) (%)

Grupmosha	2023			2024		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
0-17 vjeç	47.7	48.3	48.0	43.2	45.2	44.1
18-64 vjeç	38.4	42.5	40.5	38.0	39.0	38.5

65+	43.5	50.7	47.2	40.0	45.4	42.8
Gjithsej	41.2	45.2	43.2	39.4	41.5	40.5

Burimi: "Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2023 dhe 2024" Përpunoi:G.A

Referuar të dhënave të mësipërme, rreziku i varfërisë shumëdimensionale ka rënë në strukturën demografike. Fëmijët vijnë në një kategori më e prekur nga ky risk. Ndërsa vërehet se, megjithëse të moshuarit (65+) ishin categoria me risk më të ulët të varfërisë monetare, për sa i përket riskut të varfërisë shumëdimensionale, ata janë categoria e dytë më e prekur pas fëmijëve, çka tregon se kjo kategori përjeton forma të tjera privimi që nuk shpjegohen vetëm përmes varfërisë monetare.

E megjithëse norma ka rënë, fakti që 40.5% e popullatës janë në risk për të qenë të varfër ose përjashtim social krahasuar me 21% të mesatares së vendeve të BE-së⁸⁵ tregon se Shqipëria ka një përqindje shumë të madhe të familjeve që, përveç problemeve të të ardhurave, vuajnë edhe nga privimet në standardet e banimit, aksesit në ngrohje, ushqim të mjaftueshëm apo nga mungesa e punësimit të qëndrueshëm.

Sikurse do të trajtohet edhe në vijim, në vendin tonë shpenzimet për mbrojtjen sociale për vitin 2024 zinin rreth 9% të PBB ose 31% të totalit të shpenzimeve qeveritare, pesha këto të njëjta me ato të vitit 2013 (për më tepër, aneksi 1). Për vitin 2023 buxheti për mbrojtjen sociale në Shqipëri është më pak se gjysma e mesatares së BE-së (19.2% e PBB-së)⁸⁶.

Për periudhën nën auditim, me qëllim lehtësimin dhe zbutjen e varfërisë, vendi ynë ka pasur në veprim Strategjinë Kombëtare për mbrojtjen sociale 2019-2022 dhe Strategjinë Kombëtare për mbrojtjen sociale 2024-2030. Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë është qëllim strategjik i vendit tonë i formalizuar në Strategjinë 2019-2022⁸⁷. Ky qëllim është i detajuar në 4 nën objektiva, me masat përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre. Në vitin 2023 MSHMS ka publikuar Raportin e Monitorimit të hartuar me mbështetjen e UNICEF, me qëllim për të monitoruar progresin e bërë dhe sfidat në fushën e mbrojtjes sociale, në vendi tonë⁸⁸. Referuar këtij raporti rezultoi se:

- Përqindja e popullsisë së varfër ekstreme që marrin NE e cila synohej të arrinte në masën 100% deri në vitin 2023, është realizuar në masën 62%;
- Përqindja e familjeve NE të jetë përfituese e të gjithë programeve të tjera mbështetëse në raport me totalin e përfituesve, e cila synohej në masën 75%, është realizuar në masën 65%.

Referuar të dhënave të publikuara në raportin e monitorimit, në vitin 2023 janë trajtuar me ndihmë ekonomike mesatarisht 62,000 familje. Numri i familjeve përfituese është ulur në krahasim me vitin 2022, ku janë trajtuar mesatarisht me ndihmë ekonomike deri në 64,000 familje. Në raportin e monitorimit për Strategjinë për Mbrojtjen Sociale të vitit 2023, vërehet se ka informacione lidhur me masat e ndërmarra me qëllim arritjen e qëllimeve strategjike, por nuk ka një analizë të detajuar të arsyeve përse disa prej masave nuk janë arritur, ose janë arritur pjesërisht.

Nga ana tjetër identifikohet se në dokumentet strategjike vendi ynë formalizon politikat për të lehtësuar të varfëritë, por zyrtarisht ka statistika vetëm për rrezikun për të qenë i varfër ose

⁸⁵ <https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-eurostat-news/w/ddn-20240612-1>

⁸⁶ General government expenditure by function (COFOG), Online data code:gov_10a_exp, indikator EU-27.

⁸⁷ Ndërsa në Strategjinë e re ky qëllim është formuluar si: Zbutja e varfërisë për çdo individ në nevojë dhe përmirësimi i jetesës për personat me Aftësi të Kufizuara nëpërmjet skemave financiare të përshtatshme, të përgjigjshme gjinore, transparente për fuqizim dhe integritet, të afta për përballimin e rreziqeve e krizave.

⁸⁸ Raporti i monitorimit të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale, 2023, fq. 4 Raporti-i-Monitorimit-te-Strategjise-se-Mbrojtjes-Sociale-Viti-2023.docx.

përrjashtim social. “Minimumi jetik është e vetmja “rrjet sigurie” e testuar, brenda arkitekturës së shtetit të mirëqenies, e cila nuk synon vetëm individët në moshë pune, por përfshin edhe të moshuarit.”⁸⁹ Krahas rekomandimit të KLSH-së për miratimin e vlerës zyrtare të minimumit jetik⁹⁰, vërehet se një numër i konsiderueshëm i organizmave kombëtare dhe ndërkombëtare kanë theksuar nevojën e minimumit jetik për të garantuar një jetesë me dinjitet për shqiptarët. Në raportin e Avokatit të Popullit, UNDP-së, dhe Ambasadës Norvegjeze në vitin 2021 për vendin tonë, theksohet se: “mungon përkufizimi i minimumit jetik në legjislacionin për mbrojtjen sociale, gjë që ndikon në hartimin e politikave për mbrojtjen sociale, sidomos në përcaktimin e qartë të qëllimit të tyre.”⁹¹ Për më tepër, në raportin e Komitetit Evropian të Drejtave Sociale për Shqipërinë në vitin 2022, merret e mirëqene se qeveria duhet të garantojë minimumin jetik dhe se paga minimale nuk duhet të bjerë nën këtë nivel “Komiteti kërkon që Shqipëria të tregojë se paga e mbrojtur, d.m.th. pjesa e pagës që mbetet pas të gjitha zbritjeve (përfshirë edhe mirëmbajtjen e fëmijëve), në rastin e një punëtori që fiton pagën minimale, nuk do të bjerë kurrë nën minimumin jetik të përcaktuar nga Qeveria.”⁹² Në konkluzionet e vitit 2022 Komiteti ka tërhequr vëmendjen se nëse Shqipëria nuk e përcjellë këtë informacion në raportin e ardhshëm, nuk do të ketë asgjë që të vërtetojë se situata është në përputhje me Kartën Sociale Evropiane.

- **1.5 Deri në vitin 2030, ndërtimi i qëndrueshmërisë së të varfërve dhe personave në situata të pambrojtura dhe zvogëlimi i ekspozimit dhe cenueshmërisë së tyre ndaj ngjarjeve ekstreme të lidhura me klimën, goditjet dhe fatkeqësitë e tjera ekonomike, sociale dhe mjedisore, si dhe katastrofat**

1.5.1 Numri i vdekjeve, personave të zhdukur dhe personave të prekur drejtpërdrejt si pasojë e fatkeqësive, për çdo 100,000 banorë
1.5.2 Humbjet ekonomike direkte të shkaktuara nga fatkeqësitë, në lidhje me Produktin e Brendshëm Bruto global (PBB).
1.5.3 Numri i vendeve që miratojnë dhe zbatojnë strategji kombëtare për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, në përputhje me Kornizën Sendai për Reduktimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë 2015–2030.
1.5.4 Përqindja e njësisve të qeverisjes vendore që miratojnë dhe zbatojnë strategji vendore për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, në përputhje me strategjitë kombëtare.

✓ Lidhur me indikatorin 1.5.1 dhe 1.5.2 të OZHQ 1:

Të dhënat mbi ‘numrin e vdekjeve, personave të zhdukur dhe personave të prekur drejtpërdrejt si pasojë e fatkeqësive’, si dhe të dhënat mbi ‘humbjet ekonomike direkte të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore’, mund të sigurohen nëpërmjet Bazës së të Dhënave mbi Humbjet nga Fatkeqësitë. Ky është një sistem që administrohet nga AKMC⁹³. Bashkitë⁹⁴ dhe Ministrinë⁹⁵ janë institucionet që hedhin dhe përditësojnë të dhënat parësore për fatkeqësitë

⁸⁹ Parlamenti Europian: Lufta kundër varfërisë dhe përrjashtimit social- Përmes skemave të të ardhurave minimale, 2021, fq. 102.

⁹⁰ Raporti i performancës ‘Varfëria në Shqipëri dhe roli i shtetit në zbutjen e saj’, KLSH, 2018, fq.34-35.

⁹¹ <https://www.undp.org/albania/publications/evaluation-standard-subsistence-minimum-albania>, fq. 6.

⁹² <https://www.ecoi.net/en/file/local/2092699/Conclusions+2022+Albania+E.pdf> fq.22.

⁹³ Vendim nr. 345, datë 26.5.2022 ‘Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë’, pika 11.a.v.

⁹⁴ Vendim nr. 345, datë 26.5.2022 ‘Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë’, pika 11.c

⁹⁵ Vendim nr. 345, datë 26.5.2022 ‘Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë’, pika 11.b.

brenda territorit të tyre, apo fushës së përgjegjësisë. Ndërsa, Prefekti⁹⁶ siguron që bashkitë nën juridiksionin e vet hedhin dhe përditësojnë të dhënat në Bazën e të dhënave. Për më tepër, Baza e të dhënave mbi Humbjet nga Fatkeqësitë duhet të ndërveprojë me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile⁹⁷ (për të dhëna mbi personat e vdekur), si dhe me Bazën Shtetërore të të Dhënave të Kadastrale⁹⁸ (për të dhëna mbi pasuritë e paluajtshme, p.sh. në rastin e dëmtimit të banesave).

Baza e të dhënave mbi humbjet nga fatkeqësitë ka një rëndësi të veçantë, pasi jo vetëm siguron të dhëna statistikore, por gjithashtu mundëson kryerjen e analizave të thelluara që ndihmojnë në parandalimin e fatkeqësive, kompensimin apo rindërtimin pas tyre, si dhe planifikimin e investimeve të ardhshme.⁹⁹ Sistemi shërben si një inventar i fatkeqësive¹⁰⁰ (me ndikim të vogël, të mesëm, apo të madh), ku mund të sigurohen të dhëna, mbi llojin e fatkeqësisë, datën, vendndodhjen e saktë (me hartë digjitale), pronat e dëmtuara (me të dhëna kadastrale të lidhura), pasuri kulturore apo dëmet në mjedis të shkaktuara, personat e plagosur, të humbur, apo që kanë humbur jetën, kostot financiare të dëmeve, etj.

Nga analizimi i të dhënave rezulton se, kontrata për Sistemin e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë është lidhur më datë 28.12.2023. Kosto ishte 54,935,520 lekë dhe përfshin edhe mirëmbajtjen për 2 vite.¹⁰¹ Referuar të dhënave të përcjella nga AKMC, sistemi u vendos në funksion me datë 28.06.2024¹⁰². Në muajin nëntor 2024, kjo bazë të dhënash u regjistrua si Databazë Shtetërore, duke u integruar si pjesë e sistemeve elektronike shtetërore me hapësirë digjitale në serverat e AKSHI-t.

Grupi i auditimit kreu një vëzhgim në AKMC, mbi mënyrën si funksionon ngarkimi i të dhënave në sistemin e sipërpërmendur, nivelin e popullimit të tij, ndërveprimin me databazat e tjera shtetërore etj., e rrjedhimisht për të vlerësuar mundësinë për të siguruar të dhëna për indikatorët 1.5.1 dhe 1.5.2 të OZHQ1, nëpërmjet kësaj baze të dhënash.

Nga vëzhgimi rezultoi se, sistemi është i ngritur, por është pjesërisht i populluar. Ka pak të dhëna mbi numrin e vdekjeve, personave të zhdukur apo të prekur nga fatkeqësitë, apo për humbjet ekonomike të shkaktuara nga fatkeqësitë, çka e bën të pamundur përlllogaritjen e indikatorëve 1.5.1 dhe 1.5.2 të OZHQ 1, në mënyrë të besueshme, nëpërmjet kësaj baze të dhënash.

Nga auditimi rezultoi se, jo të gjitha institucionet e parashikuara në legjislacionin në fuqi¹⁰³ kanë akses në Bazën e të dhënave. Ndërsa, nga institucionet që kanë akses, të dhënat nuk janë plotësuar në mënyrë të plotë. Në sistem nuk ka akses 50% e bashkive si dhe asnjë prej

⁹⁶ Vendim nr. 345, datë 26.5.2022 'Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë', pika 11.ç.

⁹⁷ Vendim nr. 345, datë 26.5.2022 'Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë', pika 4.a.

⁹⁸ Vendim nr. 345, datë 26.5.2022 'Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë', pika 4.b.

⁹⁹ Materiali i trajnimeve të përgatitur nga AKMC, për përdoruesit e Bazës së të Dhënave, përcjellë nga AKMC, në vijim të pyetësorit zyrtar të grupit të auditimit.

¹⁰⁰ Ligji 45/2019 'Për mbrojtjen civile', pika 8, neni 3.

¹⁰¹ Totali: 54,935,520 lekë me TVSH që përfshinë inplemetimin 39,095,520 lekë me TVSH dhe mirëmbajtjen për dy vite: 15,840,000 lekë me TVSH.

¹⁰² E-mail zyrtar i AKMC për grupin e auditimit.

¹⁰³ Vendim nr. 345, datë 26.5.2022 'Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë'

Ministrive.¹⁰⁴ Nga provat e kryera në sistem rezultoi se, ai nuk ndërvepron me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, si dhe as me Bazën Shtetërore të të Dhënave të Kadastrale. Në vijim të vëzhgimit të kryer, grupit të auditimit i'u bë me dije se u sigurua ndërveprimi i këtij sistemi me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe me Bazën Shtetërore të të Dhënave Kadastrale, për të cilin grupi auditimit kreu dhe një vëzhgim tjetër. Pjesë e këtij sistemi është menduar që të jetë edhe Policia e Shtetit, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, si dhe Instituti i Gjeoshkencave, të cilët aktualisht nuk kanë akses.

Duke mos pasur një bazë të dhënash elektronike, në vitet më parë (një proces që vijon edhe tani), të dhënat mbi fatkeqësitë janë mbledhur nga AKMC nëpërmjet raportimeve të bashkive në një tabelë Excel-i. Grupi i auditimit vëzhgoi disa nga tabelat e përcjella nga bashkitë në këtë formë dhe rezultoi se informacionet e përcjella nëpërmjet tyre nuk janë të plota. Si dhe, jo të gjitha Bashkitë raportojnë në mënyrë periodike. Popullimi i Bazës Elektronike të të dhënave është i domosdoshëm për të siguruar plotësinë, vërtetësinë dhe monitorimin e të dhënave.

Gjithashtu, AKMC duhet të hartojë udhëzimet¹⁰⁵ e nevojshme për funksionimin e Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, në ndihmë të përdoruesve të tij.¹⁰⁶ Nga auditimi nuk rezultoi të jenë hartuar dhe miratuar udhëzues për Bazën e të Dhënave dhe Humbjeve nga Fatkeqësitë. Me qëllim plotësimin me informacion të plotë të bazës së të dhënave, grupi i auditimit gjykon se është e nevojshme që AKMC, ndër të tjera, të udhëzojë mënyrën si do të hidhen të dhënat për ngjarjet në raport me kohë (p.sh. sa kohë pas ndodhjes së ngjarjes duhet të regjistrohet ngjarja në sistem, si duhet të vijoj plotësimi i të dhënave, në vijim të përditësimit të informacioneve për çdo fatkeqësi, etj.). Gjithashtu, është e rëndësishme të udhëzohet mënyra si do të ngarkohen në këtë sistem të dhënat nga fatkeqësitë që kanë ndodhur ndër vite, përpara se të vihej në përdorim Baza e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë, etj.

Ndër të dhënat që raportohen lidhur me fatkeqësitë e që janë të nevojshme edhe për përlllogaritjen e indikatorëve të OZHQ (dhe që duhet të hidhen edhe në Bazën e të Dhënave) janë edhe humbjet nga fatkeqësitë dhe dëmi ekonomik direkt. Sipas legjislacionit në fuqi, ministritë dhe institucionet qendrore kryejnë vlerësimin e humbjeve nga fatkeqësitë, sipas fushës së përgjegjësisë, ndërsa bashkitë, kryejnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e tyre. Nga analizimi nuk rezultoi që të ketë një metodologji për vlerësimin e humbjeve nga fatkeqësitë, ndërsa vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në Bashki kryhet mbështetur në akte nënligjore¹⁰⁷ të dala në zbatim të ligjit për emergjencat civile¹⁰⁸ të shfuqizuar e që riskojnë të mos parashikojnë si bëhet përlllogaritja për të gjitha llojet e

¹⁰⁴Referuar informacionit të përcjellë nga AKMC për sa i përket Bashkive, që nuk kanë ende akses janë në proces krijim llogarish nga AKMC, si dhe trajnimi mbi përdorimin e sistemit. Pjesa tjetër e bashkive që nuk ka akses ende nuk kanë përcjellë të dhënat e përfaqësuesve që janë ngarkuar me hedhjen e të dhënave, për fatkeqësitë e ndodhura brenda territorit të tyre. Për sa i përket Ministrive, me ndryshimet që kanë ndodhur në vitin 2025, kanë ndryshuar edhe pikat e kontaktit. AKMC është në pritje të pikave të reja të kontaktit nga Ministritë, me qëllim krijim e llogarive, dhe vijimin me trajnimet.

¹⁰⁵ Vendim nr. 345, datë 26.5.2022 ‘Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë’, referuar: xi, shkronja a), pika 11.

¹⁰⁶ Grupit të auditimit i është vendosur në dispozicion Manuali i Përdorimit të Sistemit. Ky dokument përmban informacion mbi funksionet që ofron sistemi, dhe mënyrën e përdorimit të tij.

¹⁰⁷ P.sh. VKM nr. 329, datë 16.5.2012 ‘Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore’

¹⁰⁸ Ligji nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar.

dëmeve¹⁰⁹. Referuar Ligjit të ri¹¹⁰, aktet nën ligjore për vlerësimin e dëmeve, procedurat, kompensimi, afatet, strukturat përgjegjëse, etj. duhet të ishin nxjerr nga Këshilli i Ministrave brenda vitit 2020¹¹¹.

- ✓ *Lidhur me Indikatorin 1.5.3: Mbi hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë, në përputhje me Kornizën Sendai për Reduktimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë 2015–2030.*

Një nga treguesit e Agjendës 2030 për të matur progresin e arritur në drejtim të *Zhdukjes së varfërisë ekstreme* është edhe hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë, në përputhje me *Kornizën Sendai*. Krahë faktit që ky është një indikator i Agjendës 2023, hartimi i Strategjisë është edhe detyrim ligjor në vendin tonë: *‘Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë është dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë që përcakton politikat e aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit.*’¹¹²

Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023 dhe Plani i Veprimit është hartuar dhe miratuar me VKM nr. 94, datë 22.02.2023. Në këtë strategji, si tregues të ndikimit janë parashikuar edhe ato të OZHQ 1, si dhe synohet që brenda vitit 2030:

- të zvogëlohet me 10% numrit i të prekurve për 100,000 nga fatkeqësitë, krahasuar me vitin 2018 (*treguesi 1.5.1*) dhe,
- të zvogëlohen me 5% humbjet e drejtpërdrejta ekonomike nga fatkeqësitë e shkaktuara, krahasuar me vitin 2018 (*treguesi 1.5.2*)

Strategjia është Dokumenti themelor i Qeverisë Shqiptarë që duhet të drejtojë të gjitha aktivitetet dhe investimet e ardhshme të menaxhimit të fatkeqësive. Menaxhimi i risqeve ekzistuese dhe parandalimi i risqeve të reja, rritja e ndërgjegjësimit dhe lehtësimi i shkëmbimit të informacionit, përmirësimi i kapaciteteve ripërtëritëse, etj., janë në thelb të këtij dokumenti strategjik. Gjithashtu, ky dokument hap rrugën për hartimin dhe harmonizimin e Strategjive Vendore për Zvogëlimin e Riskut në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Referuar këtij dokumenti, *‘Nuk ka zhvillim të qëndrueshëm pa zvogëlimin e riskut të fatkeqësive.*’¹¹³ Ashtu si rezultatet e Kuadrit Sendai, edhe ato të OZHQ-ve janë produkt i proceseve të ndërlidhura sociale dhe ekonomike pra, natyrshëm ka sinergji midis Agjendës 2030 dhe Kuadrit Sendai. Nëpërmjet monitorimit të Kuadrit Sendai synohet të arrihet edhe monitorimi i treguesve të OZHQ¹¹⁴.

¹⁰⁹ Nga kërkimi i grupit të auditimit nuk është arritur të identifikohet në mënyrë të plotë si bëhet përlllogaritja e dëmit në rastin e *‘gjësë së gjallë’* të humbur nga një fatkeqësi, në kushtet kur nuk është shpallur gjendja e emergjencës civile.

¹¹⁰ Ligj nr. 45/2019 *‘Për mbrojtjen civile’*

¹¹¹ Ligj nr. 45/2019 *‘Për mbrojtjen civile’*, neni 72, pika 1 b), që parashikon daljen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 41, pika 6.

¹¹² Ligj nr. 45/2019 *‘Për mbrojtjen civile’*, neni 10, pika 1.

¹¹³ Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023 dhe Plani i Veprimit të miratuar me VKM nr. 94, datë 22.02.2023, në kapitullin: *‘Lidhja me Kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm’*.

¹¹⁴ Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023 dhe Plani i Veprimit të miratuar me VKM nr. 94, datë 22.02.2023, në kapitullin: *‘Lidhja me Kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm’*.

Për të arritur shkallën optimale të zbatimit të Strategjisë, procesi i zbatimit duhet të monitorohej rregullisht dhe të raportohej në mënyrë transparente¹¹⁵. Referuar dokumentit, aktivitetet e Strategjisë janë zgjedhur duke përdorur udhëzimet SMART¹¹⁶. Me qëllim që strategjia të ishte e matshme ‘*Secila prej fushave kyçe të ndërhyrjes ka një sërë aktivitetesh të identifikuar që kontribuojnë në këtë fushë. Secili prej rreziqeve ka një listë të treguesve të rezultateve që do të ndihmojnë në monitorimin e progresit të zvogëlimit të riskut specifik.*’¹¹⁷ Progresi i arritur nga secili prej palëve përkatëse të interesit do të monitorohej nga AKMC-ja dhe Grupi i Punës për Monitorimin e Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive mbi baza vjetore. Ne vijim, informacioni mbi aktivitetet e realizuara, përqindjen e zbatimit, si dhe hapat e mëtejshëm do t’i raportoheshin në mënyrë transparente Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Ndërsa, bazuar në raportimin e progresit çdo dy vjet, duke filluar nga viti 2024, një vlerësim i zbatimit të Strategjisë do të bëhet nga një institucion i jashtëm i paanshëm me kërkesë të koordinatorit, AKMC-së.

Midis informacioneve të vëna në dispozicion, evidentohen shkresa zyrtar drejtuar disa institucioneve përgjegjëse, kur nga AKMC kërkohet përfshirja në PBA-në e vitit përkatës e projekteve (në fushën e tyre të përgjegjësisë) që janë pjesë e aktiviteteve të Planin e Veprimit të Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023¹¹⁸. Ndërsa në planet vjetore të punës së AKMC-së, janë përfshirë edhe informacione mbi projekte të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.

Nga auditimi rezultoi se, *Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023 dhe Plani i Veprimit*, nuk ka të parashikuar tregues, të cilët ta bëjnë të matshëm progresin e arritur nga zbatimi i aktiviteteve të përcaktuara. Gjithashtu, në Planin e Veprimit nuk identifikohen *target* vjetor të synuar, për të mundësuar krahasimin e rezultateve të arritura në bazë vjetore, kundrejt atyre të pritshme, e që rrjedhimisht do të lejonin ndërmarrjen në kohë të masave për përmirësimin e situatës.

Nga auditimi nuk sigurohen evidenca që të jetë ngritur dhe të ketë funksionuar Grupi i Punës për Monitorimin e Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive. Për periudhën objekt auditimi, nuk është kryer një proces i mirëfilltë monitorimit mbi nivelin e zbatimit të planit të veprimit, mbi baza vjetore. Gjithashtu, nuk është kryer procesi i vlerësimit të zbatimit të saj nga ndonjë institucion i jashtëm i paanshëm. Deri më tani, nuk është raportuar pranë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi aktivitetet e realizuara, përqindjen e zbatimit, si dhe hapat e mëtejshëm.

- ✓ *Lidhur me Indikatorin 1.5.4: Përqindja e njësive të qeverisjes vendore që miratojnë dhe zbatojnë strategji vendore për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, në përputhje me strategjitë kombëtare:*

Krahas faktit që është një indikator për të matur progresin në drejtim të OZHQ1, miratimi dhe zbatimi i strategjive vendore për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, sikurse edhe hartimi i Strategjisë Kombëtare, është edhe një detyrim ligjor për bashkitë në vendin tonë, i parashikuara në Ligjin për Mbrojtjen Civile. ‘*Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore, me vendim të*

¹¹⁵ Parashikuar në Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023 dhe Planin e Veprimit të miratuar me VKM nr. 94, datë 22.02.2023, në kapitullin: ‘*Monitorimi dhe raportimi i progresit*’.

¹¹⁶ Specifike, të Matshme, të Arritshme, Realiste dhe në Kohë

¹¹⁷ Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023 dhe Plani i Veprimit të miratuar me VKM nr. 94, datë 22.02.2023, në kapitullin: ‘*Monitorimi dhe raportimi i progresit*’.

¹¹⁸ P.sh. Shkresë zyrtare drejtuar MSHMS-së, nr.1289/4, datë 14.07.2023, përcjellë grupit të auditimit, me e-mailin zyrtar të datës 04.11.2025.

këshillit bashkiak, miraton, minimalisht çdo pesë vjet, strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, të harmonizuar me Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.¹¹⁹ Këto Strategji duhet të jenë në linjë me Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Ndërsa, AKMC-ja ushtron autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.¹²⁰

Nga auditimi rezultoi se Bashkitë Durrës dhe Elbasan, subjekt auditimi, nuk kanë hartuar dhe miratuar Strategjitë Vendore të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë. Referuar të dhënave të përcjella prej bashkive nën auditim, hartimi i këtij dokumenti kërkon mbështetje teknik dhe financiare, të cilën Bashkitë nuk e kanë siguruar deri më tani¹²¹, çka ka shkaktuar mos përmbushjen e këtij detyrimi ligjor dhe nën-objektivi të OZHQ-ve. Sipas informacioneve të vëna në dispozicion nga AKMC vetëm 15% e bashkive në nivel vendi kanë hartuar strategjitë vendore për reduktimin e riskut nga fatkeqësitë¹²². Në dokumentacionin e vënë në dispozicion grupit të auditimit, identifikohet se nga AKMC janë zhvilluar takime me fokus hartimin e dokumenteve strategjike. Nga diskutimet ka rezultuar se, disa prej arsyeve përse është ky nivel i ulët i hartimit të dokumenteve strategjike në nivel vendor për reduktimin e riskut nga fatkeqësitë janë:

- Disa prej bashkive nuk kanë ngritur në organikë sektorët për mbulimin e emergjencave civile;
- 80% e bashkive nuk kanë staf të trajnuar për hartimin e dokumenteve strategjike;
- Ka paqartësi në interpretimin dhe implementimin e VKM-së nr.414 të vitit 2021 'Për miratimin e Procedurave dhe Kritereve të ndarjes dhe përdorimit të Fondit të Kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile', e ndryshuar';
- Titullarët e institucioneve nuk janë ndërgjegjësuar sa i takon përdorimit dhe planifikimit në kohë të fondeve nga paketa e kushtëzuar e emergjencave civile;
- Ekziston një paqartësi sa i takon rolit të Institucionit të Perfektit dhe Bashkive për mënyrën e mbledhje dhe raportimit të të dhënave në bazën e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë.

➤ **1.a. Sigurimi i mobilizimit domethënës të të ardhurave nga një sërë burimesh, duke përfshirë zgjerimin e bashkëpunimit për zhvillim, në mënyrë që të sigurohen mjete të përshtatshme dhe të parashikueshme për vendet në zhvillim, në veçanti për vendet më pak të zhvilluara, për zbatimin e programeve dhe politikave për t'i dhënë fund varfërisë në të gjitha përmasat e saj**

1.b Krijimi i kornizave të politikave të shëndosha në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, bazuar në strategjitë e zhvillimit në favor të të varfërve dhe me ndjeshmëri ndaj çështjeve gjinore, për të mbështetur investimin e përshtetshëm tek masat për zhdukjen e varfërisë.

1.a.1 Totali i ndihmës zyrtare për zhvillim (grante) nga të gjithë donatorët që fokusohet në uljen e varfërisë, si përqindje e të ardhurës kombëtare bruto të vendit përfitues

¹¹⁹ Ligj nr. 45/2019 'Për mbrojtjen civile', neni 11.

¹²⁰ Ligj nr. 45/2019 'Për mbrojtjen civile', neni 23, pika 3.

¹²¹ Bashkia Durrës përcjell se mund të ketë një bashkëpunim të mundshëm me GIZ me qëllim hartimin e Strategjisë Vendore për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë.

¹²² Mbështetur në informacionin e përcjellë nga AKMC, kanë miratuar këtë dokument strategjik 9 bashki, janë në proces 13 bashki, ndërsa për 39 bashki nuk ka nisur procesi.

1.a.2 Përqindja e *shpenzimeve totale të qeverisë për shërbime thelbësore* (arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale)

1.b.1 *Shpenzime publike sociale* me ndikim të drejtpërdrejtë në mbështetjen e të varfërve

Për të siguruar arritjen e objektivave kombëtare lidhur me varfërinë në vend, e rrjedhimisht për të ndikuar pozitivisht në arritjen e qëllimit global për t'i dhënë fund varfërisë në të gjitha format e saj dhe kudo, është e nevojshme mbështetja e masave me fonde, si me buxhetin e shtetit ashtu edhe me *grante* nga donatorët e huaj. Këto të dhëna janë të nevojshme për të vlerësuar, nëpërmjet indikatorë të Agjendës 2030, progresin e bërë në drejtim të arritjes së OZHQ1.

✓ Lidhur me indikatorët 1.a.1 të OZHQ 1:

Referuar legjislacionit në fuqi, SASPAC administron bazën e të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Ndihmës së Huaj (SIMNH)¹²³, ndërsa në listën e institucioneve të interesuara është edhe ministria përgjegjëse për financat¹²⁴. Ky sistem duhet të përmbajë të dhëna mbi projektet e huaja si informacione të përgjithshme, të dhënat financiare (kostoja e projektit, komponentët, angazhimet, pagesat e planifikuara, pagesat e realizuara etj.)¹²⁵, treguesit e performancës, si dhe referenca me OZHQ-të¹²⁶.

Nga informacionet e vëna në dispozicion grupit të auditimit, vërehet se Baza e të dhënave për ndihmën e huaj, është realizuar nëpërmjet një projekti që në vitin 2017, përfituesi i të cilit ishte Ministria përgjegjëse për financat. Ndërsa me krijimin e SASPAK, kompetenca për administrimin e Sistemit të të dhënave për ndihmën e huaj i kaloi këtij institucioni¹²⁷. Për këtë sistem, deri në vitin 2022 ishin nënshkruar 7 memorandume mirëkuptimi ndërmjet MFE dhe partnerëve për zhvillim.¹²⁸

Mbështetur në sa më sipër, grupi i auditimit kërkoi informacion drejtuar SASPAK dhe MFE mbi ndihmën e huaj (financiare) që vendi ynë ka pasur me qëllim arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, për periudhën nën auditim, si një prej indikatorëve për të matur progresin e bërë në drejtim të OZHQ1. Në vijim të kërkesës, subjektet nën auditim nuk përcollën informacion të detajuar financiar. Grupit të auditimit i'u bë me dije se *'Aktualisht është në proces hartimi i raportit të performancës së ndihmës së huaj 2013 – 2023 dhe raporti i performancës së ndihmës së huaj për vitin 2024, të cilët përmbajnë dhe një analizë të ndihmës së huaj në raport me realizimin e OZHQ-ve'*¹²⁹.

Nga informacionet e përcjella nga subjektet nën auditim, Sistemi Informatik i Menaxhimit të Ndihmës së Huaj (SIMNH) nuk është funksional/operativ, dhe fushat nuk përmbajnë të dhëna

¹²³ VKM nr. 642, Datë 29.10.2021 'Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës', pika 12, shkronja 'f'; dhe VKM nr.590, datë 4.9.2019 'Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Ndihmës së Huaj (SIMNH)', e ndryshuar, pika 8, shkronja 'a'.

¹²⁴ VKM nr.590, datë 4.9.2019 'Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Ndihmës së Huaj (SIMNH)', e ndryshuar, pika 8, shkronja 'b'.

¹²⁵ VKM nr.590, datë 4.9.2019 'Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Ndihmës së Huaj (SIMNH)', e ndryshuar, pika 4.1.

¹²⁶ VKM nr.590, datë 4.9.2019 'Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Ndihmës së Huaj (SIMNH)', e ndryshuar, pika 4.2, shkronja 'dh'.

¹²⁷ VKM nr. 642, Datë 29.10.2021 'Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës', pika 12, shkronja 'f'; dhe VKM nr.590, datë 4.9.2019 'Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Ndihmës së Huaj (SIMNH)', e ndryshuar, pika 8, shkronja 'a'.

¹²⁸ Specifikisht: ADA, JICA, Ambasada e Suedisë dhe e Zvicrës, USAID, OSBE dhe Koordinatori Rezident i OKB në Shqipëri.

¹²⁹ Përgjigja zyrtare e SASPAK, e-mail zyrtar, datë 31.10.2025, në vijim të kërkesës për informacion të grupit të auditimit.

të plota. Përditësimi i fundit i sistemit daton në Nëntor 2021 dhe është kryer nga Agjencia UN Women¹³⁰.

✓ Lidhur me indikatorët 1.a.2 dhe 1.b.1 të OZHQ 1:

Në auditimin e performancës me temë “*Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm*”, me fokus efektivitetin e veprimtarisë së institucioneve shqiptare lidhur me OZHQ-të për periudhën 2017-2021, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka theksuar në mënyrë të vecantë rëndësinë e funksionimit të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar në Shqipëri (IPSIS/SIPI).

Në këtë auditim është konkluduar se ‘*Nuk mund të identifikohet në mënyrë të qartë lidhja midis OZHQ-ve dhe/apo target-ëve specifik të OZHQ-ve, me buxhetet e planifikuara apo të alokuara për arritjen e tyre, përgjatë periudhës nën auditim*’¹³¹ dhe se mos funksionimi i IPSIS-it, ka ndikuar negativisht në këtë situatë.

“*Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar është sistemi kryesor për planifikimin, analizën, përgatitjen e të gjitha tipologjive të dokumenteve strategjike, si dhe për monitorimin e performancës së arritur kundrejt politikave dhe objektivave të planifikuara*”¹³².

Nëpërmjet këtij sistemi do arrihej të krijohej një pasqyrim dhe lidhje e qartë midis politikave dhe produkteve të prodhura për to, të shoqëruara me treguesit e performancës dhe referencat me OZHQ-të¹³³. Pra, ky sistem do të mundësonte të identifikohesh në mënyrë të qartë: ¹³⁴

- detajimi dhe lidhja e objektivave strategjik kombëtarë me objektivat specifik;
- detajimi dhe lidhja e masave të ndërmarra (për objektivat specifik) me programet buxhetore;
- detajimi dhe lidhja e programeve buxhetore me projektet e investimit dhe produktet (të shoqëruara me buxhet përkatëse faktike).

Gjurmët e para për krijim e IPSIS identifikohen që në vitin 2005¹³⁵, pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar (IPS) në Shqipëri, me mbështetjen e Bankës Botërore dhe partnerëve të zhvillimit, si një kornizë për lidhjen e politikave, planifikimit strategjik dhe buxhetimit. Procesi ka kaluar nga një reformë institucionale e planifikimit (2005–2015) në një fazë të konsolidimit digjital në vitin 2020¹³⁶. Me krijimin e SASPAK, në vitin 2021 administrimi i sistemit IPSIS-t kaloi nga Ministria përgjegjëse për financat tek SASPAK¹³⁷.

Nga auditimi rezultoi se aktualisht Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar nuk është funksional, rrjedhimisht grupi i auditimit nuk e ka të mundur të identifikojë në mënyrë të qartë

¹³⁰ Përgjigja zyrtare e SASPAK, e-mail zyrtar, datë 31.10.2025, në vijim të kërkesës për informacion të grupit të auditimit.

¹³¹ <https://www.klsh.org.al/wp-content/uploads/2025/02/Raport-perfundimtar-i-auditimit-te-performances-me-teme-Objektivat-e-zhvillimit-te-qendrueshem.pdf>, Raporti i Performancës me teme ‘Objektivat e zhvillimit të qendrueshëm’, 2022, fq. 35-36.

¹³² VKM nr.290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (sipi/ipsis)”, i ndryshuar, pika 1.

¹³³ VKM nr.290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (sipi/ipsis)”, i ndryshuar, pika 5, shkronja “a.iii”.

¹³⁴ VKM nr.290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (sipi/ipsis)”, i ndryshuar, pikat 5 dhe 7.

¹³⁵ Dokumenti “IPS_roadmap”, përcjellë nga SASPAK në vijim të kërkesës për informacion, me e-mailin zyrtar të datës 31.10.2025.


¹³⁶ Me miratimin e VKM-së nr.290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)”, të ndryshuar në vitin 2022.

¹³⁷ VKM nr. 642, Datë 29.10.2021 ‘Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës’, pika 12, shkronja ‘f’; dhe VKM nr.290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (sipi/ipsis)”, i ndryshuar, pikat 8, shkronja “b”.

dhe të plotë lidhjen midis OZHQ1 dhe/apo target-ëve specifik të OZHQ1, me buxhetet e planifikuara apo të alokuara për arritjen e tyre. Në vijim të sa më sipër grupi i auditimit kërkoi informacion nga Ministria përgjegjëse për financat, me qëllim analizimin e shpenzimeve totale të qeverisë për shërbimet thelbësore arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale.

Nga analizimi i të dhënave rezulton se për periudhën 2013-2024, shpenzimet thelbësore (arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale) zënë rreth 50% të totalit të shpenzimeve të qeverisë. Piku i shpenzimeve thelbësore ka arritur në vitin 2019 në masën 54% të shpenzimeve totale, ndërsa në vitin 2022 ra në nivelin 49.9% të totalit të shpenzimeve, për tu pasuar me një rritje të lehtë në 3 vitet e fundit 51% në vitin 2024. Peshën kryesore në totalin e shpenzimeve thelbësore e zënë ato për mbrojtjen sociale (31% të totalit të shpenzimeve në vitin 2024), ndërsa arsimi dhe Shëndetësia, luhaten në intervalin 9-10% të totalit të shpenzimeve të qeverisë. Ndër vite arsimi ka përfutur më shumë buxhet se shëndetësia, përjashtim bëjnë vitet e pandemi, ku shëndetësia pati një epërsi të lehtë ku në vitin 2021 arriti 10.7% e shpenzimeve totale, vlera më e lartë e arritur nga ky sektor në 11 vitet e fundit.

Grafiku 3: Shpenzimet thelbësore ne total dhe te detajuara sipas sektoreve, si % nga shpenzimeve totale të qeverisë



Burimi: MF. Përpunoi: Grupi i auditimit

Nëse do t'i krahasojmë me mesataren e vendeve të BE-së¹³⁸, do të vërejmë se shpenzimet thelbësore zënë rreth 65% të totalit të shpenzimeve të qeverisë, çka tregon një fokus më të lartë në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale, se në vendin tonë. Shpenzimet për arsimin zënë 10% të totalit të shpenzimeve, peshë relative e të përafërt kjo me vendin tonë. Ndryshim vërehet në shpenzimet për shëndetësinë ku për periudhën 2020-2023 ato zënë 15% të totalit të shpenzimeve qeveritare (përkundrejt 9-10% në vendin tonë) dhe në shpenzimet për mbrojtjen sociale ku për të njëjtën periudhë janë rreth 40% të shpenzimeve totale (përkundrejt 30% në vendin tonë).

Konkluzion 3: Referuar 2 indikatorëve zyrtar të OZHQ1, që vendi ynë përllëgarit për të matur progresin e arritur nga masat e ndërmarr në drejtim të zbutjes së varfërisë, konkludohet se megjithë masat e ndërmarra dhe arritjes së pjesës më të madhe të tyre (referuar raporteve të monitorimit) 40% e shqiptarëve vijnë në rrezik për të qenë i varfër ose përjashtimi social, ndërsa buxheti i alokuar për mbrojtjen sociale në vendin tonë është ndjeshëm më i ulët,

¹³⁸ General government expenditure by function (COFOG), Online data code: gov_10a_exp, indikatori EU-27.

se mesatarja e vendeve të BE-se. Lidhur me masat e ndërmarra për arritjen e nënobjektivit 1.5 të OZHQ1, nuk mund të konkludohet në mënyrë të besueshme, pasi Baza e të Dhënave mbi Humbjet nga Fatkeqësitë nuk është populluar në mënyrë të plotë si një proces i vazhduar, e rrjedhimisht nuk mund të sigurohen të dhëna prej saj mbi vdekjet, personat e zhdukur dhe personat e prekur drejtpërdrejt nga fatkeqësitë, si dhe as për humbjet ekonomike direkte të shkaktuara prej tyre. Lidhur me hartimin dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare për Reduktimin e Risqeve nga Fatkeqësitë, ajo nuk është hartuar plotësisht në përputhje me Kuadrin Sendai, pasi nuk është shoqëruar me pasaportën e miratuar të indikatorëve, si dhe nuk është monitoruar, vlerësuar dhe raportuar në mënyrë të mirëfilltë. Nga ana tjetër, vetëm 15% e Bashkive në rang vendi kanë hartuar dhe miratuar Strategjitë Vendore të Reduktimit të Riskut nga Fatkeqësitë. Si indikatorët për të matur progresin e arritur në drejtim të nën objektivave 1.a dhe 1.b të OZHQ1, nuk u arrit të konkludohet mbi ndihmën financiare të huaj për arritjen e OZHQ, pasi Sistemi Informatik i Menaxhimit të Ndihmës së Huaj (SIMNH) nuk është funksional/operativ. Në vijim, për shkak se edhe Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar (SIPI) nuk funksionon nuk sigurohet një lidhje e qartë midis OZHQ-ve dhe/apo *target-eve* specifik të OZHQ-ve, me buxhetet e planifikuara apo të alokuara për arritjen e tyre.

6. Gjetje nga auditimi: Vendi ynë ka ndërmarrë një sërë masash për të zbutur dhe lehtësuar varfërinë, por megjithatë gjatë periudhës objekt auditimi mbi 40% e popullsisë, ka qenë në rrezik për të qenë e varfër ose përjashtim social¹³⁹, vlerë kjo dy herë me e lartë se mesatarja e Evropës (21% e popullatës në vitin 2023). Shpenzimet për mbrojtjen sociale për vitin 2024 zinin rreth 9% të PBB-së ose 31% të totalit të shpenzimeve qeveritare, vlera këto të njëjta me ato të vitit 2013. Për vitin 2023 buxheti për mbrojtjen sociale në Shqipëri ishte më pak se gjysma e mesatares së BE-së (19.2% e PBB-së). Referuar raportit të monitorimit të vitit 2023 të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, shumica e aktiviteteve të parashikuara për zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë janë përmbushur, por nuk është kryer një analizë e detajuar mbi arsyet përse vetëm 62% e popullsisë në varfëri ekstreme përfiton ndihmë ekonomike, krahasuar me synimin prej 100% deri në vitin 2023, si dhe përse vetëm 65% e familjeve që marrin ndihmë ekonomike, janë përfituese edhe të programeve të tjera mbështetëse, krahasuar me synimin prej 75% deri në vitin 2023¹⁴⁰. Megjithëse në dokumentet kombëtare formalizohen politikat për të lehtësuar dhe zbutur varfërinë, në vendin tonë nuk ka një përkufizim zyrtar që të përcaktojë kur konsiderohesh i varfër, por vetëm në risk për të qenë i varfër. Ndër vite organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, kanë kërkuar hartimin e politikave sociale dhe marrjen e masave të nevojshme bazuar në minimumin jetik. Megjithatë, vendi ynë ende nuk ka një vlerë të miratuar të minimumit jetik. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 38-58 të Raportit të Auditimit)*

6.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe Ministrinë e Financave, të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për të miratuar vlerën zyrtare të minimumit jetik për vendin tonë, në mënyrë që masa e ndihmës ekonomike, politikat e pagës, programet e mbrojtjes sociale, matja e varfërisë dhe përjashtimit social, etj., të realizohen mbështetur mbi minimumin jetik të miratuar.

Brenda vitit 2027

Observimi i subjektit: Me anë të shkresës nr. 8527/3 prot., datë 18.02.2026 Ministria e Financave ka përcjellë komentet dhe observimet lidhur me rekomandimin e mësipër,

¹³⁹ Indikator 1.2.2 – Përqindja e popullsisë në rrezik të varfërisë ose përjashtimit social

¹⁴⁰ Të dhëna të raportuara në raportin e monitorimit të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale, 2023, fq. 25 dhe fq.34.

protokolluar në KLSH nr. 589/17 prot., datë 27.02.2026, si: “Vlerësojmë që rekomandimi duhet të rishikohet duke hequr Ministrinë përgjegjëse për financat nga propozimi për të miratuar vlerën e minimumit jetik. Theksojmë që përlllogaritja e kësaj vlere dhe miratimi i saj nuk është në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Financave.”

Qendrimi i grupit të auditimit: Lidhur me vlerësimin e paraqitur nga Ministria e Financave, theksojmë se rekomandimi i KLSH-së synon të nxisë një qasje të koordinuar ndërinstitucionale në procesin e përcaktimit dhe miratimit të minimumit jetik. Duke pasur në konsideratë ndikimin që përcaktimi i minimumit jetik do të kishte në buxhetin e shtetit dhe në zbatimin e politikave publike përkatëse, ky proces nuk mund të realizohet pa bashkëpunimin ndërinstitucional, përfshirë edhe Ministrinë e Financave. **Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.**

Observimi i subjektit: Me anë të shkresës nr. 843/1 prot., datë 11.03.2026, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka përcjellë komentet dhe observimet lidhur me projekt-raportin e auditimit, protokolluar në KLSH nr. 589/20 prot., datë 17.03.2026, si mëposhtë: “Përcaktimi i minimumit jetik është një proces i thelluar shkencor, që kërkon analiza makroekonomike, metodologji të standardizuara statistikore dhe vlerësim të të ardhurave reale dhe për këtë arsye, duhet të udhëhiqet nga institucionet me përgjegjësi ekonomike dhe statistikore, si autoritete metodologjike të pavarura, për të garantuar objektivitet dhe paanshmëri. Në këtë kuadër, MSHMS nuk mund të marr iniciativë, por ajo kontribuon me evidenca për grupet në nevojë dhe e përdor treguesin matur për hartimin e politikave dhe programeve mbrojtëse/mësbtetëse për kategoritë vulnerabël.”

Qendrimi i grupit të auditimit: Referuar Vendimit nr. 515, datë 25.09.2025 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale”, MSHMS ka si mision “garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale [...]”, si dhe ushtron veprimtarinë e saj, ndër të tjera, në “zhvillimin e politikave që synojnë mbrojtjen sociale, promovimin social, integrimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies sociale të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë” dhe në “zhvillimin e politikave për ndihmën ekonomike [...] për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike”.

Në këtë kuadër, grupi i auditimit vlerëson se adresimi i çështjeve që lidhen me plotësimin e nevojave bazë jetike të individëve dhe familjeve në nevojë përbën pjesë të drejtpërdrejtë të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Për rrjedhojë, roli i saj nuk mund të kufizohet vetëm në kontribut me evidenca apo në përdorimin e treguesve për hartimin e politikave, por përfshin edhe angazhimin në nxitjen dhe bashkërendimin institucional për zhvillimin e politikave dhe mekanizmave të nevojshëm në këtë fushë, në bashkëpunim me institucionet përkatëse. **Observacioni nuk merret në konsideratë.**

6.2 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në raportet e ardhshme të monitorimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, në rastet kur aktivitetet e parashikuara për zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë rezultojnë të porealizuara ose të realizuara pjesërisht, të paraqesë një analizë të detajuar të shkaqeve të mosrealizimit në mënyrë të plotë, ndikimit në arritjen e objektivave dhe masave të nevojshme për përmirësim.

Në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Të dhënat mbi personat që kanë humbur jetën, janë zhdukur apo prekur drejtpërdrejtë nga fatkeqësitë, si dhe humbjet ekonomike direkte të shkaktuara prej tyre nevojiten për të matur progresin e arritur në drejtim të OZHQ - 1. Këto të dhëna, për vendin

tonë duhet të gjenden në Bazën e të Dhënave mbi Humbjet nga Fatkeqësitë të administruar nga AKMC¹⁴¹. Të dhënat që janë aktualisht në këtë *databazë* nuk mund të përdoren për të përlllogaritur indikatorët e OZHQ 1. Baza e të Dhënave mbi Humbjet nga Fatkeqësitë është ngritur, por nuk është e populluar në mënyrë të plotë. Në sistem nuk ka akses 50% e bashkive si dhe asnjë prej Ministrive.¹⁴² Ndërsa, institucionet të cilat kanë akses, nuk i plotësojnë të dhënat në mënyrë të plotë, sipas fushave të parashikuara në sistem. Nga auditimi rezultoi se nuk janë hartuar Udhëzuesit e nevojshëm që sigurojnë funksionimin e plotë të sistemit në ndihmë të përdoruesve të tij. Deri më tani nuk ka metodologji për përlllogaritjen e humbjeve nga fatkeqësitë, si dhe ende nuk janë hartuar dhe miratuar aktet nën ligjore për vlerësimin e dëmeve, procedurat, kompensimi, afatet, strukturat përgjegjëse, në vijim të miratimit të Ligjit për mbrojtjen civile në vitin 2019. Këto janë dokumente rregullatore të domosdoshme për të siguruar përlllogaritjen e humbjeve dhe dëmeve nga fatkeqësitë, si pjesë e Bazës së të Dhënave, dhe rrjedhimisht vlerësimin e indikatorëve të OZHQ 1.

7.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile të ndërmarrë hapat e nevojshme, për të siguruar hartimin dhe miratimin e udhëzimeve të nevojshme për funksionimin e Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, në ndihmë të përdoruesve.

Brenda vitit 2026

7.2 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar, hartimin dhe miratimin e metodologjive të nevojshme për vlerësimin e humbjeve nga fatkeqësitë, si dhe të kontribuojë në intensifikimin e përpjekjeve për hartimin dhe miratimin e akteve nën ligjore për vlerësimin e dëmeve, procedurat, kompensimi, afatet, strukturat përgjegjëse në rastet e fatkeqësive.

Brenda vitit 2026

7.3 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Financave, Bashkia Durrës dhe Bashkia Elbasan të marrin të gjitha masat e nevojshme, si dhe të intensifikojnë bashkëpunimin midis tyre, për të siguruar popullimin dhe funksionimin e plotë të bazës së të dhënave mbi humbjet nga fatkeqësitë.

Brenda vitit 2026

Observimi i subjektit: Me anë të shkresës nr. 8527/3 prot., datë 18.02.2026 Ministria e Financave ka përcjellë komentet dhe observimet lidhur me rekomandimin e mësipër, protokolluar në KLSH nr. 589/17 prot., datë 27.02.2026, si: *“Vlerësojmë se Ministria e Financave duhet të hiqet nga rekomandimi mbi bazën e të dhënave nga humbjet nga fatkeqësitë pasi kjo fushë dhe ky aktivitet nuk janë brenda fushës së përgjegjësisë së MF-së.*

Qendrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observimin e paraqitur nga Ministria e Financave, sqarojmë se rekomandimi nuk i atribuon Ministrisë së Financave përgjegjësi për administrimin e Bazës së të Dhënave mbi humbjet nga fatkeqësitë, por synon nxitjen e bashkëpunimit të mëtejshëm ndërinstitutional për funksionimin e plotë të këtij sistemi, në

¹⁴¹ Vendim nr. 345, datë 26.5.2022 ‘Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë’, pika 11.a.v.

¹⁴² Referuar informacionit të përcjellë nga AKMC për sa i përket Bashkive, që nuk kanë ende akses janë në proces krijim llogarish nga AKMC, si dhe trajnimi mbi përdorimin e sistemit. Pjesa tjetër e bashkive që nuk ka akses ende nuk kanë përcjellë të dhënat e përfaqësuesve që janë ngarkuar me hedhjen e të dhënave, për fatkeqësitë e ndodhura brenda territorit të tyre. Për sa i përket Ministrive, me ndryshimet që kanë ndodhur në vitin 2025, kanë ndryshuar edhe pikat e kontaktit. AKMC është në pritje të pikave të reja të kontaktit nga Ministrinë, me qëllim krijim e llogarive, dhe vijimin me trajnimet.

zbatim të VKM nr. 345, datë 26.5.2022. Në këtë kuadër, vlerësohet se një pjesë e informacionit, veçanërisht ai me natyrë financiare që lidhet me përballimin e pasojave të fatkeqësive, mund të disponohet ose të sigurohet nga Ministrisë së Financave, ndaj përfshirja e saj në rekomandim është në funksion të lehtësimit të bashkëpunimit institucional me qëllim, funksionimin e plotë të sistemit. ***Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.***

8. Gjetje nga auditimi: Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë (në përputhje me *Kornizën Sendai*) është një nga indikatorët e dakordësuar në nivel global për të matur progresin e arritur në drejtim të OZHQ 1. Gjithashtu, hartimi i këtij dokumenti strategjik është edhe detyrim ligjor i parashikuar në Ligjin për mbrojtën civile. Vendi ynë ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Reduktimin e Risqeve nga Fatkeqësitë, mirëpo ajo nuk është hartuar mbështetur plotësisht mbi parimet SMART, siç parashikon ky dokument¹⁴³. Aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit të këtij dokumenti strategjik nuk janë shoqëruar me tregues (*indikatorë*) dhe *target* vjetor të synuar, të cilët të sigurojnë monitorimin e progresit të arritur në mënyrë të besueshme. Nga ana tjetër, nuk janë siguruar evidenca mbi ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Punës për Monitorimin e Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive. Monitorimi i aktiviteteve të zbatuara të Planit të Veprimit nuk është kryer nëpërmjet një procesi të mirëfilltë, dhe nuk është konsoliduar në raporte të dedikuara, në bazë vjetore, sikurse parashikohet të bëhej ky proces¹⁴⁴. Gjithashtu, nuk është kryer procesi i vlerësimit të zbatimit të saj nga ndonjë institucion i jashtëm i paanshëm.¹⁴⁵ Në vijim, nuk është raportuar pranë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi aktivitetet e realizuara, përqindjen e zbatimit, si dhe hapat e mëtejshëm, me qëllim për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie¹⁴⁶. Mungesa e monitorimit të aktiviteteve të ndërmarra, nëpërmjet një procesi të mirëfilltë, në kushtet e mungesës së indikatorëve të Planit të Veprimit, nuk siguron një informacion të plotë dhe të konsoliduar mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë.

8.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar hartimin dhe miratimin e pasaportës së indikatorëve për Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 dhe Planin e Veprimit, për të siguruar monitorimin e plotë dhe të besueshëm të zbatimit të aktiviteteve të këtij dokumenti strategjik dhe planeve të veprimit në zbatim të tij.

Brenda vitit 2026

8.2 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile pas miratimit të pasaportës së indikatorëve, të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar një monitorimin të plotë dhe të besueshëm të zbatimit të Planeve të Veprimit të Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, duke siguruar: konsolidimin e procesit të monitorimit në Raporte Vjetore të Monitorimit; ngritjen e Grupit të Punës për Monitorimin e Strategjisë; si dhe vlerësimin e paanshëm të rezultateve të arritura. Produktet e proceseve të mësipërme të raportohen pranë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Brenda 6-mujorit të parë 2027

¹⁴³ Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 dhe Plani i Veprimit të miratuar me VKM nr. 94, datë 22.02.2023, në kapitullin: 'Monitorimi dhe raportimi i progresit'.

¹⁴⁴ Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 dhe Plani i Veprimit të miratuar me VKM nr. 94, datë 22.02.2023, në kapitullin: 'Monitorimi dhe raportimi i progresit'.

¹⁴⁵ Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 dhe Plani i Veprimit të miratuar me VKM nr. 94, datë 22.02.2023, në kapitullin: 'Monitorimi dhe raportimi i progresit'.

¹⁴⁶ Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 dhe Plani i Veprimit të miratuar me VKM nr. 94, datë 22.02.2023-2030, në kapitullin: 'Monitorimi dhe raportimi i progresit'.

9. Gjetje nga auditimi: Përqindja e njësive të qeverisjes vendore që miratojnë dhe zbatojnë strategjitë vendore për reduktimin e riskut nga fatkeqësitë, është një nga indikatorët e dakordësuar në nivel global për të matur progresin e arritur në drejtim të OZHQ1. Gjithashtu, hartimi i Strategjive Vendore për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë është edhe një detyrim ligjor i parashikuar në Ligjin për Mbrojtjen Civile të vitit 2019. Deri në përfundim të vitit 2025, vetëm 15% e Bashkive¹⁴⁷ në vend kanë hartuar dhe miratuar Strategjitë Vendore të Reduktimit të Riskut nga Fatkeqësitë. Në Bashkitë Durrës dhe Elbasan, subjekte nën auditim, ende nuk ka filluar procesi i hartimit të këtij dokumenti strategjik. Rezulton se shkak për këtë situatë janë mangësitë në aftësitë teknike të stafit për hartimin e dokumenteve strategjike, pamjaftueshmëria e fondeve ose problematika të lidhura me interpretimin dhe implementimin e legjislacionit në fuqi për fondet e buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile, paqartësi lidhur me bazën e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë, etj.

9.1 Rekomandimi: Bashkitë Durrës dhe Elbasan, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar hartimin dhe miratimin e Strategjive Vendore për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë, në harmoni me Strategjinë Kombëtare për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë.

Brenda 6-mujorit të parë 2027

9.2 Rekomandimi: Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të kërkojë informacion të detajuar në mënyrë periodike nga secila prej Bashkive të cilat ende nuk e kanë miratuar Strategjinë Vendore për reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë, mbi fazën në të cilën janë në këtë proces, si dhe vështirësitë e hasura në përmbushjen e këtij detyrimi ligjor. Pjesë e Raportit të Monitorimit të Strategjisë Kombëtare për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë, të jetë edhe një analizë e detajuar (në baza vjetore), mbi ecurinë drejt përmbushjes së këtij detyrimi, sfidat dhe masat e parashikuara për t'u ndërmarrë për tejkalimin e tyre.

Brenda 6-mujorit të parë 2027

10. Gjetje nga auditimi: Sistemi Informatik i Menaxhimit të Ndhmës së Huaj (SIMNH), i cili duhet të përmbajë informacione mbi projektet e huaja, të dhëna financiare të tyre dhe referencat me OZHQ-t, nuk është funksional/operativ, dhe fushat nuk janë të populluara me të dhëna të plota. Përditësimi i fundit i këtij sistemi është kryer në vitin 2021 nga një organizatë ndërkombëtare. Në mungesë të funksionimit të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Ndhmës së Huaj nuk është e mundur të vlerësohet dhe të analizohet ndihma financiare e huaj e përfituar në drejtim të arritjes së Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm (në tërësi) dhe OZHQ 1 në veçanti, si një prej indikatorëve për të matur progresin e arritur në drejtim të zhdukjes së varfërisë.

10.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar funksionimin e plotë dhe të vazhduar të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Ndhmës së Huaj (SIMNH). Një analizë e detajuar mbi ecurinë për arritjen e funksionimit të plotë të këtij sistemi, për vet rëndësinë që ky sistem ka për të siguruar një monitorim të qëndrueshëm të ndikimit të ndihmës së huaj në arritjen e OZHQ-ve në vend, të përfshihet në agjendën e diskutimeve të Komitetit

¹⁴⁷ Mbështetur në informacionin zyrtar të siguruar gjatë auditimit (përcjellë zyrtarisht nga AKMC, si dhe konsultuar nga grupi i auditimit komunikimet zyrtare të AKMC me strukturat e përfshira në këtë proces) rezulton se kanë miratuar këtë dokument strategjik 9 bashki, janë në proces 13 bashki, ndërsa për 39 bashki nuk ka nisur ende procesi.

Ndërmistror për Arritjen e OZHQ-ve, në mbledhjen e ardhshme të tij.

Brenda 6-mujorit të parë 2027

10.2 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të marrin masat e nevojshme për të kryer një analizë të detajuar mbi ndihmën e huaj që vendi ynë ka përfituar ndër vite dhe referencat me OZHQ-të. Rezultatet e kësaj analize të bëhen publike, me qëllim sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies lidhur me ndikimin e ndihmës së huaj në arritjen e OZHQ 1.

Brenda 6-mujorit të parë 2027

Observimi i subjektit: Me anë të shkresës nr. 8527/3 prot., datë 18.02.2026 Ministria e Financave ka përcjellë komentet dhe observimet lidhur me rekomandimin e mësipër, protokolluar në KLSH nr. 589/17 prot., datë 27.02.2026, si: *“Vlerësojmë se institucioni përgjegjës për zbatimin e tij është SASPAC, pasi në përputhje me fushën e përgjegjësisë në VKM 642/2021, ky institucion koordinon dhe monitoron ndihmën e huaj në vendin tonë. Në këtë kuadër me shkresën nr. 321, datë 09.02.2026, SASPAC i është drejtuar të gjitha institucioneve me kërkesën për të raportuar mbi ndihmën e huaj të përfituar nga to.... MF do të kontribuojë me informacionin përkatës, vetëm për projektet brenda fushës së saj të përgjegjësisë, dhe nëse do të kërkohet nga SASPAC, do të jetë e gatshme të asistojë me të dhëna shtesë sipas fushës së përgjegjësisë.”*

Qendrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me vlerësimin e paraqitur nga Ministria e Financave, sqarojmë se është në përputhje me frymën e rekomandimit të KLSH-së, për bashkëpunim ndërinstitutional dhe kontribut me informacionin përkatës sipas fushës së përgjegjësisë së këtij institucioni, **dhe nuk përbën observim që kërkon ndryshim të përmbajtjes së rekomandimit.**

Observimi i subjektit: Me anë të shkresës nr. 270/2 prot., datë 04.03.2026 Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës ka përcjellë komentet dhe observimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e mësipërm, protokolluar në KLSH nr. 589/19 prot., datë 06.03.2026, si: *“Lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e auditimit për funksionimin e Sistemit Informatik të Menaxhimit të Ndhmës së Huaj (SIMAH), Agjencia ka dhe do të vazhdojë të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave për funksionimin e këtij sistemi, me qëllim për të adresuar problematikat ekzistuese dhe për përditësimin e tij, duke synuar monitorim të qëndrueshëm dhe raportim të besueshëm të ndihmës së huaj. Gjithashtu, theksojmë se Drejtoria e Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj ka përgatitur së fundmi raport analitik mbi të dhënat e sistemit të koordinimit të ndihmës së huaj në vendin tonë, i cili do të publikohet së shpejti, duke kontribuar kështu në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies lidhur me ndihmën e ndihmës së huaj. Theksojmë se këto masa do të zhvillohen në mënyrë të integruar me sistemet ekzistuese të planifikimit dhe raportimit (SIP), duke siguruar shmangien nga mbivendosja.”*

Qendrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër, qëndrimi i SASPAC konsiderohet në linjë me frymën e rekomandimit të KLSH-së, lidhur me ndërmarrjen e hapave për analizimin dhe raportimin e të dhënave mbi ndihmën e huaj, si dhe për publikimin e një raporti analitik në funksion të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, **dhe nuk përbën observim që kërkon ndryshim të përmbajtjes së rekomandimit.**

11. Gjetje nga auditimi: Fokusi që vendi i jep sektorëve kryesorë, si arsimi, mbrojtja sociale dhe shëndetësia, nëpërmjet buxheteve të alokuara për to, si shërbime thelbësore, është një prej indikatorëve për të matur progresin e arritur në drejtim të zhdukjes së varfërisë. Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar (SIPI) i cili që prej vitit 2020 duhet të siguronte një lidhje të qartë midis politikave, planifikimit strategjik, buxhetimit dhe OZHQ-ve, nuk funksionon. Kjo situatë nuk mundëson një lidhje të qartë midis OZHQ-ve dhe/apo *target-ëve* specifik të OZHQ-ve, me buxhetet e planifikuara apo të alokuara për arritjen e tyre, rrjedhimisht nuk është e mundur të sigurohet një informacion i plotë dhe i detajuar mbi buxhetet e alokuara për arritjen e OZHQ 1. Nga analiza e kryer nga grupi i auditimit për periudhën 2013-2024, rezultoi se shpenzimet për shërbimet thelbësore¹⁴⁸ (arsim, mbrojtja sociale, dhe shëndetësi), zënë rreth 50% të totalit të shpenzimeve qeveritare krahasuar me 65% që rezulton në mesataren e vendeve të Europës¹⁴⁹. Shpenzimet për mbrojtjen sociale në Shqipëri zënë rreth 30%, ndërsa arsimi dhe shëndetësia rreth 10% secila, pa shfaqur ndonjë trend të qëndrueshëm rritës apo rënës.

11.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar funksionimin, përditësimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar. Raportimi mbi ecurinë drejtë funksionimit të plotë të këtij sistemi, për vet rëndësinë që sistemi ka për të siguruar lidhjen e qartë të politikave, buxheteve, OZHQ-ve dhe treguesve të performancës të përfshihen në agjendën e diskutimeve të Komitetit Ndërministror për Arritjen e OZHQ-ve, në mbledhjen e ardhshme të tij.

Brenda 6-mujorit të parë 2027

Observimi i subjektit: Me anë të shkresës nr. 8527/3 prot., datë 18.02.2026 Ministria e Financave ka përcjellë komentet dhe observimet lidhur me rekomandimin e mësipër, protokolluar në KLSH nr. 589/17 prot., datë 27.02.2026, si: *“SIPI është një sistem që përdoret për hartimin e dokumenteve strategjike, dhe përgjegjës për të siguruar funksionimin e tij është SASPAC. Ministria përgjegjëse për financat përdor sistemin AFMIS, për të cilin ajo ka përgjegjësinë për funksionimin dhe përditësimin e tij. Sistemi SIPI ishte planifikuar që të kishte ndërfaqe/komunikim me sistemin AFMIS sa i takon pjesës së përputhshmërisë së dokumenteve strategjike me deklaratën e politikës së programit buxhetor, pjesë e përgatitjes së PBA-së, të ML/IQ. Në këtë kontekst, vlerësojmë që përgjegjësia për funksionimin dhe përditësimin e SIPI-së është e SASPAC-it dhe jo e MF-së. MF shpreh gatishmërinë për të bashkëpunuar me SASPAC kur të jetë e nevojshme, por mendojmë se nuk mund të ndjekë një rekomandim që nuk është në fushën e saj të përgjegjësisë.”*

Qendrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me vlerësimin e paraqitur nga Ministria e Financave, sjellim në vëmendje se në raportin e auditimit grupi i auditimit, ndër të tjera, ka trajtuar rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve kryesore lidhur me SIPI, historikun e krijimit të tij, statusin aktual të funksionimit, si dhe çfarë të dhënash mund të siguroheshin (përfshirë ato që lidhen me ndërveprimin me AFMIS) në rast se sistemi do të funksiononte. Në këtë kontekst, rekomandimi i KLSH-së i drejtohet SASPAC-it si institucioni përgjegjës për funksionimin, përditësimin dhe sigurimin e përdorimit të qëndrueshëm të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar, dhe Ministrisë së Financave si institucion me rol bashkëpunues, brenda fushës së përgjegjësisë. Duke qenë se SIPI duhet të ndërveprojë me bazë të dhënash që menaxhohet nga MF, rekomandimi i KLSH-së thekson rëndësinë e

¹⁴⁸ Të dhëna të përcjella zyrtarisht nga Ministria e Financave, grupi të auditimit, E-mail zyrtar 28.10.2025, në përgjigje të Kërkesës zyrtare për informacion të grupit të auditimit.

¹⁴⁹ General government expenditure by function (COFOG), Online data code:gov_10a_exp, indikatori EU-27.

bashkëpunimit të vazhduar midis dy institucioneve për realizimin e funksionimit, përditësimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të sistemit.

Për sa më sipër, qëndrimi i Ministrisë së Financave konsiderohet në linjë me frymën e rekomandimit të KLSH-së **dhe nuk përbën observim që kërkon ndryshim të përmbajtjes së tij.**

11.2 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (në cilësinë e Sekretariatit) të përfshijë gjetjet dhe rekomandimet e këtij auditimi në çështjet që do të paraqiten për diskutim në mbledhjen e ardhshme të Komitetit Ndërmintor për Arritjen e OZHQ-ve, me qëllim sigurimin e marrjes në kohë të masave për zbatimin e tyre, në funksion të përparimit drejt OZHQ1.

Brenda vitit 2026

Observimi i subjektit: Me anë të shkresës nr. 270/2 prot., datë 04.03.2026 Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës ka përcjellë komentet dhe observimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e mësipërm, protokolluar në KLSH nr. 589/19 prot., datë 06.03.2026, si: “Lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e auditimit për funksionimin e IPSIS, Agjencia ka dhe do të vazhdojë të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave për adresimin e problematikave ekzistuese dhe për përditësimin e sistemit, me qëllim të sigurohet një monitorim i qëndrueshëm dhe raportim i besueshëm i lidhjes midis politikave, buxheteve dhe OZHZ-ve, përfshirë OZHQ1. Platforma IPSIS aktualisht nuk funksionon, por projekti i Asistencës Teknike “EU 4 Good Governance” po vlereson efikasitetin e saj dhe identifikon fushat për përmirësim në procesin e planifikimit dhe monitorimit strategjik. Theksojmë se do të përfshijë gjetjet dhe rekomandimet e auditimit në agjendën e mbledhjes së ardhshme të Komitetit Ndërmintor për Arritjen e OZHQ-ve, me qëllim marrjen e masave të nevojshme për zbatimin në kohë të tyre dhe avancimin e progresit të OZHQ1.”

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër, qëndrimi i SASPAC konsiderohet në linjë me frymën e rekomandimit të KLSH-së **dhe nuk përbën observim që kërkon ndryshim të përmbajtjes së tij.**

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT